

MONITORIMI I MEDIAVE
TE SHKRUARA SHQIPTARE
DHE MUSLIMANET

ROALD A. HYSA

TIRANË 2006

Roald A. Hysa

**Mediat e shkruara
dhe muslimanët
shqiptarë**

www.xhamiakokonozit.com

Tiranë 2006

Titulli: Mediat e shkruara dhe muslimanët

Autor: Roald A. Hysa

Boton: www.xhamiakokonozit.com

© Të drejtën e botimit e ruan vetë autori, nuk lejohet të botohet pa dijeninë e tij. Lejohet vetëm për përdorim personal dhe me qëllim citimi. Për më tepër informacion mund t'i drejtoheni adresës e-mail: roald_ahysa@yahoo.com

Paraqitja e monitorimit “Mediat e shkruara dhe muslimanët”

Kohët e fundit është vënë re një shtim në rritje të interesit të shtypit të shkruar ndaj Islamit dhe muslimanëve. Këtë e pohon edhe ky monitorim që do ta ndiqni në vijim ndaj kësaj shtrese, e cila po bëhet e ndjeshme në shoqërinë e re shqiptare postdiktatoriale. Pikërisht ishte besimi i mohuar i shqiptarëve, ajo që e bën me interes këtë monitorim pas rreth 15 vjet tranzicioni. Vetëkuptohet që jo çdo gjë e pasqyruar në të përditshmet tona të shkruar nuk e pasqyron të plotë këndvështrimin musliman të gjërave, për objektet, sendet dhe temat që i interesojnë njerëzit për jetën e përditshme. Gazetarët janë munduar t'i pasqyrojnë ato sipas kuptimit të tyre, duke rënë përrejt edhe e mosnjohjes dhe e padijenisë, e ardhur kjo si shkak kryesor nga ndërprerja drastike 30-vjeçare e edukimit fetar në përgjithësi dhe atij musliman në veçanti. Një tjetër arsye e mosnjohjes është edhe puna rutinë, e cila bëhet pengesë për ta kuptuar si duhet problemin. Po ashtu siç mund të vërehet se ka pasur në disa raste edhe keqdashje dhe dëshirë për të ndikuar në probleme të ndryshme. Ndërkaq ky monitorim ka pasur për synim jo evidentimin e gabimeve të mundshme të shtypit se sa më tepër vendin që zënë muslimanët dhe problemet e tyre si kategoria shoqërore me e madhe në Shqipëri. Dalja në pah e këtyre problemeve ka ardhur më pas, kur pikërisht është parë se si janë trajtuar problemet. Një rast i tillë është shqetësimi i një gazetaresje se muslimanët nuk e festojnë Vitin e Ri, duke i cilësuar ata si ekstremistë. Por kjo është më tepër çështje kulture sesa armiqësie sociale siç paraqitet rëndom për vetë faktin se Viti i Ri ndër shqiptarët është një festë e re e futur nga të gjithë ish-regjimet komuniste për të zëvendësuar festat fetare. Për pasojë këtu nuk asnjë lloj ekstremizmi, por ruajtje të identitetit kulturor musliman, i

cili tashmë në një shoqëri të mbizotëruar nga laiciteti shtetëror dhe shekullarizmi kërkon mbijetesën e vet, si dhe vetë mosha e re gazetarëve që i trajtojnë këto probleme konsiderohet si “armiqtësi kulturore apo sociale”. Ndërsa kjo gjë në fakt është diversiteti kulturor që po përjetohet nga shoqëria shqiptare, e cila ka filluar të stabilizohet tashmë pas 15 vjet tranzicioni. Shpresojmë që ky monitorim do t'i vlejë të interesuarve, pra, atyre që merren me gazetarinë e shkruar, për t'iu dhënë të kuptojnë se tashmë muslimanët janë një shtresë e rëndësishme, qoftë sociale, qoftë ekonomike e Shqipërisë bashkëkohore. Jo vetëm muslimanët si shtresë, por edhe Komuniteti Musliman Shqiptar, në nivelin përfaqësues si dhe shoqatat e ndryshme muslimane, të cilat ushtrojnë veprimtaritë e ndryshme bamirëse në trojet shqiptare.

Kriteret e këtij monitorimi

Ky monitorim është bërë në 19 gazeta të ndryshme, ku nga këto 16 janë të përditshme kombëtare dhe që shpërndahen në të gjithë Shqipërinë, njëra është lokale që del në Durrës (Durrësi Bulevard) dhe nuk është e përditshme, dhe tjetra është gazeta javore ABC. Nga ky vëzhgim janë lënë jashtë gazetatat partiake, me përjashtim të gazetës “Republika”, e cila me gjithë statusin e saj partiak, është blerë nga privatë dhe vepron si çdo e përditshme e pavarur, por në rastet kur republikanët kanë nevojë, ata kanë vendin e tyre të padiskutueshëm në gazetë. Kriteri kryesor është që gazeta të ketë bërë ndonjë lajm, njoftim apo shkrim të çdolloji gazetaresk që i intereson muslimanëve, apo ka të bëjë me to dhe fenë e tyre Islamin. Ndërkaq në monitorim citohet data, gazeta, titulli i shkrimit (në disa raste edhe nëntitulli apo mbititulli), rubrika ku përfshihet, emri i autorit (ndërsa kur nuk është vënë emër është vënë “pa autor” dhe në rast se është me iniciale, janë vënë inicialet) dhe numri i faqes. Më pas është vënë një përmbledhje e shkrimit dhe ajo çka ka në brendësinë e tij si dhe citime nga teksti, kur është bërë ndonjë i tillë sipas rastit. Titujt e cituar apo tekstet në thonjëza që janë riprodhuar janë lënë siç janë në origjinal, qoftë edhe me gabime në të shkruar për t'i mbetur besnik citimit të

bërë. Ky monitorim ka filluar në muajin shkurt të vitit 2005 dhe është mbyllur në fund të muajit shkurt 2006. Pra, kap një periudhë 13-mujore. U ndoqën gazetatat e muajit shkurt 2006, pavarësisht se ky monitorim ishte paraparë që të ishte vjetor, për arsyen se gjatë muajit shkurt 2006 në të gjitha këto gazeta plasi i ashtuquajturi “problemi i karikaturave”, shkak i këtij debati në gazeta ishte publikimi i disa karikaturave ofenduese për të gjithë muslimanët të Profetit Muhamed nga gazeta daneze “Jyllands Posten”. Këto janë kriteret kryesore, të cilat jemi munduar t’i ndjekim me besnikëri.

Roald A. Hysa

Gazetat e përditshme të shfrytëzuara:

SOT, Korrieri, Ballkan, Tirana Observer, ABC, Albania, Dita, Express, Shekulli, Gazeta Shqiptare, Koha Jonë, Metropol, Panorama, Republika, Tema, 55, Standard, Durrësi Bulevard, Telegraf Ditor.

Indiferenca e rrezikshme ndaj besimeve

Nga Idriz
Pse duhet të bëjmë...
...indiferencë ndaj besimeve...
...që janë pjesë e identitetit të popullit...
...dhe të cilat kanë qenë...
...njëri nga faktorët kryesorë...
...që kanë bërë të mundur...
...që të jemi këtu sot...
...si popull dhe si shtet...
...dhe të cilat kanë qenë...
...njëri nga faktorët kryesorë...
...që kanë bërë të mundur...
...që të jemi këtu sot...
...si popull dhe si shtet...



TIRANA

1 përditshme e përmirësuar
10 Mars 2005

TRIVER

HOHA JOJE

Futet në votime Partia myslimane

Isb-Mylfia i shantazoi Lukën, tashmë kjoqta parti, synon që të ketë zgjedhje 10 marsi të vitit 2005.

korrieri

Shqipëri, gjysma e xhamive, pa leje

ZBULIMI Kancelari i Kulturës, pas një studimi, zbuloi se në Shqipëri ka vetëm gjysmën e xhamive të lejuara. Kjo tregon për indiferencën e shtetit ndaj besimeve.

ZHANI CIKO

1000000
Drejt për Oqean

metropol

TRAKTE MYSLIMANEVE: MOS FESTONI VITIN E RI

Analizë

Panorama

SHARROHET KRYQI Myftiu Moisiut: Po emërohen katolikët

SHEKULLI

Ikën nënkryetari i myslimanëve

Blendi Myftiu jep dorëheqjen. Komiteti Mysliman, njëçmërisht intrigueshëm

standard

EGALIZIMET

Parlamenti

Monitorimi i mediave shqiptare të shkruara

Muaji Shkurt 2005

1. E enjte 10 shkurt

Gazeta “Koha Jonë”

“**Muxhahedinët e shtypit shqiptar**”, editorial, Rudolf Marku, fq. 1 me vijim në fq. 6.

Përveç titullit dhe përdorimit të termit “muxhahedin” në editorial nuk bëhet asnjë lidhje tjetër me Islamin. Autori në këtë editorial sulmon pseudo-publicistët, të cilët nuk i njeh njeri dhe që abuzojnë, por duke përdorur si analogji termin islam “muxhahedin”. Përdorimi i këtij termi është bërë me kuptim përkeqësues, për pasojë autori ose nuk e ka ditur kuptimin e saktë të tij, ose e ka bërë në mënyrë të pavetëdijshme, ose e ka bërë qëllimisht për të vazhduar në rrugën e klisheve të krijuara abuzivisht nga mediat kundrejt Islamit.

2. E shtunë 12 shkurt

Gazeta “Koha Jonë”

“**Edi Rama nuk i jep Komunitetit Mysliman leje ndërtimi për Namazgjah**”, me okelion në kopertinë “*Nënvleftësimi i komunitetit më të rëndësishëm*”. lajmi i parë, Alban Mati, fq. 2.

Ky shkrim në formë të përmbledhur paraqet faktet e ndërtimit të katedrales së Shën Palit në kryeqytet për komunitetin katolik mu pranë sallës plenare të Kuvendit dhe të ndërtimit të një katedraleje tjetër shumë të madhe për ortodoksët, punimet e së cilës tashmë kanë filluar mu pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe aludohet qartë për prejardhjen e ministrit të saj Majko. Ndërsa akoma nuk është dhënë leje për ndërtimin e një xhamie me përmasa të mëdha për nevojat e muslimanëve të kryeqytetit. Ky shkrim vjen tamam në kohën kur kryetari i bashkisë së Tiranës Edi Rama, ka paraqitur përpara publikut projektin e kullave që do të ngrihen mu në qendër pranë monumentit të “Partizanit të panjohur”, ku dikur ka qenë Xhamia e vjetër Sulejman Pasha, e cila u rrafshua përfundimisht në vitin 1950. Gjuha e përdorur në këtë shkrim është kundra kryetarit Edi Rama dhe pasqyron letrat e shumta që i janë drejtuar nga Komuniteti Musliman atij. Po ashtu thuhet në këtë shkrim, citojmë “ky akt i nënvleftësimit nga Edi Rama i komunitetit tonë nuk mund të kalojë pa reagime të besimtarëve tanë”.

3. E shtunë 19 shkurt 2005

Gazeta “Shekulli”

**“Dëshmitarët e Jehovahit, sekt i papranuar nga fetë zyrtare”
“Komuniteti Musliman Muça: Kjo nuk është fe e vërtetë”,**
kronikë, e.spaho; b.prifti, fq. 5.

Shkrimi i referohet vetëvrasjes së vajzës 11-vjeçare me banim në Allias të Tiranës Joana Rajdhos, e cila frekuentonte “Dëshmitarët e Jehovahit”. Në këtë shkrim sillen prononcimet e tre drejtuesve kryesorë të komuniteteve fetare. Ndër to edhe kryetari i Komunitetit Musliman Selim Muça që është deklaruar se “ndjekja e këtij sektit fetar, nuk i sjell të mira njerëzve”. Po të njëjtin qëndrim ndaj këtij sektit mbajnë edhe drejtuesit e tjerë të komuniteteve fetare. Po ashtu janë hapur hetimet nga prokuroria për vetëvarjet e Joana Rajdhos dhe Alda Cenes.

4. E Shtunë, 26 Shkurt 2005

Gazeta “Korrieri”

“Myslimanet: Nuk ka vonesa per Universitetin”

Shkrimi njofton rreth konferencës së shtypit të mbajtur nga nënkryetari i Komunitetit Musliman dhe njëkohësisht Myftiu i Tiranës, Bledar Myftari së bashku me drejtorin e arsimit në këtë institucion Saimir Rusheku. Citojmë:

“Ideja për ngritjen e një institucioni të edukimit teologjik të besimtarëve myslimanë u bë publike pas një vizite të Kryeministrit Nano në selinë e Komunitetit Mysliman Shqiptar, më 21 janar. Shefi i qeverisë përkrahu propozimin e bërë nga drejtuesit e komunitetit mysliman, duke premtuar edhe zgjidhjen e problemit të kthimit të pronave.”

5. E shtunë, 26 shkurt 2005

“Gazeta Shqiptare”

Pas vetëfljimeve të fundit muslimanët kërkojnë kontroll ndaj fraksioneve fetare

“Të jashtëligjshme sektet fetare”, *Mesazhi musliman dje në xhamitë e kryeqytetit*, Fatos Mahmutaj, fq. 11.

Ky është një shkrim rreth jehonës së disa vetëvrasjeve të ndodhura gjatë muajit shkurt nga disa të mitur dhe qëndrimit të mbajtur nga hatibi i xhamisë Dine Hoxha në kryeqytet, citojmë:

“Sipas tyre, organet e caktuara shtetërore duhet të kontrollojnë këto fraksione të feve, pasi nuk do të jetë çudi kur të ligjërohen sekte sataniste dhe të kryejnë masakra, siç ka ndodhur disa

vjet më parë në Japoni dhe vende të tjera. Ahmed Kalaja, hatibi (ligjëruesi) i xhamisë së Rrugës së Kavajës, në fjalën (hutben) e mbajtur dje para besimtarëve të kësaj xhamie, pasi përmendi statistikën tmerruese të kohëve të fundit, fajësoi për gjithçka që ka lidhje me vetëflijimin e njerëzve, humbjen e besimit të tyre te Zoti, si dhe ngatërrimin e besimit të pastër të njerëzve në dhjetëra sekte të devijuara fetare. “As islami, as krishterimi e as hebraizmi nuk i ftojnë njerëzit të vetëvriten, por përkundrazi, e dënojnë tepër një veprim të tillë”, tha Kalaja,...” Po në këtë faqe i bëhet jehonë konferencës së shtypit të mbajtur një ditë përpara nga nënkryetari i Komunitetit Musliman dhe njëkohësisht Myftiu i Tiranës, Bledar Myftari së bashku me drejtorin e arsimit në këtë institucion Saimir Rusheku, në shkrimin me titull: **“Komuniteti Musliman: Vlerësojmë premtimin për Universitetin Islamik”**

6. E shtunë, 26 shkurt 2005

Gazeta “Shekulli”

Fondacioni fetar “Xhemati Ahmadija” pretendon se është një sekt mysliman dhe se bashkëpunon edhe me Komunitetin Mysliman.

“Xhamia që nuk njihet nga Komuniteti Mysliman”, Valmora Gogo.

Në faqet e kësaj gazete shfaqet ky shkrim, i cili flet për qendrën ahmedije të hapur përpara disa vjetësh, rrymë e cila nuk pranohet unanimisht nga dijetarët muslimanë që i përket Islamit apo muslimanëve. Megjithatë sipas deklaratave të bëra nga drejtori i qendrës Abdul Shakoor Aslam Khan, ato kanë bashkëpunim me Komunitetin Musliman, citojmë nga shkrimi:

Bashkëpunimi me Komunitetin Mysliman

Abduli të tregon një dokument ku thuhet se Komuniteti Mysliman e njuh praninë e këtij sekti, madje edhe i falenderon për punën e tyre. Dokumenti i firmosur nga kryetari i Komunitetit Mysliman Selim Muca në vitin 2004 ka edhe një tjetër fakt. Sipas dokumentit të treguar nga Abduli, Selim Muca i ka falenderuar edhe për një lloj financimi që ka bërë ky sekt për ambientet e Komunitetit Mysliman. Presidentit të sektit iu kërkua një kopje e këtij dokumenti nga “Shekulli”, por Abdul Shakoor Aslam Khani nuk e lejoi një gjë të tillë.

Ndërkaq po në këtë faqe jepet kundërpërgjigja nga nënkryetari i Komunitetit Musliman dhe njëkohësisht Myftiu i Tiranës, Bledar Myftari, nën një titull tjetër: **Myftari: “Ai sekt nuk përfaqëson Islamin”**, si dhe citojmë nga ky shkrim: “Ai fondacion

fetar nuk përfaqëson Islamin”,-kështu u shpreh dje nënkryetari i Komunitetit Mysliman, Bledar Myftari. Sipas Myftarit, Komuniteti Mysliman nuk mban asnjë lidhje me fondacionin. Po sipas Myftarit, edhe në arenën ndërkombëtare ky sekt nuk llogaritet si mysliman. “Ky sekt nuk përfaqëson aspak komunitetin mysliman”,-ka theksuar sërish Myftari.

Po në këtë faqe i bëhet jehonë konferencës së shtypit të mbajtur një ditë përpara nga nënkryetari i Komunitetit Musliman dhe njëkohësisht Myftiu i Tiranës, Bledar Myftari së bashku me drejtorin e arsimit në këtë institucion Saimir Rusheku, në shkrimin me titull:

“Si do të hapet Universiteti Mysliman”

Muaji Mars 2005

7. E diel 6 mars 2005

gazeta “Korrieri”

“Vdekja e religjioneve”, editorial nga Sokol Balla; fq.1 me vazhdim në fq. 10

ky autor ka marrë shkas nga 4 vetëvrasjet që ndodhën gjatë muajit shkurt, të të miturve që u vetëvarën në disa qytete të vendit, ku akuzohen kryesisht një sekt fetar, i ashtuquajhuri sekt i “Dëshmitarëve të Jehovait”, të cilët kanë qenë disa herë me radhë në shënjestrën e mediave të ndryshme, jo vetëm për këtë problem, por edhe për disa të tjera. Autori thotë për to: “Natyrisht e kam të vështirë të vlerësoj në mënyrë konkluzive, nëse “Dëshmitarëve të Jehovait” kanë nxitur këto vetëvrasje makabre foshnjash 11-vjeçare, edhe pasi për orë të tëra kërkova në internet. Duke mos zbuluar asgjë për joshjen ndaj vdekjes, por duke lexuar shumë për Armaggeddon-ët e rremë që “Dëshmitarët e Jehovait” predikonin vazhdimisht në vite. Gjithsesi nga ato që lexova nuk arrita të dalloj nxitjen drejt vetëvrasjes, por jam i detyruar të besoj policinë, kur thotë se ka sekuestrar në cilësi provash, botimet javore të “Kullës së Rojes”. Në fund të fundit, unë ndoshta nuk i arrij t’i kuptoj mirë, sepse unë NUK BESOJ.”

Më pas ky gazetar vazhdon me sulmet e tij edhe përfaqësuesit e besimeve fetare të njohura tradicionalisht në të gjithë trojet shqiptare ku sulmon fillimisht bektashinjtë dhe Dede Reshat Bardhin pse është dekoruar nga presidenti, vazhdon me ortodoksët, me myslimanët e katolikët, por më ashpër sulmohet Komuniteti Musliman. Citojmë përsëri nga shkrimi në fjalë:

“Nuk ka sesi të mos dëshpërohesh kur sheh një Komunitet Mysliman, të degjeneruar në një zyrë tapish dhe hipotekash dhe skenë krimesh misterioze.” Po ashtu ky autor shton: “Ata që presupozohet të na udhëheqin në këtë udhëtim të vështirë mistik dhe shpirtëror në kisha e xhami, duhet të fillojnë të lëvizin. Tashmë në Shqipëri po rriten breza që kanë nisur të besojnë”.

8. E diel 6 mars 2005

gazeta “Korrieri”

“De Agostini '05: Shqipëria, 84.4% muslimane”, sociale, Ben Andoni, fq. 9.

Në këtë shkrim autori i bën jehonë faktit të publikuar nga enciklopedia e famshme italiane “De Agostini”, e mirënjohur ndërkombehtarisht. Shifrat e paraqitura nga ky almanak prestigjioz, nuk dihet pse, kanë shkaktuar një shqetësim të madh tek ky autor, të cilit i parapëlqejnë shifrat e dhëna vite më parë nga ky almanak. Citojmë nga shkrimi:

“Në vitin 2000, De Agostini, almanaku i njohur i botës italike, jepte shifrën klasike për sa i përket përqindjes së religjionit shqiptar: 70% muslymanë-20% ortodoksë-10% katolikë. Këtë shifër e ka përmbysur vetë ‘frikshëm’ në vitin 2005, kur ka shkruar për religjionin muslyman 84.4%, për atë ortodoks 8.7% dhe për katolikët 6.2%”. Autori ka kërkuar me këmbëngulje të dijë burimin e shifrave të marra nga ky almanak dhe aty sipas atij burimi i shfrytëzuar nga kjo enciklopedi, është faqja e internetit e INSTAT-it, të cilin ai e kontakton nëpërmjet drejtoreshës së këtij institucioni Milva Ikonomi. Kjo drejtuese ka deklaruar sipas autorit, e citojmë: “Nuk e di se kujt i janë referuar, por kuptohet që kjo nuk i është referuar institucioneve tona”. Çuditërisht ky fakt nuk i ka pëlqyer autorit dhe është munduar që gjatë shkrimit të tij të shkurtër të shkaktojë konfuzion të dhënash, ku në mënyrë indirekte i referohet shumë gabim disa deklaratave të bëra ditë më parë në gazetën “Shekulli” të bëra nga Rrok Mirdita ku ai deklaroi se komuniteti katolik ka 40.000 persona të pagëzuar, dhe jo 500.000 siç pretendon artikullshkruesi. Ai kërkon që kjo mjegull të davaritet së bashku me konfuzionin, por në këtë rast ia kërkon shifrave të deklaruara nga De Agostini, me të cilën habitet. Citojmë fjalinë e fundit të shkrimit: “Në këtë rast flitej për De Agostinin, një autoritet për sa i përket prestigjit... më vonë mund të vijojnë dhe të tjerët”.

9. E martë 8-9 mars 2005

gazeta “SOT”

“Enigma e sfinksit në marrëdhëniet shqiptaro-amerikane”, Kastriot Myftaraj

Citojmë nga shkrimi i këtij autori që është i mirënjohur për urrejtjen ndaj Islamit dhe muslimanëve: “myslimanët shqiptarë janë vetëm ish-myslimanë duke qenë se dikur u kthyen në Islam me dhunë nga Turqia dhe me largimin e saj veç një pakësi e këtyre ndiheshin vërtetë myslimanë dhe ndiqnin ritet. Pjesa

më e madhe e këtyre nuk janë shqiptarë etnikë, por myslimanë me origjinë turke”. Kjo gjë shkruhet pas njoftimit nga Vatikani se mbi 200.000 myslimanë shqiptarë janë bërë të krishterë. Duket se synimet e autorit që është një person problematik vazhdimisht i akuzuar se edhe shkrimet nuk i ka të vetat, nuk bën gjë tjetër vetëm se sjell ndasi midis shqiptarëve dhe shkon në favor të prozelitizmit.

10. E diel 13 mars 2005

gazeta “Metropol”

“Dita e verës, lavde pagane për natyrën”, (etnologu dhe studiuesi Thanas Meksi shpjegon), Ledia Lleshi, fq. 17

Studiuesi Thanas Meksi i shpjegon nëpërmjet intervistës së tij se Dita e Verës është një festë pagane. Citojmë nga intervista: “Familjet e trevës (flitet për qytetin e Elbasanit) arrijnë të sjellin natyrën me anë të riteve, duke i bërë lavdet e para pagane në një ditë të shënuar.”

Po në këtë faqe kemi një shkrim të asociuar me mbititull “Flet Myneveri (mu në verë). 80 vjeçarja e lindur në Ditën e Verës” dhe titull Elbasani “sofra e Ditës së Verës”.

Në këtë shkrim emri i të intervistuarës Mynever lidhet me kuptimin në shqip “Mu në verë”. Kuptohet që edhe gazetarja, edhe e intervistuarra kanë bërë një lidhje logjike pa ditur prejardhjen e këtij emri që është nga arabishtja Munevvere, që do të thotë e shndritshme, e ndriçuar.

11. E diel 13 mars 2005

gazeta “Metropol”

“Çfarë kuptoi Bushi?” në Bota Speciale, Fareed Zakaria, fq. 18.

Gjendja e Lindjes së Mesme është në vëmendje të këtij shkrimi, ku autori merr në shqyrtim politikanët dhe udhëheqësit e këtij rajoni. I gjithë ky këndvështrim është trajtuar duke u ballafaquar me qëndrimet e presidentit amerikan Bush dhe administratës së tij pas 11 shtatorit.

“Një shenjë shërimi” – Një vit pas 11 marsit, myslimanët e Spanjës ndihen si në shtëpinë e tyre - në Bota Speciale, Stryker McGuire, fq. 19.

Në këtë reportazh të shkurtër autori përshkruan gjendjen e komunitetit musliman pas ngjarjeve tragjike të 11 marsit 2004 ku u vranë dhjetëra të pafajshëm. Në këtë shkrim autori vlerëson pozitivisht qëndrimet e qeverisë spanjolle nëpërmjet intervistave të ndryshme me përfaqësues muslimanë në qytete të ndryshme

të Spanjës. Tragjedia e stacionit Atocha në Madrid u kapërcye pa pasoja denigruese dhe pa fobira ndaj të huajve sidomos ndaj vendeve të Magrebit. Përkundrazi autori na tregon, citojmë: “Pas shpërthimeve të vitit të kaluar, udhëheqësit katolikë dhe myslimanë u bashkuan me njëri-tjetrin, duke kapërcyer ndarjet historike dhe fetare. Qeveria premtoi të zbatoj një marrëveshje të mbajtur pezull të vitit 1992, për të financuar mësimin e Islamit në shkolla, kur këtë e kërkojnë të paktën dhjetë studentë. Qeveria rajonale e Katalonjës ofroi, për herë të parë, mësim në gjuhën arabe dhe për kulturën arabe.”

Po ashtu në vijim të shkrimit jepen përpjekjet e qeverisë spanjolle për të përballuar kërkesat në rritje të popullsisë muslimane në Spanjë dhe njoftohet se kjo popullsi përbën 2% të totalit dhe është me tendenca në rritje.

12. E diel 13 mars 2005

gazeta “Albania”

“Çfarë bëjnë 3.500 misionarët e sektit “Dëshmitarët e Jehovahit” në Shqipëri” speciale, Bejdo Malo, fq. 12-13.

Në këtë speciale trajtohen problemet e krijuara nga 4 vetëvrasjet e adoleshenteve si dhe përpjekjet ligjore për të vënë nën kontroll sektet e dyshimta fetare me ligj. Dëshmitarët e Jehovahit në këtë shkrim citohen të kenë thënë se ato mbahen me ndihmat e këtyre pjesëtarëve. Ndërsa në të kundërt shifrat e cituara nga mediat e ndryshme shqiptare kapin shumë e një investimi 90 milionë dollarësh duke vënë krejtësisht nën dyshim besueshmërinë e këtyre njerëzve pavarësisht në janë shqiptarë apo jo. Literatura e këtij sektit në shumë vende të tjera është refuzuar dhe ato nuk lihen ligjërisht të hyjnë në këto vende. Megjithatë kjo çështje me sa thuhet në shkrim i ka kaluar prokurorisë. Po ashtu duke pasur si burim Komitetin Shtetëror të Kulteve jepet edhe një listë e Kishave Ungjillore që përbëhet nga rreth 98 të tilla.

13. E martë 15 mars 2005

gazeta “Korrieri”

“Mjaft pasiviteteve në çështjet fetare”, analizë, Xhavit Shala (drejtor i Qendrës Shqiptare të Studimeve për Sigurinë Kombëtare – ish-funksionar i rendit)

Në këtë analizë, të cilën autori e nis duke përmendur përplasjen e simboleve ku përmend rastin e dy kryqeve të mëdhenj ortodoksë, vazhdon me analizën mbi gjendjen e bashkësisë muslimane pas ardhjes së demokracisë deri në ditët e fundit.

Ai akuzon haptas se OJQ-të arabe u bënë përhapëse të fundamentalizmit islamik në Shqipëri nëpërmjet selefizmit. Citojmë nga shkrimi: “Selefizmi është semafori jeshil i fundamentalizmit islamik. Ai ndryshon nga katër drejtimet kryesore të ushtrimit të myslimanizmit, të njohura zyrtarisht në botë.” Në rreshtat pasues të këtij citimi autori mundohet të bëjë një analizim të imtë për këtë lëvizje në botë dhe në Shqipëri dhe lëvizjet e tyre. Duket nga informacioni i paraqitur nga ky autor se ai nuk i njeh sa duhet shkollat juridike islame dhe se informacioni është i marrë nga burime jo të mirinformuara për nga pikëpamja doktrinale. Burimet e informimit të autorit duhet të jenë të brendshme, të Komunitetit Musliman. Megjithatë me sa duket më i rëndësishëm për këtë person janë pikat që jepen në mbyllje të shkrimit dhe që kanë të bëjnë me: miratimin e ligjit për komunitetet fetare, nënshkrimi i një aktmarrëveshjeje midis qeverisë dhe katër komuniteteve fetare si dhe zgjidhja me ligj për kthimin e pronave komuniteteve fetare.

14. E shtunë 19 mars 2005

Gazeta “Albania”¹

“Drejtuesit e feve, deklarata për harmoninë mes besimeve”,
pa autor, fq. 5.

Në këtë shkrim i bëhet jehonë faktit të nënshkrimit të marrëveshjes së katër komuniteteve fetare tradicionale në Shqipëri e quajtur “Deklarata e Angazhimeve të Përbashkëta Morale. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga katër krerët e këtyre komuniteteve, kryetari i Komunitetit Musliman Shqiptar H. Selim Muça, Kryegjyshi Botëror i Kryegjyshitës Bektashiane H. Dede Reshat Bardhi, Kryepeshkopi i Tiranës Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë Anastas Janullatos, Shkëlqesia e tij Monsinjor Rrok Mirdita, edhe në sajë të bashkëpunimit me konferencën botërore “Fetë për paqen”. Në këtë takim kanë qenë të pranishëm kryeministri Fatos Nano, funksionarë të lartë shtetërorë, funksionarë të trupit diplomatik të akredituar në Tiranë si dhe përfaqësuesit e konferencës botërore “Fetë për Paqen” me drejtoreshën e saj rajonale Emyli Kruniç. Po ashtu kjo nismë është mbështetur nga Ministria e Jashtme Gjermane. Në këtë deklarata komunitetet fetare angazhohen për vazhdimin dhe promovimin e një atmosfere paqësore brenda komuniteteve dhe në asnjë rast të mos nxisin urrejtjen fetare ndaj njëri-tjetrit.

¹ Pikërisht për jehonën e këtyre shkrimeve është përgatitur një aneks i veçantë, i titulluar: “Marrëveshja e katër komuniteteve fetare tradicionale dhe aktualiteti shqiptar”, po nga ky monitorues.

15. E shtunë 19 mars 2005

gazeta “Panorama”

“**Katër fetë nënshkruajnë paqe**”, pa autor, fq. 10

Në këtë shkrim i bëhet jehonë faktit të nënshkrimit të marrëveshjes së katër komuniteteve fetare tradicionale në Shqipëri e quajtur “Deklarata e Angazhimeve të Përbashkëta Morale. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga katër krerët e këtyre komuniteteve, kryetari i Komunitetit Musliman Shqiptar H. Selim Muça, Kryegjyshi Botëror i Kryegjyshatës Bektashiane H. Dede Reshat Bardhi, Kryepeshkopi i Tiranës Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë Anastas Janullatos, Shkëlqesia e tij MonsinJOR Rrok Mirdita, edhe në sajë të bashkëpunimit me konferencën botërore “Fetë për paqen”. Në këtë takim kanë qenë të pranishëm kryeministri Fatos Nano, funksionarë të lartë shtetërorë, funksionarë të trupit diplomatik të akredituar në Tiranë si dhe përfaqësuesit e konferencës botërore “Fetë për Paqen” me drejtoreshën e saj rajonale Emyli Kruniç. Po ashtu kjo nismë është mbështetur nga Ministria e Jashtme Gjermane. Në këtë deklaratë komunitetet fetare angazhohen për vazhdimin dhe promovimin e një atmosfere paqësore brenda komuniteteve dhe në asnjë rast të mos nxisin urrejtjen fetare ndaj njëri-tjetrit. Pak a shumë teksti është i ngjashëm në të gjitha gazetatat, por në rastin konkret është gabuar kur thuhet katër fe në titull, sepse janë dy fe dhe katër komunitete. Muslimanë dhe të krishterë që i përkasin bektashinjve dhe sunitë; ortodoksë dhe katolikë.

16. E shtunë 19 mars 2005

gazeta “Panorama”

“**Universitetet fetare dhe siguria kombëtare**”, opinion, Ferdinand Xhaferaj, fq. 1 me vazhdim fq. 11.

Në këtë shkrim vëmendja e autorit është përqendruar mbi hapjen e universitetit musliman që ende nuk është hapur në Tiranë. Në të gjithë shkrimin është bërë i ndjeshëm fakti se nëse do të hapet një universitet musliman në Shqipëri do të minimizohet rreziku që vjen ndaj të shkolluarve jashtë në universitetet fetare. Ndërsa hapja e një universiteti musliman në Tiranë do të sjellë edhe një kombëtarizim të kuadrove që mendohet se do të dalin nga kjo strukturë e supozuar. Ky shqetësim i autorit vjen nga traditat e vendeve të tjera islame, citojmë: “Traditat e huazuara nga vendet arabe mund të prodhonin një orientim të Islamit shqiptar sipas parimit, feja para kombit. Kjo do të përbënte një kërcënim nga më seriozët

për institucionin e harmonisë fetare”. Ky autor vazhdon më tej të flasë me tone pozitive për punën që duhet të bëjnë predikuesit muslimanë në bazë të ajeteve kuranore për tolerancën. Më tej ky autor e sheh si pozitiv hapjen e këtij universiteti dhe mbylljen e ciklit të arsimit të lartë për të gjithë nxënësit e 7 medreseve të shpërndara në Shqipërinë zyrtare. Ky autor mendon, citojmë: “Pra, universiteti duke mundësuar një zhvillim modern kombëtar të Islamit në vendin tonë do të jetë një harmonizues progresiv i Islamit kombëtar shqiptar me vlerat e qytetërimit evropian.”

17. E shtunë 19 mars 2005

gazeta “Express”

“Komunitetet fetare nënshkruajnë marrëveshjen për bashkëjetesë paqësore”, flash, pa autor, fq. 12.

Në këtë shkrim i bëhet jehonë faktit të nënshkrimit të marrëveshjes së katër komuniteteve fetare tradicionale në Shqipëri e quajtur “Deklarata e Angazhimeve të Përbashkëta Morale. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga katër krerët e këtyre komuniteteve, kryetari i Komunitetit Musliman Shqiptar H. Selim Muça, Kryegjyshi Botëror i Kryegjyshit Bektashian H. Dede Reshat Bardhi, Kryepeshkopi i Tiranës Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë Anastas Janullatos, Shkëlqesia e tij Monsinjor Rrok Mirdita, edhe në sajë të bashkëpunimit me konferencën botërore “Fetë për paqen”. Në këtë takim kanë qenë të pranishëm kryeministri Fatos Nano, funksionarë të lartë shtetërorë, funksionarë të trupit diplomatik të akredituar në Tiranë si dhe përfaqësuesit e konferencës botërore “Fetë për Paqen” me drejtoreshën e saj rajonale Emyli Kruniç. Po ashtu kjo nismë është mbështetur nga Ministria e Jashtme Gjermane. Në këtë deklaratë komunitetet fetare angazhohen për vazhdimin dhe promovimin e një atmosfere paqësore brenda komuniteteve dhe në asnjë rast të mos nxisin urrejtjen fetare ndaj njëri-tjetrit.

18. E shtunë 19 mars 2005

gazeta “Republika”

“Komunitetet fetare, nënshkruajnë deklaratën e Angazhimeve Morale”, politikë, pa autor, fq. 6.

Në këtë shkrim i bëhet jehonë faktit të nënshkrimit të marrëveshjes së katër komuniteteve fetare tradicionale në Shqipëri e quajtur “Deklarata e Angazhimeve të Përbashkëta Morale. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga katër krerët e këtyre komuniteteve, kryetari i Komunitetit Musliman Shqiptar H. Selim Muça, Kryegjyshi Botëror i Kryegjyshit Bektashian

H. Dede Reshat Bardhi, Kryepeshkopi i Tiranës Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë Anastas Janullatos, Shkëlqesia e tij MonsinJOR Rrok Mirdita, edhe në sajë të bashkëpunimit me konferencën botërore “Fetë për paqen”. Në këtë takim kanë qenë të pranishëm kryeministri Fatos Nano, funksionarë të lartë shtetërorë, funksionarë të trupit diplomatik të akredituar në Tiranë si dhe përfaqësuesit e konferencës botërore “Fetë për Paqen” me drejtoreshën e saj rajonale Emyli Kruniç. Po ashtu kjo nismë është mbështetur nga Ministria e Jashtme Gjermane. Në këtë deklaratë komunitetet fetare angazhohen për vazhdimin dhe promovimin e një atmosfere paqësore brenda komuniteteve dhe në asnjë rast të mos nxisin urrejtjen fetare ndaj njëri-tjetrit.

19. E shtunë 19 mars 2005

gazeta “Gazeta Shqiptare”

“Katër komunitetet fetare në vend rikonfirmojnë bashkëjetesën”, mbititull *“Nënshkruhet deklarata e Angazhimeve Morale”*, politikë, pa autor, fq. 6.

Në këtë shkrim i bëhet jehonë faktit të nënshkrimit të marrëveshjes së katër komuniteteve fetare tradicionale në Shqipëri e quajtur “Deklarata e Angazhimeve të Përbashkëta Morale. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga katër krerët e këtyre komuniteteve, kryetari i Komunitetit Musliman Shqiptar H. Selim Muça, Kryegjyshi Botëror i Kryegjyshatës Bektashiane H. Dede Reshat Bardhi, Kryepeshkopi i Tiranës Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë Anastas Janullatos, Shkëlqesia e tij MonsinJOR Rrok Mirdita, edhe në sajë të bashkëpunimit me konferencën botërore “Fetë për paqen”. Në këtë takim kanë qenë të pranishëm kryeministri Fatos Nano, funksionarë të lartë shtetërorë, funksionarë të trupit diplomatik të akredituar në Tiranë si dhe përfaqësuesit e konferencës botërore “Fetë për Paqen” me drejtoreshën e saj rajonale Emyli Kruniç. Po ashtu kjo nismë është mbështetur nga Ministria e Jashtme Gjermane. Në këtë deklaratë komunitetet fetare angazhohen për vazhdimin dhe promovimin e një atmosfere paqësore brenda komuniteteve dhe në asnjë rast të mos nxisin urrejtjen fetare ndaj njëri-tjetrit.

20. E shtunë 19 mars 2005

gazeta “Gazeta Shqiptare”

“Holanda ndalon gjuhën arabe në xhami”, lajm shkurt

“HAGË – Zyrtarët holandezë deklaruan dje se kanë urdhëruar që në xhamitë e vendit të përdoret gjuha holandeze dhe jo ajo arabe. Urdhëresa ka dalë nga këshilli i qeverisë për çështjet

sociale, por ka shkaktuar shumë debate në vendin simbol të tolerancës dhe integritit. Masa u mor disa muaj pas vrasjes së regjizorit Theo Van Gogh nga një ekstremist, gjë që shkaktoi polemika lidhur me emigrantët islamikë në vend.” Përdorimi i termit emigrant islamik është i gabuar, duhet përdorur musliman.

21. E shtunë 19 mars 2005

gazeta “**Shekulli**”

“**Katër besime fetare firmosin deklarata bashkëpunimi**”, sociale, e.s. (elda spaho), fq. 9.

Në këtë shkrim i bëhet jehonë faktit të nënshkrimit të marrëveshjes së katër komuniteteve fetare tradicionale në Shqipëri e quajtur “Deklarata e Angazhimeve të Përbashkëta Morale. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga katër krerët e këtyre komuniteteve, kryetari i Komunitetit Musliman Shqiptar H. Selim Muça, Kryegjyshi Botëror i Kryegjyshit Bektashian H. Dede Reshat Bardhi, Kryepeshkopi i Tiranës Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë Anastas Janullatos, Shkëlqesia e tij Monsinjor Rrok Mirdita, edhe në sajë të bashkëpunimit me konferencën botërore “Fetë për paqen”. Në këtë takim kanë qenë të pranishëm kryeministri Fatos Nano, funksionarë të lartë shtetërorë, funksionarë të trupit diplomatik të akredituar në Tiranë si dhe përfaqësuesit e konferencës botërore “Fetë për Paqen” me drejtoreshën e saj rajonale Emyli Kruniç. Po ashtu kjo nismë është mbështetur nga Ministria e Jashtme Gjermane. Në këtë deklaratë komunitetet fetare angazhohen për vazhdimin dhe promovimin e një atmosfere paqësore brenda komuniteteve dhe në asnjë rast të mos nxisin urrejtjen fetare ndaj njëri-tjetrit. Pak a shumë teksti është i ngjashëm në të gjitha gazetat, por në rastin konkret është gabuar kur thuhet katër fe në titull, sepse janë dy fe dhe katër komunitete. Muslimanë dhe të krishterë që i përkasin bektashinjve dhe sunitë; ortodoksë dhe katolikë.

22. E shtunë 19 mars 2005

gazeta “**Shekulli**”

“**Pajtimi si bazë e sigurisë**”, opinion, Mentor Nazarko (ish-këshilltar i presidentit Rexhep Meidani), fq. 1 me vazhdim në fq. 14.

Në këtë shkrim autori merr shkas nga nënshkrimi i deklaratës së përbashkët të katër krerëve të katër komuniteteve fetare tradicionale në vend si dhe kontekstit politik dhe social në të

cilën u nënshkrua kjo deklaratë. Vetëvrasja e disa adoleshenteve që mendohet të jetë shtyrë nga sekt i “Dëshmitarëve të Jehovait”, realizimi i një ligji që do të rregullojë marrëdhëniet e feve me shtetin, çështjet e sigurisë kombëtare, hapja e një universiteti musliman, si dhe vazhdimi i harmonisë dhe i tolerancës fetare janë marrë në shqyrtim në këtë shkrim nga autori. Po ashtu ky autor e sheh si pozitiv lëvizjet e bëra nga Komiteti Shtetëror i Kulteve me në krye z. Ilir Kulla. Pas këtyre konstatimeve të bëra nga ky autor, pra, të marrëdhënieve të shtetit me fetë, ai ngre si problem çështjen e integritetit të Shqipërisë, citojmë: “Kjo përbërëse e rrjedhës së zhvillimeve tona shoqërore lidhet në mënyrë vendimtare jo thjesht me imazhin e vendit i cili nuk është një fjalë goje, por me të gjithë zhvillimet integruese shqiptare dhe me sigurinë kombëtare. Nuk mund të përfshihesh në një organizim ndërkombëtar si BE i cili derimëtanë konsiderohet si klub i vendeve të krishtera, pa i dhënë drejtimin e duhur këtij procesi, pa zgjidhur në mënyrën më të drejtë disa prej problemeve në fjalë.” Në vazhdim ky autor ngre problemin se sektet fetare për mendjen e tyre ateiste përfaqësojnë në një farë mënyre lozha masonike, ku përqendrohet jo vetëm pushteti shpirtëror, por edhe ai ekonomik-financiar që i kapërcen kufijtë legalë shtetërorë. Më pas ky autor nënvizon faktin se shteti duhet të rregullojë me dinjitet raportet me bashkësitë fetare pa shkelur lirinë e besimit. Në aspektin e marrëdhënieve të shtetit, ai duhet të diferencojë marrëdhëniet e tij me fetë tradicionale dhe me fetë e reja që kanë hyrë pas hapjes së Shqipërisë. Ky autor e mbyll opinionin e vet me shqetësimin e sigurisë kombëtare, ku citojmë dy fjalitë e fundit: “Për më shumë që sot feja është bërë element thelbësor i lidhur me sigurinë e vendeve të veçanta, apo në përgjithësi e familjes së tyre. Sa më i vogël të jetë një vend, megjithë historinë e lavdishme të bashkëjetesës mes feve, aq më i madh është rreziku i faktorëve të tillë si terrorizmi.”

23. E shtunë 19 mars 2005

gazeta “Koha Jonë”

“Krerët e komuniteteve fetare, mesazh paqeje dhe besimi”, mbititull *“Nënshkruhet në kryeqytet Deklarata e Angazhimeve të Përbashkëta Morale”,* politikë, pa autor, fq. 6.

Në këtë shkrim i bëhet jehonë faktit të nënshkrimit të marrëveshjes së katër komuniteteve fetare tradicionale në Shqipëri e quajtur “Deklarata e Angazhimeve të Përbashkëta

Morale. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga katër krerët e këtyre komuniteteve, kryetari i Komunitetit Musliman Shqiptar H. Selim Muça, Kryegjyshi Botëror i Kryegjyshit Bektashianë H. Dede Reshat Bardhi, Kryepeshkopi i Tiranës Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë Anastas Janullatos, Shkëlqesia e tij Monsinjor Rrok Mirdita, edhe në sajë të bashkëpunimit me konferencën botërore “Fetë për paqen”. Në këtë takim kanë qenë të pranishëm kryeministri Fatos Nano, funksionarë të lartë shtetërorë, funksionarë të trupit diplomatik të akredituar në Tiranë si dhe përfaqësuesit e konferencës botërore “Fetë për Paqen” me drejtoreshën e saj rajonale Emyli Kruniç. Po ashtu kjo nismë është mbështetur nga Ministria e Jashtme Gjermane. Në këtë deklaratë komunitetet fetare angazhohen për vazhdimin dhe promovimin e një atmosfere paqësore brenda komuniteteve dhe në asnjë rast të mos nxisin urrejtjen fetare ndaj njëri-tjetrit.

24. E shtunë 19 mars 2005

gazeta “**Korrieri**”

“**Firmoset paqja fetare**”, politikë, S.P., fq. 5.

Në këtë shkrim i bëhet jehonë faktit të nënshkrimit të marrëveshjes së katër komuniteteve fetare tradicionale në Shqipëri e quajtur “Deklarata e Angazhimeve të Përbashkëta Morale. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga katër krerët e këtyre komuniteteve, kryetari i Komunitetit Musliman Shqiptar H. Selim Muça, Kryegjyshi Botëror i Kryegjyshit Bektashianë H. Dede Reshat Bardhi, Kryepeshkopi i Tiranës Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë Anastas Janullatos, Shkëlqesia e tij Monsinjor Rrok Mirdita, edhe në sajë të bashkëpunimit me konferencën botërore “Fetë për paqen”. Në këtë takim kanë qenë të pranishëm kryeministri Fatos Nano, funksionarë të lartë shtetërorë, funksionarë të trupit diplomatik të akredituar në Tiranë si dhe përfaqësuesit e konferencës botërore “Fetë për Paqen” me drejtoreshën e saj rajonale Emyli Kruniç. Po ashtu kjo nismë është mbështetur nga Ministria e Jashtme Gjermane. Në këtë deklaratë komunitetet fetare angazhohen për vazhdimin dhe promovimin e një atmosfere paqësore brenda komuniteteve dhe në asnjë rast të mos nxisin urrejtjen fetare ndaj njëri-tjetrit.

25. E shtunë 19 mars 2005

gazeta "Dita"

"Katër fetë, angazhim për një moral", shoqëria, pa autor, fq. 13.

Në këtë shkrim i bëhet jehonë faktit të nënshkrimit të marrëveshjes së katër komuniteteve fetare tradicionale në Shqipëri e quajtur "Deklarata e Angazhimeve të Përbashkëta Morale. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga katër krerët e këtyre komuniteteve, kryetari i Komunitetit Musliman Shqiptar H. Selim Muça, Kryegjyshi Botëror i Kryegjyshatës Bektashiane H. Dede Reshat Bardhi, Kryepeshkopi i Tiranës Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë Anastas Janullatos, Shkëlqesia e tij Monsinjon Rrok Mirdita. Në ndryshim nga shkrimet e tjera, në këtë rast i është bërë jehonë më tepër fjalës së kryeministrit të vendit Fatos Nano. Në këtë deklaratë komunitetet fetare angazhohen për vazhdimin dhe promovimin e një atmosfere paqësore brenda komuniteteve dhe në asnjë rast të mos nxisin urrejtjen fetare ndaj njëri-tjetrit. Në rastin konkret është gabuar kur thuhet katër fe në titull, sepse janë dy fe dhe katër komunitete. Muslimanë dhe të krishterë që u përkasin bektashinjtë dhe sunitë; ortodoksë dhe katolikë.

26. E shtunë 19 mars 2005

gazeta "55"

"Komunitetet fetare të bashkuar për tolerancën", forum, Ervin Koçi, fq. 8.

Në shkrimin e tij autori i bën një përmbledhje frymës së tolerancës fetare që e karakterizon vendin tonë. Aty flitet më tepër për angazhimet që morën drejtuesit e të katër komuniteteve për të ruajtur frymën e bashkëpunimit dhe të tolerancës fetare. Drejtuesit e lartë të komuniteteve i kanë kërkuar autoriteteve shtetërore hartimin e rezolutës mbi statusin ligjor të komuniteteve fetare si dhe kthimin e pronave të shtetëzuara apo të konfiskuara në të kaluarën. Po ashtu një problem shqetësues që është ngritur në këtë takim është, citojmë nga shkrimi: "Në këtë takim, nga ku ka dalë dhe deklarata e përbashkët mbi tolerancën dhe predikimin fetar, është vënë theksi edhe në veçimin e të gjitha atyre komuniteteve pseudofetare, që përhapnin në të vërtetë predikime të mbrapshta, dalime, mostolerancë dhe deri në frymë terroriste."

27. E enjte 24 mars 2005

gazeta "55"

"Blasfemitë e Selman Ruzhdiut dhe sikleti i Toni Blerit", marrë nga "Il Foglio" 23 mars 2005, fq. 6.

Në këtë shkrim me gjithë të metat e shumta që vërehen në përkthim, paraqitet nga njëra anë Selman Ruzhdiu si një sfidues dhe një njeri i botës dhe nga ana tjetër Toni Bleri, i cili po ballafaqohet me problemet etiko-fetare të shoqërisë angleze. Nga njëra anë kemi një ateist si Selman Ruzhdiu, i cili një pjesë të famës së vet e gëzon nga fetvaja ku urdhërohej vrasja e tij nga Ajatollah Khomeini. Citojmë: "E vumë re edhe ne, kur u detyruam të mbajmë radhë për dy orë me radhë për ta dëgjuar në Nju Jork, duke kapërcyer kontrole të rrepta, teksa viktimat e "fatwa"-ve islamiste shfaqej i irrituar me tejkalimin e kompetencave nga policia pas 11 shtatorit."

28. E premte 25 mars 2005

gazeta "TemA"

"Jugosllavët, nën tryshninë e armiqësive të Luftës II Botërore", mbittitull *"Dossier i jashtëzakonshëm: CIA dhe Kosova: Raportet sekrete të CIA-s të periudhës 1970-1992 (35)"*, fq. 12-13.

Në këto dy faqe të këtij dosieri ka tre nën-çështje që flasin për gjendjen në Bosnje, Kosovë dhe Faktorin Mysliman. Në dy çështjet e para paraqitet me hollësi gjendja e nderë që karakterizon këto dy vende të rëndësishme muslimane dhe përplasjet që u krijuan nga serbët pas fillimit të procesit të shpërbërjes së Federatës Jugosllave. Por shqetësimi më i madh në këtë raport del nga Faktori Mysliman, citojmë dy fjalitë e para të kësaj teme: "Një kërcënim islamik që shtrihet tej komunitetit shqiptarë dhe i cili përfshin myslimanët sllavë dhe turqit, është një ankth madje edhe më alarmues për serbët. Shqetësimet serbe rreth konspiracionit islamik ndërkombëtar, për të krijuar një 'oazë të gjelbër' në qendër të Jugosllavisë, janë duke dominuar në perceptimet dhe politikat aktuale". Më pas dosieri vazhdon duke cituar faktin se Kuvendi Suprem Mysliman me shumë vonesë ka kritikuar Serbinë për të drejtat e shkelura të myslimanëve dhe apeloj te të gjithë myslimanët anembanë botës që të tregojnë solidaritetet me shqiptarët e Kosovës.

Muaji **prill** 2005

29. E premte 1 prill 2005

gazeta “Express”

“Tirana, së shpejti me “Kullën e rojes”, investigimi, Fabiola Bramo – Bledi Gila, fq. 2-3.

Në këtë shkrim të këtyre autorëve i bëhet jehonë faktit për ndërtimin e një ndërtese në një hapësirë të madhe prej 5.000 m² nga ana e “Dëshmitarëve të Jehovait” në periferi të Tiranës. Ky shkrim është përgatitur në dy faqe dhe jepen zhvillimet e fundit dhe akuzat që i janë bërë këtij sektit në shtyp dhe në mediat elektronike për vetëvrasjet. Po ashtu njoftohet se ky sekt është i ndaluar edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kështu jepen katër rastet dhe emrat e atyre që kanë kryer vetëvrasje dhe që dyshimet u janë hedhur “Dëshmitarëve të Jehovait”. Citojmë nga shkrimi: “Ky rast inicioi hetimin zyrtar ndaj ideologjisë së sekteve fetare, pasi dyshohet që literaturat e tyre t’i shtyjnë frekuentuesit në vetëvrasje. Pjesëmarrës në hetime është edhe zyra e antiterrorit në Ministrinë e Rendit Publik.”

30. E premte 1 prill 2005

gazeta “Metropol”

“Gjendet i vrarë myftiu në një kanal”, mbititull “Pranë tij gjendet një çallmë e bardhë. Ekspertët: Viktima ka 12 ditë i vdekur”, kronikë, Mariglen Mullai, fq. 7.

Ky shkrim i takon faqes së kronikës dhe i dedikohet gjetjes së një kufome. Me titullin është abuzuar sepse nuk jepet asnjë informacion për identitetin e të vdekurit. Spekullohet me çallmën e gjetur pranë tij dhe disa letra të shkruara në arabisht sipas autorit të shkrimit. Për të shkaktuar sa më tepër zhurmë me këtë shkrim, autori ka futur në lojë idenë se i vdekuri mund të jetë një figurë e lartë e Komunitetit Musliman, citojmë: “Të dhënat operative flasin për mundësinë se kufoma i përket një zyrtari të lartë të fesë myslimane, ndërsa hetimet janë shtrirë menjëherë në të gjitha pikat kyçe, ku përmendet verifikimi i të gjithë anëtarëve të Komunitetit Mysliman apo të rinjve, përfaqësues të rrymës së re myslimane, me qendër në xhaminë e “Rrugës së Kavajës”. Të habit fakti se sa shpejt bëhen lidhjet dhe i mëshohet faktit për xhaminë e “Rrugës së Kavajës”. Po

ashtu një përmbledhje e shkurtër bëhet për vrasjen tre vjet më parë të Sali Tivarit: “Tre vjet më parë vritet kreu i Komunitetit Mysliman”.

31. E shtunë 9 prill 2005

gazeta “Express”

“Qeveria në gjumë për akuzat e “terrorizmit shqiptar””, speciale, pa autor, fq. 11.

Në këtë speciale flitet për faktin e publikimit të një raporti të bërë nga Instituti i Stratfordit në SHBA, ku jepet alarmi për të ashtuquajturin terrorizëm i “Islamit të Bardhë”, nga shqiptarët e Kosovës. Akuzat antishqiptare në këtë raporte flasin për atentate terroriste kundra shteteve të ndryshme evropiane dhe Izraelit. Këto akuza sipas këtij shkrimi janë hiperbolizuar nga gazetarët grekë në SHBA. Ndërkaq po sipas shkrimit këto akuza janë injoruar nga Departamenti Amerikan i Shtetit. I ashtuquajturi Institut i Stratfordit thuhet se është i lidhur me CIA-n amerikane dhe nuk thuhet se kush janë burimet e këtij raporti. Për këto fakte është pyetur nga gazetarët në një konferencë për shtyp, Riçard Busher, zëdhënës i Departamentit të Shtetit, i cili është përgjigjur, citojmë sipas shkrimit: “Zëdhënësi Boucher ka deklaruar se nuk mund të komentojë çfarëdo raporti kërkimor të këtij instituti”. Në rreshtat e këtij shkrimi artikullshkruesi kërkon prej qeverisë shqiptare të reagojë ndaj këtyre akuzave, edhe për faktin se shërbimet tona sekrete kanë bashkëpunuar me CIA-n amerikane në kapjen e terroristëve islamikë në Shqipëri. Citojmë: “Operacionet e tyre në të gjitha rastet janë asistuar edhe nga shërbimi ynë sekret, ndonëse prania e ndonjë elementi terrorist nuk mund të përfaqësojë komunitetin mysliman shqiptar. Identifikimi i ekstremistëve shqiptarë me religjionet nga media të ndryshme të huaja, duket se kanë si qëllim njollosjen e Shqipërisë dhe të shqiptarëve dhe krijimin e një imazhi tjetër për shqiptarët, ...”.

32. E hënë 11 prill 2005

gazeta “Metropol”

“Shqiptarocentrizmi” i Hysamedin Ferajt është Islamocentrizëm”, polemikë, Kastriot Myftaraj², fq. 12-13.

Në këtë shkrim polemizues autori ndërmer të vendosi shenjën e barazimit midis shqiptarocentrizmit dhe islamocentrizmit,

² Për prejardhjen dhe punësimin e këtij personi nuk dihet asgjë e sigurt zyrtarisht. Për më tepër flitet që pas emrit të tij fshihen të tjerë. Vitin që shkoj ky person u akuzua përpara Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës si person që nxit urrejtjen ndërfetare (2004).

terma këto të sajua nga ky artikullshkrues. Duke mos pasur kualifikimin e duhur edhe interpretimet e bëra në këtë shkrim janë të cekëta dhe të pabaza. Për problemin e xhizjes si dhe probleme të tjera historike, historiografia nuk e ka dhënë versionin e saj përfundimtar, po ashtu edhe për bazën e tyre ideologjike. Kuptohet që këtij autori nuk i shërben libri i Ferajt dhe veprimtaria e tij si shkak për të sulmuar atë vetë, por kërkon të hedhë baltë mbi historinë osmane dhe të Islamit. Po ashtu kjo gjë shihet qartë në keqpërdorimin që i bën ajeteve kuranore. Ky person vazhdon të përdori tezat e historiografisë komuniste, e cila e ka shpallur Perandorinë Osmane si një shtet që i solli veç të këqija shqiptarëve. Pra, ky person vazhdon t'i shohi gjërat në skemën bardhë e zi të ndërtuar nga strukturat e deridjeshme komuniste. Me habi vërehet se disa gazeta vazhdojnë t'i hapin dyert këtij personi që fsheh me një xheloz të rreptë të shkuarën e tij dhe përgatitjen që ka marrë. Ai e quan dr. Hysamedin Ferajn avokat të Islamizmit, kur akoma nuk është vërtetuar që të ketë pasur shtrëngim nëpërmjet taksës së xhizjes, citojmë nga shkrimi: “Duke dashur që të mbrojë teorinë e vet politike, Feraj në librin e vet mbron islamizimin e shqiptarëve, duke i bërë një avokaturë të zjarrtë xhizjes, taksës speciale që përdornin turqit ndaj të krishterëve, për t'i shtrënguar ata që të konvertoheshin në fenë islame.”

33. E hënë 11 prill 2005

gazeta “Metropol”

“Në një botë edhe më të ndarë”, mbititull: “*Si mund të gjendet një papë për të gjithë katolikët?*”, bota speciale, the economist, fq. 20-21.

Në këtë shkrim të marrë në një nga gazetatat më në zë të botës, anglezja “the economist”, jepen shumë variante për pasuesin e papës së vdekur Gjon Pali II. Në njërin nga çështjet e trajtuara janë edhe “Marrëdhëniet me myslimanët”. Sillet fakti që ky papë ka bërë përpjekje për të mbajtur të hapur dialogun ndërmjet të krishterëve dhe muslimanëve, citojmë: “Ndihet se me intuitën dhe energjinë e tij, Papa Gjon Pali II, çoi deri në limit dialogun kristiano-mysliman: në Marok, Damask, dhe në Kazakistan, ai theksoi vendosmërinë e Kishës për të shmangur çdo lloj “përplasje qytetërimesh” mes dy besimeve”. Më pas në vijim jepen edhe disa kandidatura të mundshme për zëvendësimin e këtij pape pas vdekjes, si dhe gjendjen e politikës ndërkombëtare.

34. E hënë 11 prill 2005

gazeta “Koha Jonë”

“Falsifikimi, mbledhje për shkarkimin e sekretarit të myslimanëve”, kronika, A.Q, fq. 6.

Me këtë shkrim i bëhet e ditur publikut fakti i falsifikimit të diplomave nga sekretari administrativ i Komunitetit Musliman Shqiptar, Zylyftar Dervishi. I bëhet një përmbledhje nga artikullshkruesi si dhe përmendet një dokument zyrtar i KMSH-së, ku i referohen fakteve të këtij dokumenti se në përfundim të verifikimit ka rezultuar se ky person ka vetëm diplomën e shkollës së mesme. Citojmë nga shkrimi: “Në listëne e studentëve të “Al-Hagrit”, 54-vjeçari nuk ka figuruar, ndërsa të dyja diplomat, përveç dëftesës së shkollës së mesme kanë qenë të falsifikuara. Ky fakt ka sjellë reagimin e menjëhershëm të anëtarëve të komisionit, duke njoftuar edhe kryesinë e Komunitetit Mysliman.” Në një kuti të veçantë flitet edhe për dyshimet që ka pasur në përzierjen për vrasjen e Sali Tivarit, e titulluar: “Nga i dyshuar, në pasardhës të Sali Tivarit”.

35. E mërkurë 13 prill 2005

gazeta “Shekulli”

“Në Bashkësinë Islame jo shoqatat ekstremiste”, ngjarje e ditës, Lindita Çela, fq. 2.

Në këtë shkrim flitet për ndryshimin e emrit të Komunitetit Musliman Shqiptar në Bashkësia Islame e Shqipërisë në mbledhjen e radhës të Këshillit të Përgjithshëm Drejtues të KMSH, si dhe jepet ndryshimi i nenit përkatës të statutit të këtij komuniteti, si ishte dhe si do të jetë. Po ashtu jepet një intervistë me kryetarin e KMSH-së H. Selim Muça, pikërisht për këtë problem si dhe synimet që neni i sapo-ndryshuar të përfshijë edhe tarikatet e tjera muslimane ekzistuese në Shqipëri. Citojmë nga intervista: “Por ju duhet të keni parasysh që ky është vetëm një bashkim shpirtëror, sepse këto sekte do të vazhdojnë të kenë administratën dhe drejtuesit e tyre. **“Bektashinjtë: Ritet tona, krejt të ndryshme nga myslimanizmi”,** po në të njëjtën faqe. Në këtë pjesë jepen qëndrimet zyrtare të Komunitetit Bektashi nëpërmjet sekretarit të përgjithshëm të Kryegjyshitës Botërore të Bektashinjve, Kujtim Ahmetaj. Sipas tij nuk ka asnjë marrëveshje që në Bashkësinë Islame do të përfshihen edhe bektashinjtë. Citojmë nga shkrimi: “E vetmja gjë që na lidh me Komunitetin Mysliman është besimi në Kuran dhe tek Profeti. Por kjo nuk do të thotë që ne të përfshihemi brenda strukturave të këtij Komuniteti”-thotë Kujtim Ahmetaj”.

36. E mërkurë 13 prill 2005

gazeta “Albania”

“Debatet nuk përbëjnë ndonjë hata”, “Reformatorët dhe tradicionalët, përplasjet mes myslimanëve”, “Zylyftar Dervishi: “Duan të më heqin qafe””, speciale, Bejdo Malo, fq. 12-13.

Në këto dy faqe të kësaj specialeje nëpërmjet dy intervistave dhe një shkrimi analitik autori është munduar të japi gjendjen në të cilën ndodhet KMSH pas mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm Drejtues të këtij institucioni përfaqësues të myslimanëve. Në pjesën e parë është intervistuar drejtori i kulturës Dorian Xhameta për debatet e brendshme që ekzistojnë brenda Komunitetit si dhe dy rrymat dominuese, të ashtuquajturat tradicionale dhe reformatore, emërtime të cilat janë më se të pranueshme. Në shkrimin analitik **“Reformatorët dhe tradicionalët, përplasjet mes myslimanëve”** i është bërë një përmbledhje e gjendjes kritike në të cilën ndodhet Komuniteti Musliman dhe në fund të saj autori thotë me të drejtë, citojmë: “Ai që ka mbetur më pas nga besimet fetare në Shqipëri është myslimanizmi, pasi identiteti i tij është ende shumë i paqartë”. Në faqen 13 vazhdohet me intervistën e titulluar **“Zylyftar Dervishi: “Duan të më heqin qafe”**. Ky funksionar drejtues pasi është akuzuar për falsifikim diplomash, mundohet që në këtë intervistë të japi versionin e tij për akuzat që i bëhen dhe jep argumente se me punën e tij e ka përmirësuar gjendjen financiare të KMSH-së.

37. E hënë 18 prill 2005

gazeta “Koha Jonë”

“Futet në votime partia myslimane”, zgjedhjet 2005 thirrja, Amir Shehu, fq. 3.

Në këtë shkrim flitet për partinë myslimane me kryetar Artan Shaqirin, ish-myftiu i Lezhës që pretendon të hyjë në zgjedhjet e vitit 2005 dhe të radhitet si forca e tretë në vend pas PS dhe PD. Citojmë nga shkrimi: “Me të vërtetë që jemi parti e re politike, pasi kanë shumë muaj që me zor na jepnin viston në gjykata, por tashmë jemi realitet ligjor dhe politik”, tha dje për KJ Artan Shaqiri...” Në këtë shkrim flitet dhe për hartën elektorale si dhe mënyrat e punës së kësaj partie, e cila pretendon të marrë 15% të votave. Votuesit e saj do të jenë në ato zona ku ka shumicë myslimane në fshat dhe në qytet.

38. E mërkurë 20 prill 2005

gazeta “Republika”

“Dervishi: Nuk kemi lidhje me asnjë parti politike”, “Komuniteti Musliman distancohet nga partia islamike “Atdheu”, “Kryetari i partisë “Atdheu”, ish-myfti i përjashtuar nga komuniteti”, politikë, Eljona Ballhysa, fq. 5.

Kjo është një intervistë me sekretarin e KMSH-së, Zylyftar Dervishin, për partinë “Atdheu” dhe kryetarin e saj Artan Shaqiri. Në këtë intervistë për këtë gazetë, sekretari Dervishi distancohet totalisht nga ky individ dhe kjo parti, citojmë: **“Komuniteti Musliman Shqiptar nuk ka lidhje me asnjë parti politike. Nuk ka lidhje me asnjë organizatë që kërkon, në emër të islamit, të flasë dhe të ushtrojë aktivitet politik”. Po ashtu sekretari Dervishi e cilëson kryetarin e kësaj partie si i përjashtuar si individ i padenjë për strukturat e KMSH, citojmë nga intervista: “..., por aktualisht është i përjashtuar nga Komuniteti Musliman si myfti, si predikues, për arsyet që ai i di shumë mirë, si një njeri jo i denjë për Komunitetin Musliman.”**

39. E enjte 21 prill 2005

gazeta “Albania”

“Vrasja e Tivarit, policia dërgon në prokurori prova të reja”, aktualitet, Andi Myrte, fq. 8.

Në këtë shkrim flitet për prova të reja që i janë furnizuar prokurorisë rreth vrasjes së ish-sekretarit të KMSH-së, Sali Tivari. Këto prova janë furnizuar së fundmi nga efektivitë i Komisarariatit nr. 1 të Tiranës. Citojmë nga shkrimi: **“Burime nga policia dhe prokuroria thanë për gazetën “Albania” se bazuar në këto materiale (informacione, dëshmi të administruara nga efektivët e Komisarariatit nr. 1 të policisë në Tiranë), Prokuroria e Rrethit Tiranë vendosi të rifillojë verifikimet dhe hetimet përkatëse për zbulimin e ekzekutorëve të numrit dy të Komunitetit Mysliman, Sali Tivari”. Janë disa pista ku hetohet, por më e mundshmja është ajo e pronave të KMSH-së, për të cilat i vrari ka qenë përgjegjës. Po ashtu në këtë faqe është edhe një shkrim tjetër përmbledhës me titull: **“Si u ekzekutua numri dy i Komunitetit Mysliman”**, ku hidhet faji mbi edhe paaftësinë e hetuesve për të mbledhur provat materiale në vendngjarjen e krimit. Citojmë: **“Këtyre konstatimeve iu shtua edhe mungesa e profesionalizmit të inspektorëve të policisë, të cilët kryen procedurat e para hetimore për këtë krim”.****

40. E Diel 21 prill 2005

gazeta "Albania"

**"Si e shpallën autonominë bektashinjtë në vitin 1929",
"Baballarët bektashinj kundër Komunitetit Mysliman",**
speciale, Bejdo Malo, fq. 12-13.

Në shkrimin e parë jepet një përmbledhje e shkëputjes historike që ndodhi ndërmjet bektashinjve që u vendosën në Shqipëri dhe atyre që mbetën në Turqi, dhe se si u formua Kryegjyshata Botërore e Bektashinjve në Tiranë me ndihmën edhe të pushtetit të atëhershëm. Jepen edhe disa të dhëna të përgjithshme mbi besimet e bektashinjve, si dhe për festat e tyre. Citojmë nga shkrimi: "Në vitin 1922, një kuvend me delegatë të teqeve, vendosi shkëputjen nga autoriteti i Bektashit Epror të Ankarasë (i cili vetë ishte shqiptar) dhe Tirana u bë selia botërore e këtij komuniteti". Ndërsa në shkrimin tjetër trajtohet ndërrimi i një neni të statutit të KMSH-së si dhe reagimet e drejtuesve të bektashinjve, të cilët deklarojnë publikisht që janë kundër përfshirjes së tyre në strukturat e KMSH-së. Aty jepet deklarata e Baba Mondit, numri 2 i bektashinjve, citojmë: "Ne përfaqësojmë Kryegjyshit Botërore dhe në këto kushte nuk kemi arsye të bashkohemi me Bashkësinë Islame. Ne e kemi emrin Komuniteti Bektashian Shqiptar dhe ata e kanë Komuniteti Mysliman Shqiptar. Janë dy emërtime krejtësisht të ndryshme", vazhdoi ai". Po ashtu në këtë shkrim autori i referohet edhe përplasjeve të brendshme në KMSH dhe përpjekjeve për të larguar sekretarin e përgjithshëm, Zylyftar Dervishi.

41. E premte 29 prill 2005

gazeta "Dita"

"Kryqi i Fikasit, kisha padit komunën", kronikë, Fatbardha Nergjoni, fq. 8.

Ky shkrim flet për vendimin e Komunës së Bradasheshit për të hequr një kryq të vendosur nga Kisha Ortodokse përgjatë rrugës nacionale Tiranë-Elbasan. Ky vendim erdhi pas reagimit të Komunitetit Musliman, të cilët e cilësuan praninë e kryqit si lëndim të ndjenjave të besimtarëve. "Pas disa takimeve midis përfaqësive të komuniteteve fetare dhe Komunës së Bradasheshit, u vendos me konsensus që kryqi të zhvendosej në afërsi të rrënojave të kishës". Por pas pak kohësh sipas autorit të këtij shkrimi Kisha Ortodokse ka ndërruar mendim për kryqin dhe ka paditur Komunën, ku seanca e parë gjyqësore

që do të zhvillohej më 28 prill është anuluar për mosparaqitjen e palëve.

42. E premte 29 prill 2005

gazeta “Express”

“**Terrorizmi, vazhdon të kërcënojë botën**”, speciale, pa autor, fq. 7.

Në këtë shkrim flitet për publikimin e raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit për listën e organizatave terroriste nëpër botë. Ky shkrim bën me dije se rreziku nga terrorizmi vazhdon. Në një kuti është vendosur lista e organizatave terroriste të shpërndara nëpër botë. Po ashtu në një titull të posaçëm flitet edhe për Shqipërinë. “**Shqipëria, masa kundër terrorizmit**”. Këtu flitet për masat e marra nga qeveria shqiptare në vitin 2004 ndaj organizatave të dyshuara islamike për terrorizëm.

43. E premte 29 prill 2005

gazeta “Shekulli”

“**Dy djem më thanë se po të vetëvarem do të ringjallem**”, kronikë, Vladimir Muçaj, fq. 7.

Në këtë shkrim flitet për dy persona që janë paraqitur si anëtarë të sektit “Dëshmitarët e Jehovait” dhe kanë shpërndarë disa letra ku ju kërkohej nxënësve të shkollës së fshatit Libofshë në Fier, të vrisnin veten për t’u ringjallur në Ditën e Pashkëve. Në këtë letër të shpërndarë përmbaheshin edhe kërcënime për nxënësit nëse nuk do të vetëvriteshin, do t’i vrisnin, citojmë nga shkrimi: “Nxënësi, sipas informacionit që ka dhënë drejtoresha, ka thënë se dy personat i kishin dhënë një copë litar, rreth 2-3 m, të mbështjellë, një fletushkë me mbishkrimin, “Jehovai, kur të vritesh do të ringjallesh ditën e Pashkës. Po s’u vare do të varim ne dhe ti nuk do të ringjallesh”. Po ashtu në këtë faqe është vendosur edhe një deklaratë për shtyp e “Dëshmitarëve të Jehovait” të Shqipërisë.

44. E shtunë 30 prill 2005

gazeta “Panorama”

“**Nga trafikant droge në besimtarin që ndërtoi xhaminë**”, aktualitet, Gëzim Hajdini, fq. 2.

“**Bombat me celularë, vriten 2 islamikët**”, aktualitet, (t.s), fq. 3.

Këto dy shkrime i referohen një ngjarjeje të rëndë të ndodhur në Baltëz të Fierit, ku gjetën vdekjen aksidentalisht dy besimtarë muslimanë, Pëllumb Reshlani 33-vjeç dhe Armando

Duraj 20-vjeç. Në këto dy faqe jepet ngjarja se si ka ndodhur dhe më pas hidhen dyshimet se tritoli i gjetur (sasia 700 gram) në shtëpinë e të vrarëve do të përdorej për atentate terroriste. Në faqe 2 jepet deklarimi i drejtorit të policisë së Fierit, Sokol Kalani, që thotë, citojmë nga shkrimi: “Tritoli ka shpërthyer aksidentalisht... Mendoj se lënda plasëse duhej për ndonjë hakmarrje të tyre personale dhe jo ajo që përflitet për kulte fetare dhe vende të populluara”. Kjo deklaratë gjendet në faqe 2, ndërsa në faqen pasuese, abuzohet qysh në nëntitull ku thuhet: “Hetuesit: Mina do përdorej ndaj kishës në hyrje të Fierit”. Fatkeqësisht në rreshtat në vijim hidhen dyshime të “bazuara” po në policinë e Fierit se “Ka prova për të besuar se tritoli përgatitej të shpërthente ditën e festës së Pashkëve, në kishën që ndodhet në hyrje të Fierit”.

45. E shtunë 30 prill 2005

gazeta “Gazeta Shqiptare”

“Hoxha” i fshatit, prodhues bombash”, “Shpërthimi aksidental në Fier, vdesin dy atentatorët”, aktualitet, Irma Hoxha, fq. 7.

Edhe në këtë shkrim flitet për vrasjen aksidentale të të dy besimtarëve muslimanë Pëllumb Reshlani 33-vjeç dhe Armando Duraj 20-vjeç³. Pasi jepet dinamika e ngjarjeve edhe në këtë shkrim hidhet dyshimi për akte ekstremiste nga ana e të dy të vrarëve. Citojmë nga shkrimi: “Madje, përfaqësuesit e Akuzës kanë dyshuar fillimisht dhe po hetojnë për ndonjë akt ekstremistësh”. Kjo gazetë i është referuar çuditërisht Krimeve të Rënda të Tiranës dhe jo burimeve policore në vend.

³ Për këtë ngjarje kanë shkruar pothuajse të gjitha gazetat e përditshme, si: Shekulli, Albania, Koha Jonë, Korrieri, Republika, Metropol, Ballkan, Dita, Express dhe Gazeta Shqiptare. Korrieri, Metropol dhe Gazeta Shqiptare e kanë hapur faqen e parë me fotografinë e 20-vjeçarit Armando Duraj dhe me tituj të mëdhenj.

Muaji Maj 2005

46. E diel 1 maj 2005

gazeta “Koha Jonë”

“Kryepolici Kalani: Objekti i sulmit nuk ka qënë kisha”, “Drejtori i Fierit deklaroi shpërthimin aksidental të tritolit, ku mbetën viktimat Pëllumb Reshlani dhe Armando Duraj”, Ngjarja-Pistat, G. Ruko, fq. 2.

Në këtë shkrim pasi njoftohet për ngjarjen tragjike të ndodhur një ditë më parë ku humbën jetën dy të rinjtë muslimanë Pëllumb Reshlani dhe Armando Duraj, menjëherë bëhet i ditur lajmi se vdekja e tyre ka qënë thjesht aksidentale dhe jo prej një mine të aktivizuar nga celularë. Për këtë jepet deklarata e prerë e drejtorit të policisë së Fierit Sokol Kalani si dhe e ekspertizës së bërë nga ekspertët kriminalistë të kësaj drejtorie. Drejtori Kalani ka përgënjeshtuar të gjitha kronikat e shtypit që i referoheshin ngjarjes si një bombë me celular e shpërthyer rastësisht. Citojmë deklaratën e drejtorit Kalani nxjerrë nga ky shkrim: “Lënda shpërthyesë që u mori jetën dy të rinjve, natën e të enjtes, në një fshat të Fierit, nuk ka qënë e aktivizuar nga një aparat telefoni celular”.

47. E diel 1 maj 2005

gazeta “Korrieri”

“Islamiku “kamikaz”, student në Egjipt”, ngjarje dite, XH.B, fq. 2.

Në këtë shkrim flitet për masat e marra nga ana e policisë për të siguruar qetësinë për kremtimet e Pashkëve ortodokse në Fier. Kësaj ngjarjeje i kundërvihet vrasja aksidentale e një dite më parë e dy të rinjve muslimanë dhe hidhet dyshime për atentate nga këta dy persona. Ndërkaq një theks i veçantë i vihet faktit se Armando Duraj ka qënë disa muaj për studime në një vend arab (Egjipt) për të mësuar riparimin e celularëve. Po ashtu përmendet edhe fakti që shumë muslimanë në vend zotërojnë dyqane celularësh. Ndërkaq mungojnë deklaratat e drejtorit të policisë Kalani se tritoli i shpërthyer nuk është aktivizuar nga ndonjë celular.

46. E diel 1 maj 2005

gazeta “Gazeta Shqiptare”

“**Bomba u përgatit për një zyrtar⁴**”, “*Kërcënimi se bllokoi ekstremistët në komunitet*”, faqja e parë, re.kro., fq. 3.

“**Përplasja mes dy rrymave te muslimanët**”, faqja e parë, re.kro., fq. 2.

Në rreshtat e shkrimit të parë hidhet ideja sipas burimeve shtetërore se objekt sulmi mund të ishte një zyrtar i administratës së lartë shtetërore nga ana e dy të rinjve muslimanë që gjetën vdekjen aksidentalisht nga shpërthimi i tritolit. Kjo për arsye se ky zyrtar shtetëror dhe një tjetër i Komunitetit Musliman janë bërë pengesë ndaj rrymës vehabite për ndryshime në statutin e Komunitetit. Kjo gazetë citon burime nga Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH) se të ashtuquajturat mina që po përgatisnin e kishin shënjestrën të përcaktuar. Megjithë deklaratat e policisë së Fierit dhe të drejtorit të saj, Kalani, gazetari ngulmon se këto janë mina në distancë, citojmë nga shkrimi: “Megjithëse policia e Fierit i përmbahet deklaratës se Duraj e Reshlani nuk përgatisnin mina me celular apo të komanduara në distancë, materialet e gjetura në shtëpinë e këtij të fundit tregojnë tjetër gjë”.

Në njërën nga dy faqet e dedikuara flitet për përplasjen e dy rrymave kryesore, sipas autorit të shkrimit, asaj të të vjetërve të moderuar Hanefi dhe të rinjve që i mbështeten një tradite të rreptë Vehabi. Flitet edhe për të rinjtë e shkolluar jashtë vendit si dhe për vrasjen e ish-sekretarit të KMSH-së Sali Tivari. Po ashtu citohet edhe deklaratat e Departamentit Amerikan të Shtetit se Shqipëria s’përbën rrezik terrorist.

47. E diel 1 maj 2005

gazeta “Panorama”

“**Minat me celular, hetohet për qendër ekstremiste⁵**”, “**Frikë nga atentati për Pashkë blindohet kisha e Shëngjergjit**”, aktualitet, pa autor, fq. 11.

Në këtë shkrim hidhen dyshime nga artikullshkruesi se të ashtuquajturat me celular ishin të destinuara për kishën ortodokse të Fierit. Po ashtu citohen burime të Prokurorisë së rrethit dhe nga Krimet e Rënda se po hetohet për një rrjet të

⁴ Ky titull paralajmërohet me gërma të mëdha qysh në faqe të parë i shoqëruar me një fotografi të xhamisë së re të ndërtuar në Fier.

⁵ Ky shkrim paralajmërohet qysh në faqe të parë me një fotografi të Armando Duraj, por me një titull dhe mbititull tjetër: “Minat për kishën, dy viktimat kishin lidhje me fundamentalistët”, “Frika për ditën e Pashkës. Policët blindojnë kishën e Shën Gjergjit”.

mundshëm personash ekstremistë. Po ashtu në këtë shkrim flitet edhe për mundësinë e lidhjeve ndërkombëtare. Vazhdimisht këmbëngulet në këtë shkrim për versionin e hedhur nga autori, megjithëse ai citon shefin e policisë së Fierit, Naun Doko, kur thotë për masat e marra nga policia për ruajtjen e rendit në festën e Pashkës se, citojmë: “Ky është organizimi i punës sonë për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike dhe nuk ka lidhje prania e policisë me ngjarjen e Baltëzës”. Po ashtu injorohet në këtë shkrim deklarata e drejtorit të policisë së Fierit, Sokol Kalani, se shpërthimi i tritolit ku gjetën vdekjen dy të rinjtë nuk ka ardhur nga celulari.

48. E diel 1 maj 2005

gazeta “Albania”

“Do të fusim në shkolla Kur’anin dhe ferexhenë⁶”, speciale, Bejdo Malo, fq. 8-9.

Në këtë speciale jepen fillimisht sqarime për Partinë Shqiptare Atdheu, formimin e saj dhe tendencat islame që paraqet kryetari i kësaj partie Artan Shaqiri. Më pas jepet me hollësi një bisedë e zhvilluar nga gazetari me këtë person ku vihet në dijeni lexuesi me synimet e këtij personi dhe të partisë që ai përfaqëson. Pyetjet janë bërë në disa drejtime dhe një ndër synimet përveç garës zgjedhore të ardhshme, është edhe që të futet edukata fetare nëpër shkolla. Citojmë: “Ne kemi kërkuar që vetëm edukata fetare të futet në shkollat e nivelit të ulët dhe të mesëm”.

49. E hënë 2 maj 2005

gazeta “Metropol”

“Bomba në Fier, në kërkim të investitorit të Xhamisë”, “Pëllum Reshlani nuk po e ndërtonte xhaminë me fondet e tij. Hetime në Tiranë”, kronikë, **Re.Kro.**, fq. 6.

Në këtë shkrim hidhen dyshimet për një celulë të mundshme ekstremistësh “islamike” dhe ky fakt konfirmohet nga burime të SHISH. Po ashtu hidhen dyshime në bazë të hetimeve të SHISH se xhamia që po ndërtonte Pëllum Reshlani në fshatin e vet nuk po e bënte me fondet e veta dhe kështu kanë nisur hetimet për të gjetur investitorin. Po ashtu artikullshkruesi hedh dyshimin se të ashtuquajturat bomba me celular mund të ishin përgatitur për të përgjakur festën e Pashkëve. Citojmë

⁶ Ky titull paralajmërohet me germa të mëdha qysh në faqe të parë i shoqëruar me fotografinë e faqes 9.

nga shkrimi: “Burime të besueshme pranë policisë fierake dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda, pohuan dje për gazetën, se bomba që po prodhohet dy besimtarët muslimanë, dyshohet se mund të përdoret për një akt të mundshëm terrorist. Burimet pohojnë, se një qark i mundshëm ekstremistësh islamikë, dyshohet ta përdornin bombën për të përgjakur pashkët në Fier”. **“Festat, policia mban nën kontroll situatën në Tiranë”**, masat e policisë për festën e Pashkës dhe të 1 majit në Tiranë. Po ashtu në të njëjtën faqe janë edhe deklaratimet e disa ditëve më parë të Prokurorit të Përgjithshëm Theodhori Sollaku dhe të ambasadores amerikane në Tiranë, Marsi Raiz, për terrorizmin ndërkombëtar dhe raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit për këtë problem. Më poshtë ndjek një listë me 4 të arrestuar që dyshohen për terroristë ndërkombëtarë në vitet 1998-'99.

50. E martë 3 maj 2005

gazeta “Korrieri”

“Bashkësia Islame: Viktimat e tritolit s’u vranë për detyrën”, aktualitet, pa autor, fq. 11.

Në këtë shkrim jepet qëndrimi zyrtar i BISH, nëpërmjet drejtorit të kulturës Dorian Demetja, i cili distancohet nga veprimet e ngjarjes së Fierit ku humbën jetën tragjikisht dy të rinj muslimanë. Citojmë nga shkrimi: “Dorian Demetja, Drejtori i Kulturës dhe i Rinisë në BISH, deklaroi se për këtë ngjarje, nuk duhet të përhapet panik në popull. Më tej, ai shtoi: “Edhe nga hetuesia nuk kemi ende deklarime për rezultatin hetimor. Personi që gjeti vdekjen, Pëllumb Reshlani, nuk ishte hoxhë sepse nuk kishte marrë emërim nga selia e BISH-it”, tha Demetja...”⁷.

51. E enjte 5 maj 2005

gazeta “SOT”

“Gjykata e Lartë, bahçeja private e Thimio Kondit”, letër nga populli, Selvie Rushiti, fq. 12.

Në këtë letër të publikuar nga kjo gazetë flitet për një konflikt pronash nga autori i letrës me disa arabë. Ky person i është drejtuar kryetarit të trupit gjykues të Gjykatës së Lartë Thimio Kondi, i cili vendimin e tij e ka dhënë në favor të të ashtuquajturve arabë. Por e veçanta në këtë shkrim është se

⁷ I njëjti reagim është botuar edhe në gazetën “Express”, të së njëjtës ditë me titull: **“Islamët: Viktimat e tritolit nuk lidhen me detyrën fetare”**, mbititull *“Reagon Bashkësia Islame e Shqipërisë për shpërthimin e Fierit”*, fq. 5.

artikullshkruesi megjithëse një person i zakonshëm i drejtohet publikut të gjerë me klishtë, tashmë të formuara në të gjithë shtypin. Citojmë nga shkrimi: “Zotërinjtë e sipërpërmendur, të gjithë shtetas arabë (me përjashtim të z. Duraku) nuk i kemi parë asnjëherë gjatë pesë vjetëve që ka zgjatur procesi gjyqësor. Nuk dihet si, kur dhe pse kanë ardhur ata në Shqipëri, si janë bërë pronarë toke...”. pra, ato i shqetëson të qenit e këtyre personave arabë dhe se janë paraqitur me avokatë dhe jo vetë personalisht.

52. E premte 6 maj 2005

gazeta “DITA”

“Përse i dëboi Stalini myslimanët”, dossier, Jean Christophe PEUCH, fq. 19.

Në këtë dossier jepen të dhënat dhe arsyet e dëbimeve dhe internimeve masive të bëra gjatë regjimit stalinist në ish-Bashkimin Sovjetik. Autori është gazetar i radios amerikane “Evropa e Lirë”. Flitet për popullsitë tartare, çeçene, armenë, kurdë dhe mesketë, të cilët ishin të vendosur në gadishullin e Krimesë dhe në zonën e Kaspikut. Këto popullsi u internuan se ishin muslimane në përgjithësi dhe Stalini iu druajt një lufte të mundshme me Turqinë fqinje. Largimin e mesketëve myslimanë nga Gjeorgjia për në Uzbekistan, disa historianë e justifikojnë me pastrim fetar. Porse historiografia sovjetike e ka justifikuar ndryshe këtë internim masiv të këtyre popullsive. Citojmë nga shkrimi: “Zyrtarisht historiografia sovjetike i ka justifikuar dëbimet e Stalinit si dëbime të ish-bashkëpunëtorëve të nazizmit gjatë pushtimit gjerman të gadishullit të Krimesë në vitet '41-'42. Llogariten rreth 1,5 milionë njerëz të dëbuar në Siberi dhe Azinë Qendrore, derisa forcat sovjetike morën kontrollin në rajonet e Krimesë e Kaspikut. Në mesin e popullsive të dëbuara ishin tartarët e Krimesë, çeçenët, armenët, kurdët, mesketët”.

53. E diel 8 maj 2005

gazeta “TEMA”

“Ju tregoj për luftën e hebregjeve kundër turqve”, “Golda Meir: Izraeli im (3)”, dossier, për. Behxhet Haliti, fq. 12-13.

Në këtë dossier jepen kujtimet e ish-kryeministres së Izraelit Golda Meir dhe përpjekjet e sionistëve socialistë izraelite për krijimin e shtetit hebre në Palestinë. Jepen përpjekjet për ngritjen e legjionit hebraike nëpër botë që do ta çlironin

Palestinën nga turqit osmanë. Po ashtu jepen kujtime edhe rreth disa sionistëve të tjerë si, Ben Gurion, Ben Cvi etj.

54. E mërkurë 11 maj 2005

gazeta "Metropol"

"Kryqëzatat Epope apo turp?", kultura, Giorgio Ierano, fq. 22. Autori i shkrimit bën një përmbledhje historike të asaj çka ngjau në kohën e kryqëzatave, duke i pasqyruar ato me vërtetësi dhe duke dhënë mendimin e disa kritikëve. Shkas për këtë shkrim është filmi i regjisorit hollivudian Ridley Scott për Kavalierët në Tokën e Shenjtë. Dhe ja se si e përshkruan ky autor kryqëzatën e parë, citojmë: "pushtimi i Jeruzalemit, në korrik 1099, me masakra si ato kundër hebrenjve (të djegur të gjallë në sinagoga) si dhe sulme kundër kristianëve vendas që ishin në anën e myslimanëve. E vështirë të përfshish gjithçka në një kuadër idilik". Po ashtu flitet edhe për heroin e famshëm musliman që ua hoqi nga duart Jeruzalemin kryqtarëve dhe e mbrojti me heroizëm, Salahudin Ejubin. Shkrimi mbyllet me vërejtjen e një studiuesi anglez, Stiven Runciman, që thotë citojmë: "Kryqëzatat ishin një episod tragjik dhe destruktiv. Kishte shumë kurajo dhe shumë pak besnikëri, shumë devotshmëri dhe shumë pak kuptim; ideale të zmadhuar shtypeshin nga egërsia. Lufta e shenjtë nuk ishte tjetër veçse një akt i gjatë intolerance, kryer në emër të Zotit".

55. E shtunë 14 maj 2005

gazeta "Shekulli"

"Gjergj Kastrioti, jo vetëm i të krishterëve, edhe i myslimanëve", *"Dëshmi e vetëdijes mbifetare etnike të Skënderbeut"*, kulturë, prof. Dr. Gazmend Shpuza, fq. 18.

Nëpërmjet këtij opinioni në faqen e kulturës historiani Gazmend Shpuza është munduar të japi argumente në favor të idesë që e hedh qysh në titull dhe mbititull për Skënderbeun, një nga figurat historike më të rëndësishme për historinë shqiptare. Ky debat vjen në 600-vjetorin e vdekjes të heroit kombëtar. Për këtë ide ky historian është shërbyer edhe me fjalët e poetit katolik Gjergj Fishtës, që e ka cilësuar Skënderbeun "...fatosi i lirisë dhe i pavarësisë së kombeve...". Po ashtu autori vëren me objektivitet për figurën e Skënderbeut se, citojmë nga shkrimi: "Fetarizimi', 'krishterizimi', antiislamizimi' i luftës kundërosmane të popullit shqiptar në shek. XV nën udhëheqjen e Skënderbeut, përbën, pavarësisht nga përdorimi i fesë në të dy kampet ndërluftuese të kohës, një shtrembërim të së vërtetës

historike”. Në vazhdim autori vëren se Skënderbeu ka qenë ortodoks i rritit uniat, pra, që njihete papën e Romës për të parë, e më pas kthehet në musliman i tarikatit bektashi. Gjithashtu ai citon një thënie të Skënderbeut se nuk kishte marrë asnjë grosh ndihmë nga papa. Ky autor i mbështetet shumë edhe mendimeve të patër Gjergj Fishtës.

56. E diel 15 maj 2005

gazeta “**Korrieri**”

“**Myслиmanët, jo selefizmit me status**”, ngjarje dite, ed.ku, fq. 2.

Në këtë shkrim flitet për ndryshimin e nenit 1 të statutit të **Bashkësisë Islame të Shqipërisë**, i cili do të nisë tashmë me formulën “**Bismilahi Rrahmani Rrahim – Me emrin e Zotit Mëshiruesit Mëshirëbërësit**”, si dhe për mosndryshimin e nenit 2 ku përcaktohet se medhhebi zyrtar do të jetë ai hanefi. Në këtë shkrim paraqitet si një fitore mosndryshimi i këtij neni si dhe përcaktohet se selefitë janë të pakët dhe paraqesin krahun radikal të Islamit. Në vijim autori përshkruan medhhebet hanefi dhe selefi dhe ku ndryshojnë, por duket qartë se nuk ka informacion të plotë dhe dijeni për atë që shkruan. Ose më saktë burimet⁸ nga të cilat i kanë marrë këto informacione i kanë keqinformuar dhe kanë keqpërdorur padijeninë e gazetarit në këtë fushë. Nga burime të brendshme që i kam konfirmuar si monitorues i këtyre ngjarjeve, as që nuk është kërkuar për ndryshimin e nenit nr. 2 të statutit të BISH. Citojmë nga shkrimi: “Një grup i cili përfaqësohej nga një numër i madh të rinjsh nga Tirana dhe disa rrethe të vendit, si edhe një numër më i vogël besimtarësh të devotshëm në moshë të thyer, kishin kërkuar më se njëherë që të ndryshonte riti i zbatueshëm ligjërisht nga myslimanët shqiptarë”. Po ashtu në këtë faqe jepet një prononcim i z. Ilir Kulla kreu i Komitetit të Kulteve.

57. E diel 15 maj 2005

gazeta “**Gazeta Shqiptare**”

“**Bashkësia Islame mposht rrymën e radikalëve**”⁹, “*Muslimanët fitojnë të moderuarit – Mbledhja e krerëve të Komunitetit. Shuhën debatet për ndryshimin e riteve fetare*”, faqja e parë, Gazmend Janku, fq. 2.

⁸ Në bazë të informacioneve të brendshme burimet për shtypin për temën në fjalë janë marrë nga Zylyftar Dervishi, sekretar i BISH i akuzuar për shpërdorime dhe zënie posti me diploma false dhe një kuadër tjetër i BISH.

⁹ Ky titull paralajmërohet me germa të mëdha qysh në faqe të parë.

Edhe në këtë shkrim pak a shumë është e njëjta frymë që paraqitet edhe nga artikullshkruesi i “Korrierit”, si dhe kuptohet që burimi i informimit është i njëjtë. Po ashtu në këtë faqe jepet një prononcim i z. Ilir Kulla kreu i Komitetit të Kulteve.

“Pse përplasen muslimanët shqiptarë”, “Të rinjtë’ akuzojnë ‘tradicionalët’ për shpërdorime”, faqja e parë, Fatos Mahmutaj, fq. 3.

Me sa duket autori i kësaj faqeje është i mirinformuar për gjendjen e brendshme të BISH dhe jep një kuadër më të plotë për atë çka po ndodh. Është e vërtetë që ka një ndarje midis të të ashtuquajturve ‘tradicionalë moderatorë’ dhe ‘të rinjve radikalë’. Po ashtu edhe akuzat e bëra ndaj të të ashtuquajturve ‘të rinj terroristë’ kanë dalë nga strukturat e brendshme të BISH. Akuzat e ‘të rinjve’ qëndrojnë në abuzimet me pronat e këtij institucioni dhe financat e brendshme. Ky autor jep shpjegime për shkollën hanefite dhe shkollën “vehabizmi”. Për këtë të fundit gabon kur e cilëson si shkollë sepse vetë Abdul Vehabi dhe pasuesit e tij nuk e kanë pretenduar se janë një shkollë prej shkollave të tjera, të ngjashme me hanefijtë, hanbelijtë etj. Më shumë do t’i shkante për shtat lëvizje se sa shkollë.

58. E hënë 16 maj 2005

gazeta “Panorama”

“Diplomat e muslimanëve, gati ndëshkimet”, mbititull *“Këshilli i përgjithshëm urdhëron kontrollin e dokumentacionit për arsimimin e krerëve të bashkësisë islame”,* aktualitet, pa autor, fq. 11.

Në këtë shkrim flitet për të njëjtën mbledhje që i është bërë jehonë edhe shkrimet e një dite më parë në gazetën “Korrieri” dhe “Gazeta Shqiptare”, por i kushtohet më tepër vëmendje kontrollit që po i bëhet krerëve të BISH, si dhe akuzave që shumë nga funksionarët në Tiranë dhe në rrethe nuk disponojnë diplomat përkatëse për arsimimin e tyre. Kështu është ngarkuar një komision i posaçëm për verifikimin e tyre, si dhe i është caktuar një afat për shqyrtimin e tyre. Në një kuadrat të veçantë jepet me katër fjali pikërisht tema e mos-ndryshimit të riteve, e titulluar: **“Rrëzohet kërkesa për ndryshimin e riteve”.**

59. E martë 17 maj 2005

gazeta “Korrieri”

“Qeveria premtoi xhami por na dha kjoskë”¹⁰, ngjarje dite, ed.ku, fq. 2.

Në këtë shkrim autori merret me problemin e lejes për ndërtimin e Xhamisë së Madhe në Tiranë, për të cilën është dhënë leja, por nuk është lejuar akoma të ndërtohet. Në rreshtat e këtij shkrimi përçohet shqetësimi i nënkryetarit të BISH, të nderuarit Bledar Myftari për këtë problem, citojmë nga shkrimi: “Myftari shtoi se “ky premtim i Metës dhe Nanos, nuk u realizua kurrë dhe ajo që na shqetëson më shumë, është se në planin e ri urbanistik të Tiranës, as që përfshihet ndërtimi i kësaj xhamie në vendin e deklaruar tek ish Namazgjaja”. Po ashtu në këtë faqe në një kuti të veçantë jepen tre deklarime të bëra në kohë të ndryshme nga kryeministri Fatos Nano. Në një kuti tjetër jepet edhe vendimi për kontrollimin e dokumenteve të arsimit të funksionarëve të BISH, nën titullin: “Myslimanët, 5 ditë afat për dokumentet e drejtuesve”.

60. E enjte 19 maj 2005

gazeta “Metropol”

“Karimov nuk ndalet”, bota, the economist, fq. 20.

Në këtë shkrim të marrë nga e mirënjohura ‘the economist’ përshkruhet gjendja e nderë politike në Uzbekistan. Në këto rreshta jepet edhe qëndrimi i SHBA-së dhe Britanisë ndaj masakrave që kanë ndodhur në qytete të ndryshme të Uzbekistanit. Islam Karimov është presidenti i vendit që e drejton atë me dorë të fortë dhe akuzon të ashtuquajturit grupe si përgjegjësit për trazirat në vend. Citojmë nga shkrimi: “Ka patur në numër incidentesh në Uzbekistan gjatë viteve të fundit, dhe zoti Karimov ka bërë zakonisht përgjegjës grupet islamike”. “Kredibiliteti dhe Kur’ani”, bota, Jody K. Biehl (Der Spiegel), fq. 21.

Në këto radhë flitet për lajmin e botuar nga Njuzuik se ushtarët amerikanë të bazës së Guantanamo kanë përdhosur Kur’anin. Ky lajm ka ngjallur indinjatë në botën arabe dhe është transmetuar në një moment të papërshtatshëm sipas artikullshkruesit. Citojmë: “Lajmi shkaktoi shpërthimin e një ndjenje zhurmëmadhe antiamerikane në Afganistanin, që ndërkohë ishte goxha i paqëndrueshëm. 17 vetë vdiqën.”. Ky

¹⁰ Ky shkrim paralajmërohet me germa të mëdha qysh në faqe të parë, porse me një titull tjetër: “Myslimanët, protestë për xhaminë e re”.

lajm më pas është tërhequr nga Njuzuik, e cila vazhdon të këmbëngulë se më përpara lajmi është kontrolluar nga një zyrtar i lartë i Pentagonit.

61. E premte 20 maj 2005

gazeta “Korrieri”

“Kultet: gjysma e xhamive pa leje”¹¹, ngjarje dite, ed.ku, fq. 2. Pas reagimit të së martës nga nënkryetari i BISH, i nderuari Bledar Myftari ndaj mosdhënies së lejes për ndërtimin e Xhamisë së Madhe të Tiranës, menjëherë reagon Komiteti i Kulteve me kryetar z. Ilir Kulla, duke deklaruar se gjysma e xhamive të Shqipërisë janë pa leje. Citojmë nga shkrimi: “Ndër 431 xhamitë që ndodhen në Shqipëri, 203 prej tyre janë pa leje ndërtimi”, pohojnë drejtuesit e Komitetit Shtetëror të Kulteve. “Aktualisht, ato ndodhen në proces legalizimi”, pohon KSHK”. Më tej flitet për shtrirjen e këtyre xhamive në të gjithë vendin, si dhe flitet për medresetë. Një pjesë e shkrimit i është kushtuar të huajve dhe shoqatave islame që veprojnë në vend si dhe jepet prononcimi i KSHK-së se këto shoqata veprojnë brenda ligjit.

“Bashkësia Islame: Akuza të pabaza dhe tendencioze”, nën këtë titull dhe po në këtë faqe jepen reagimet e BISH, të cilët thonë se këto akuza janë me të vërtetë tendencioze dhe se kjo nuk do të thotë se ato janë të paligjshme deri sa janë në procesin e legalizimit. Citojmë: “Sipas BISH, është e vërtetë që ka një numër xhamish të cilat nuk kanë të gjitha dokumentet e “e pafundme” që kërkohen nga shteti për një godinë të ndërtuar, por kjo nuk do të thotë aspak se ato janë të paligjshme”.

Në një kuti të veçantë me titull **“Organizatrat arabe dhanë qindra milionë USD”**, jepen burimet e parave me të cilat janë ndërtuar xhamitë. Në një kuti tjetër jepen shoqatat islame që veprojnë në Shqipëri.

62. E shtunë 21 maj 2005

gazeta “Korrieri”

“Xhamitë me leje, letrat i kanë shoqatat”, aktualitet, ed.ku, fq. 11.

Në këtë shkrim po nga i njëjti autor i një dite më parë, jepen arsyet pse mungon dokumentacioni i xhamive. Autori në bazë të shpjegimeve të marra nga funksionarë të BISH, thotë se

¹¹ Ky shkrim paralajmërohet me germa të mëdha qysh në faqe të parë, porse me një titull tjetër: “Shqipëri, gjysma e xhamive, pa leje”.

lejet e atyre xhamive që mungojnë i kanë shoqatat që i kanë ndërtuar këto xhami. Asnjë prej tyre nuk është ndërtuar pa leje dhe as nga ato që janë rikonstruktuar. Për to është marrë leje nga autoritetet lokale. Gjithashtu funksionarët e BISH pohojnë se është duke u punuar që çdo xhami të ketë edhe dosjen e saj në institucion. Këto funksionarë janë shprehur me shqetësim për deklaratat e disa ditëve më parë të bëra nga KSHK. Citojmë nga shkrimi: “Zyrtarë të BISH-it, shprehen gjithashtu se të tilla supozime sipas tyre, nuk janë produktive për marrëdhëniet me religjionin”.

63. E martë 24 maj 2005

gazeta “Panorama”

“Mashtroi me diplomën, hiqet sekretari i myslimanëve”¹², mbititull *“Tri orë debate për mungesën e diplomës. Kundërukuza: Ju jeni terroristë e radikalë”*, aktualitet, pa autor, fq. 2

Në këtë faqe i bëhet jehonë faktit të largimit nga posti i sekretarit të BISH, Zylyftar Dervishi. Flitet gjithashtu se pas debatesh të gjata në një mbledhje treorëshe, Dervishi nuk ka arritur të sjelli përpara komisionit një diplomë të shkollës së lartë që ai pretendonte se e kishte kryer. Shkruhet se edhe funksionarëve të tjerë të lartë u janë kontrolluar dokumentet.

Në një titull tjetër në këtë faqe **“Traktet në xhami akuzuan Dervishin”**, flitet për disa fletushka të shpërndara më parë ku akuzohej Dervishi për mungesën e diplomës si dhe për afëra korruptive brenda Komunitetit. Gjithashtu aty akuzohej për administrimin e keq të financave.

“Dervishi, Hoxha i burgosur për vrasje”, *“U akuzua për ekzekutimin e komshiut të motrës. Gjykata e liroi”*, aktualitet, pa autor, fq. 3.

Në këtë pjesë të shkrimit flitet për akuzën e bërë ndaj Dervishit disa vjet më parë për vrasjen e një komshiu të tij. Jepet dinamika e ngjarjes dhe emrat e përfshirë në këtë konflikt. Në një kuti të veçantë në këtë faqe jepen 4 akuzat e bëra ndaj Dervishit në traktin e shpërndarë kundra tij. Po ashtu një titull tjetër që zë vend në këtë faqe është edhe për vrasjen e pararendësit të Dervishit. **“Dervishi zuri vendin e të vrrarit, Salih Tivari”**.

¹² Ky shkrim paralajmërohet me germa të mëdha qysh në faqe të parë, porse me një titull tjetër: “Myslimanët shkarkojnë sekretarin e akuzuar për vrasje”.

64. E martë 24 maj 2005

gazeta **“Ballkan”**

“Pezullohet sekretari i myslimanëve”, nëntitull *“Pretendoj se në vitin ’97 u dogj regjistri i amzës, por dokumenti iu kontestua në Elbasan”*, kronikë, pa autor, fq. 6.

Në këtë shkrim bëhet fjalë për problemet e krijuara në BISH nga mungesa e dokumentacionit të duhur prej sekretarit të këtij institucioni, Zylyftar Dervishi. Dokumenti i paraqitur nga person është kontestuar nga autoritetet e universitetit të Elbasanit, sipas autorit të këtij shkrimi. Po ashtu jepen edhe pretendimet e Dervishit se dokumentet janë djegur në vitin 1997.

Në një kuti të posaçme me titull **“Dervishi dhe nxënësi i tij, vrasës të një të riu”**, jepen pretendimet se Dervishi së bashku me një nxënës të tijin kanë vrarë për motive të dobëta, 25-vjeçarin Lulëzim Buzin. Këta të dy janë liruar për mungesë provash, por akuzohet se motra e Dervishit që ka punuar asokohe në prokurori ka zhdukur provat e akuzës.

65. E martë 24 maj 2005

gazeta **“Tirana Observer”**

“Historia e çështjes së minoritetit çam”, **“Çamët e Amerikës, letër Bushit”**¹³, argumenti, Arben Ademaj, fq. 2-3.

Në faqen 2 bëhet një përmbledhje historike e dëbimit masiv që pësuan çamët muslimanë që nga vitet 1912 e deri në vitin 1945, kur kanë qenë edhe dëbimet e fundit. Përveç kësaj jepen edhe dëmet e pësuar me shifra ku numri i të zhdukurve gjatë këtyre konflikteve është 150.000 sipas autorit. Por këto konflikte kanë lënë pas edhe një seri problemesh ende të pazgjidhura pasurore. Ndërsa më e keqja është, citojmë nga shkrimi: *“Dëbimi me forcë nga Greqia i gjithë popullsisë myslimane shqiptare, përveç ndjenjës së keqe, kanë lënë dhe një mal problemesh pas. Ndërkohë, sipas deklaratave të autoriteteve greke, ‘Çështja çame nuk ekziston’”. Ndërsa në faqen pasuese jepen përpjekjet e çamëve që banojnë në Amerikë për të sensibilizuar për këtë problem autoritetet amerikane. Gjithashtu jepet i plotë teksti i letrës së dërguar presidentit amerikan Bush, përpara takimit të këtij të fundit me kryeministrin grek Karamanlis.*

¹³ Ky shkrim paralajmërohet me germa të mëdha qysh në faqe të parë, porse me një titull tjetër: *“Letër presidentit Bush: Zgjidhje çështjes çame”*.

66. E mërkurë 25 maj 2005

gazeta "Express"

"Drejtësia italiane akuzon Fallacin", express lajme, fq. 12.

Në këtë lajm të shkurtër se drejtësia italiane ka filluar hetimet ndaj gazetares italiane Oriana Fallaci. Ajo është paditur nga Adel Smith, president i Bashkimit të Muslimanëve të Italisë, për librin e saj "Forca e arsyes" që përmban shprehje fyese kundër Islamit.

67. E enjte 26 maj 2005

gazeta "Panorama"

"Tre kushtet e myslimanëve për Dervishin", mbititull "*Në tre raste që ai ka paraqitur dokumente shkolle në komunitet nuk i ka vërtetuar dot si origjinale*", aktualitet, pa autor, fq. 13.

Në këtë shkrim njoftohet pezullimi i sekretarit të BISH, Zylyftar Dervishi dhe jepen kushtet që duhet të përmbushi ai për të vazhduar në funksionin e tij si sekretar. Po ashtu në vazhdim jepet përgjigja negative e Universitetit të Elbasanit, me numër prot. 155, datë 19 maj, e cila mohon kategorikisht që Dervishi ta ketë atë kopje diplome të rregullt. Për pasojë ajo është e falsifikuar, citojmë nga shkrimi: "Pas kërkesës së Komunitetit Musliman, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" me shkresë Nr. Prot. 155 datë 19 maj 2005 ka theksuar se diploma e pretenduar nga Zylyftar Dervishi nuk figuron e regjistruar në Librin e Amzës së Rikuperuar të Fakultetit të Ciklit të Ulët dhe Parashkollor. Sipas këtij Universiteti dokumenti i paraqitur është i falsifikuar". Për këtë sipas shkrimit Dervishit i janë vënë tre kushte nga mbledhje e Këshillit të Përgjithshëm të BISH: të provojë vërtetësinë e diplomës, të paraqesë listën e notave për çdo vit dhe të identifikojë të paktën tre shokë të kursit që ka pasur gjatë studimeve.

68. E premte 27 maj 2005

gazeta "Ballkan"

"Përgënjeshtrohet diploma e Dervishit", mbititull "*Ish-rektori i Universitetit të Elbasanit dhe ish-dekani i kthejnë përgjigje Komunitetit Mysliman*", aktualitet, pa autor, fq. 17.

Po ashtu edhe kjo gazetë i bën jehonë faktit të falsifikimit nga ana e sekretarit të BISH, Zylyftar Dervishit të diplomës së tij. Jepet edhe vendimi i BISH për ta pezulluar këtë person, duke i dhënë afat që t'i vërtetojë pretendimet e tij, duke paraqitur listën e notave dhe të sjelli dëshmitarë që e kanë kryer shkollën me të për të dëshmuar. Në këtë faqe jepet të skanuara fotokopja

e diplomës së paraqitur nga Dervishi si dhe përgjigja negative e rektorit të Universitetit të Elbasanit prof. Dr. Jani Dode. Po ashtu pretendimet e Dervishit i kanë hedhur poshtë edhe ish-rektori i Universitetit të Elbasanit Mehmet Çeliku dhe ish-dekani Ali Shashaj. Gjithashtu sipas artikullshkruesit diploma e paraqitur nga Dervishi kuptohet fare lehtë që është e falsifikuar.

69. E diel 29 maj 2005

gazeta “Gazeta Shqiptare”

“**Sekuestro llogarive të 4 shoqatave islamike**”¹⁴, faqja e parë, pa autor, fq. 2.

“Shqipëria kthehet në një fushë të minuar për organizatat “humanitare” që financojnë terrorizmin”. Kjo është fjalia e parë me të cilën nis shkrimin ky autor, duke bërë me dijeni në vijim për bllokimin e llogarive bankare të 4 shoqatave dhe dy individëve me urdhër të ministrit të financave Arben Malaj. Këto bllokime që u bëhen llogarive të fondacioneve (Global Relief Foundation, Al Haramain, Taibah, Ringjallja e Trashëgimisë Islame si dhe 2 individë të quajtur Nabil Abdul Sayadi dhe bashkëshortja e tij Patricia Rosa Vinck) në kuadrin e masave që ka marrë shteti shqiptar për luftën kundra terrorizmit ndërkombëtar pas shpalljes së listës së zezë nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Po ashtu jepen fondacionet që kanë qenë vazhdimisht në qendër të vëmendjes së kësaj lufte si dhe një historik i shkurtër ku përmenden dëbimet e bëra nga shteti shqiptar ndaj personave të huaj me origjinë arabe.

“**Fondacionet e huaja paga imamëve**”, nëntitull “*Financojnë pagën e disa klerikëve e deri një kuzhinier në Belsh*”, faqja e parë, Artan Hoxha, fq. 3.

Siç mund të gjykohet edhe nga titulli në këtë shkrim flitet se fondacionet, të cilave u janë bllokuar llogaritë bankare ndërmjet veprimtarive të ndryshme kanë kryer edhe atë të dhënies së pagave për imamët e xhamive të ndryshme. Më pas artikullshkruesi flet për dy nga katër fondacionet që u janë bllokuar llogaritë, Taibah dhe Ringjallja, me të dhëna të hollësishme për organizimin e tyre dhe ku i kanë selitë e tyre në Tiranë dhe Ballkan. Fondacionit Ringjallja i atribuohet edhe qendra Ben Hammude (kjo gabimisht, sepse kjo është qendër e Gjysëm Hënës së Kuqe të Emirateve të Bashkuara Arabe) në Dërmenas të Fierit, kurset e të cilës i kanë ndjekur edhe dy

¹⁴ Po ky titull me germa të mëdha dhe me një foto ku paraqiten njerëz me mjekra në burg, foto e marrë nga agjencitë e huaja.

besimtarë që gjetën vdekjen aksidentalisht pak kohë më parë. Më pas po ky autor flet edhe për fondacionin tashmë të mbyllur Al Haramain.

Në kuadër të po kësaj faqeje jepet një intervistë e shkurtër e nënkryetarit të BISH, Bledar Myftari, e titulluar “**Komuniteti Musliman bashkëpunon me 6 fondacione e shoqata islame**”. Kemi të bëjmë me një tjetër gabim formal në titull, sepse tashmë emërtimi Komuniteti Musliman ka ndryshuar në **Bashkësia Islame e Shqipërisë**¹⁵.

¹⁵ Ndryshimi i emërimit është bërë në mbledhjen e radhës së Këshillit të Përgjithshëm ku është bërë edhe ndërrimi i nenit nr. 2 të Statutit të Komunitetit Musliman të Shqipërisë (KMSH) në Bashkësia Islame e Shqipërisë (BISH) ky vendim është diskutuar në prill dhe ka marrë formë përfundimtare në 15 maj 2005.

Muaji Qershor 2005

70. E mërkurë 1 qershor 2005

gazeta “Korrieri”

“Largohet sekretari i myslimanëve”, aktualitet, pa autor, fq. 8.

Në këtë shkrim njoftohet largimi përfundimtar i Zylyftar Dervishit nga posti i sekretarit të BISH dhe zëvendësimi me Betim Truçin, një tjetër funksionar i këtij institucioni. Më pas jepet një përshkrim i asaj çka ndodhur në mbledhjet e fundit të Këshillit të Përgjithshëm të BISH dhe për shkeljet e përfolura të bëra nga Dervishi. Jepet gjithashtu informacion rreth një trakti kundra këtij personi, i shpërndarë nga një grup besimtarësh kundra punës së dobët të Dervishit. Për abuzimet e bëra me pronat e muslimanëve u ngrit edhe një komision i posaçëm, i cili ka akuzuar tashmë punën e dobët të kryesisë së vjetër të Komunitetit Musliman dhe në veçanti dy ish-nënkryetarët, të cilët edhe kanë pasur rolin kryesor (Selim Stafa dhe Ermir Gjinishi).

71. E enjte 2 qershor 2005

gazeta “Korrieri”

“Përhap panik duke abuzuar me besimin”, aktualitet, Valbona Idrizi, fq. 9.

Një person që ka përhapur lajme të rreme mbi fundin e botës është subjekt i shkrimit, ngjarjet e të cilit zhvillohen në Shkodër. Një farë Ilir Zhejani ka përhapur komunikata ku ka paralajmëruar se fundi i botës do të vijë në vitin 2009 dhe se ai si person është i dërguari i Zotit. I menjëhershëm ka qenë edhe reagimi i Myftinisë së Shkodrës ndaj këtij të dërguari të rremë.

72. E enjte 2 qershor 2005

gazeta “Shekulli”

“Kisha në fermanët osmanë”, dossier, Shaban Sinani, fq. 20-21.

Në këtë shkrim studimor, drejtori i Arkivit Qendror të Shtetit, Shaban Sinani flet për raportet tolerante të shtetit osman ndaj subjekteve të krishtera të Perandorisë. Po ashtu jep edhe

traktatet e ndryshme të nënshkruar me fuqi të ndryshme të krishtera, veçanërisht atë austriake që mori përsipër mbrojtjen e të krishterëve romanë. Gjithashtu ky studiues citon edhe rastet kur të krishterë kanë bërë karrierë në shtetin osman si rastet klasike të Vaso pashë Shkodranit dhe të familjes Bibë Dodë Pashës. Një tjetër fakt që citohet është edhe lënia e rezidencës së Patriarkanës Ortodokse në Stamboll. Në një kuti të veçantë janë vendosur përfundimet në të cilat ka arritur ky studiues, ku ndër të tjera citojmë: “Të gjitha këto shprehin një politikë të kujdesshme dhe pragmatiste nga ana e Portës së Lartë, që përmban edhe sensin e tolerancës, duke e pranuar edhe ndryshimin në besim, duke i njohur atij autonomi të brendshme funksionimi administrativ dhe financiar, duke e mbështetur këtë veprimtari me një paketë ligjore privilegjesh; duke e parë dhe vlerësuar kishën si faktor bashkëpunimi, pa shmangur dekurajimin e tradicionalizmit fetar dhe inkurajimin e ndryshimit në besim, por jo në format klasike të përshkruara në historiografi, deri tek ekzagjerimet me ndryshimin e dhunshëm fetar”.

“Fermanët tolerantë”¹⁶, dossier, Belina Budini, fq. 20-21.

Në këtë shkrim i bëhet jehonë botimit të një katalogu me fermanët që kanë të bëjnë më Shqipërinë lëshuar nga sulltanët osmanë. Ky katalog titullohet “Fermanlar” dhe është botim i përbashkët i TIKAs dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Në këtë shkrim jepen të dhëna të ndryshme rreth fermaneve dhe këtij botimi. Po ashtu jepen fermanet, me të cilët është mbrojtur e drejta e ushtrimit të fesë prej të krishterëve.

73. E shtunë 4 qershor 2005

gazeta “Panorama”

“Zgjedhjet fusin në sherr myslimanët”, aktualitet, Trashgim Sokolaj, fq. 11.

Në këtë shkrim flitet për një letër drejtuar kryetarit të BISH, Selim Muça, në të cilën një grup i madh besimtarësh i janë drejtuar atij me disa shqetësime. Sipas autorit të shkrimit shqetësimet janë katër: 1. Diploma e falsifikuar e ish-sekretarit Zylyftar Dervishi dhe emërimi i tij në Lushnje si myfti. 2. Mungesa e arsimit përkatës e myftiut të Lezhës. 3. Familjariteti në strukturat drejtuese të BISH, dhe 4. Përfshirja e kryetarit Muça në fushatën elektorale të kandidatit socialist të Dibrës

¹⁶ Rreth botimit të katalogut “Fermanlar”, kanë botuar shkrime edhe gazeta të tjera, si: Metropol, Albania, Ballkan.

Bashkim Haxhiu. Në këtë shkrim jepen edhe informacione të tjera rreth këtyre problemeve.

74. E diel 5 qershor 2005

gazeta “Shekulli”

“**Rozafa’, kleri: Besimtarët të bojkotojnë kutitë e votimit**”¹⁷, kronikë, Anila Dushi, fq. 5.

Në këtë kronikë flitet për reagimin e përbashkët të të dy komuniteteve fetare muslimane dhe atij ortodoks, ndaj privatizimit të hotel Rozafës në Shkodër. Pronarë të këtij trualli sipas artikullshkruesit janë Myftinia e Shkodrës, komuniteti Ortodoks dhe familja Laçej. Autorja e shkrimit përshkruan historikun e kësaj mosmarrëveshjeje midis komuniteteve fetare dhe një grupi ish-të përndjekurish politikë. Në fund jepet reagimi i të dy krerëve fetarë, të cilët kanë deklaruar se po të mos u jepet e drejta e pronësisë, ato u kanë bërë thirrje besimtarëve që të mos votojnë në 3 korrik.

75. E diel 12 qershor 2005

gazeta “Gazeta Shqiptare”

“**Kërcënohen me vdekje Muça e Kulla**”¹⁸, nëntitull “*Policia merr në ruajtje kreun e Bashkësisë Islame*”, aktualitet, re.kr, fq. 13.

Sipas këtij shkrimi kreu i Bashkësisë Islame Muça dhe kreu shtetëror i Komitetit të Kulteve Ilir Kulla kanë marrë kërcënime nga ‘rrymë ekstremiste e xhihadit selefist’, të cilët u përpoqën të ndryshojnë edhe statusin e komunitetit musliman për të zyrtarizuar këtë rrymë ekstreme. Këto kërcënime kanë qenë shumë serioze përderisa e kanë detyruar policinë e antiterrorit që të marri masa, duke siguruar jetën e tyre¹⁹. Në këto rreshta thuhet se kërcënimet e bëra janë po prej atyre personave që kërkuan të ndryshojnë statusin e Bashkësisë, por që nuk ia dolën dot. Emrat e personave nuk jepen se kush janë ata, po ashtu nuk janë dhënë edhe më parë nga gazetarët e kësaj gazete përveç faktit që kanë studiuar jashtë dhe që identifikohen si selefistë dhe ekstremistë. “Disa të rinj, të cilët kanë studiuar

¹⁷ Kësaj ngjarje i kanë bërë jehonë në faqet e tyre edhe gazetat: Panorama, Korrieri, Koha Jonë dhe SOT.

¹⁸ Ky shkrim paralajmërohet me germa të mëdha qysh në faqe të parë, porse me një titull tjetër: “Ekstremistët dënojnë me vdekje kreun e muslimanëve”, shoqëruar me një foto të madhe të Selim Muçës.

¹⁹ Pas vizitës të bërë nga një kanal privat televiziv në shtëpinë e Muçës, nuk ka pasur asnjë polic që ta ruante atë, ndërsa Ilir Kulla gjendej jashtë shtetit.

në shkollat arabe dhe aziatike, kërkojnë që të sjellin zyrtarisht në Shqipëri veç muslimanizmit osman edhe këtë rrymë të islamit ekstrem”.

76. E martë 14 qershor 2005

gazeta “Gazeta Shqiptare”

“Kërcënimet, gjashtë imamë thirren në polici”²⁰, faqja e parë, Gerti Xhaja, fq. 2.

Në këtë faqe bëhet fjalë për shoqërimin në Drejtorinë e Policisë në Tiranë, dega e antiterrorit, të 6 imamëve të xhamive të kryeqytetit dhe anëtarë të këshillit të myftinive, për të ashtuquajturat kërcënime që u janë bërë Ilir Kullës dhe Selim Muçës. Për orë me radhë këta persona janë marrë në pyetje, por nuk është marrë për to asnjë masë ndalimi apo arrestimi. Po ashtu jepet mohimi i një dite më parë i bërë nga Selim Muça se nuk ka pasur asnjë kërcënim (nëpërmjet një zëdhënësi). Ndërsa Ilir Kulla e ka pohuar se ka marrë kërcënime nëpërmjet telefonit dhe internetit. Në një pjesë të veçantë jepet intervista e dhënë nga ligjëruesi i xhamisë Dine Hoxha, Ahmet Kalaja, për ngjarjet në fjalë. Citojmë: “Sa për zotin Selim Muça, ne e respektojmë se është kryetari ynë dhe nuk kemi patur konflikte, apo më keq ta kemi kërcënuar atë. Në polici na pyetën edhe për Kryetarin e Komitetit të Kulteve, Ilir Kulla, i cili nuk ka asnjë lidhje me ne, dhe nuk besoj të ketë patur kërcënim nga ndonjë besimtar musliman, për hir të funksionit që ka”.

“Muslimanët, lind organizata paralele”²¹, faqja e parë, Gerti Xhaja, fq. 3.

Në faqen në vijim jepet lajmi i krijimit të Forumit Musliman Shqiptar, i cili në bazë të disa neneve në statutin e tij, i ka të njëjta me BISH, 2, 5, 6 dhe 7. Sipas shkruarit këto nene krijojnë përplasje kompetenca me Komunitetin Musliman dhe me Kushtetutën e Shqipërisë, e cila sipas nenit 10, sanksionon marrëveshjen me 4 komunitetet tradicionale, dhe një ndër këto 4 është BISH. Po ashtu si edhe në shkrime të tjera pararendëse të kësaj gazete flitet edhe për të dy rryma, atë të butën hanefi dhe atë të fortën vehabi. Në një vend të posaçëm jepet deklarimi i kreut KSHK Ilir Kulla, i cili ka pohuar se shteti njeh vetëm BISH si organizatë përfaqësuese të muslimanëve shqiptarë.

²⁰ Ky lajm është bërë publik jo vetëm në gazetën e kësaj dite që po evidentojmë këtu.

²¹ Ky shkrim paralajmërohet me germa të mëdha qysh në faqe të parë, porse me një titull tjetër: “Përçahen muslimanët, krijohet fraksioni i ri”.

“Do vijmë të marrim në duar drejtimin e Komunitetit”, titull po në faqe 3.

Po ashtu në një tjetër vend të posaçëm flitet për mendimet e marra nga po kjo gazete disa vite më parë studentëve që studionin në Arabinë Saudite, ku këta janë shprehur se kur të kthehen do të marrin në dorë Komunitetin Musliman Shqiptar.

77. E martë 14 qershor 2005

gazeta **“Korrieri”**

“E vërteta e dënimit të Muçës e Kullës”²², ngjarje dite, Sokol Çobo, fq. 2.

Në një vend të posaçëm jepet lajmi i shoqërimit të imamëve në Drejtorinë e Policisë së Tiranës dhe janë hetuar nga drejtori i Antiterrorit. Ndërsa shkrimi në tërësi është ndërtuar mbi deklaratimet e bëra nga ligjëruesi i Xhamisë Dine Hoxha, Ahmet Kalaja. Ai e ka cilësuar këtë ngjarje si show mediatic në prag të zgjedhjeve elektorale ku qeveria kërkon të bëjë figurë të mirë në arenën ndërkombëtare dhe se po merr pjesë në luftën antiterror. Ndërkaq një citim tjetër interesant është për kreun e KSHK, nga Kalaja, citojmë: “Imami i xhamisë së rrugës së Kavajës, Ahmet Kalaja thotë se gjithçka ka filluar pas kandidimit të Ilir Kullës, aktualisht me detyrë, kryetar i Komitetit Shtetëror të Kulteve pranë Kryeministrisë, si kandidat për deputet në Korçë, nën siglën e Partisë Socialiste (PS). Ai thotë se shoqërimi mund të jetë realizuar nga ndonjë klan i fshehtë që vepron midis besimtarëve”.

78. E martë 14 qershor 2005

gazeta **“Metropol”**

“Myslimanët ndihen të fyer”²³, nëntitull **“Ligjëruesi i xhamisë së “Rrugës së Kavajës”, Ahmed Kalaja, tregon çastet e shoqërimit në polici”,** kronikë, Mariglen Mullai, fq. 6.

Në këtë faqe kemi një intervistë me ligjëruesin e xhamisë së rrugës së Kavajës, Ahmed Kalaja, rreth shoqërimit të besimtarëve muslimanë në Drejtorinë e Policisë Tiranë, dega e Antiterrorit. Pyetjes së gazetarit se si i kanë marrëdhëniet me Selim Muçën dhe Ilir Kullën, ai i përgjigjet, citojmë: “Myslimanët

²² Ky shkrim paralajmërohet me germa të mëdha qysh në faqe të parë, porse me një titull tjetër: “Në polici “myslimanët ekstremistë”, ku “myslimanët ekstremistë” është futur në thonjëza në formë ironie.

²³ Këto shkrime të Metropolit paralajmërohen në kopertinë nën titullin: “Islamofobia, antiterrori shoqëron pesë imamë”, nëntitull “Selim Muça: Më kërcënojnë vetëm mediat. Kush bëri denoncimin”.

janë fyer deri në një farë mase dhe ç'është e vërteta atakimi ynë me këta dy figura të nderuara qëndron, por në përmasa minimale në krahasim me ato që thuhet". Ndërkaq në një vend të veçantë jepen deklaratimet e Kullës se e kanë kërcënuar nëse do të merret me punët e bashkësisë islame. Po në këtë faqe jepet lajmi se nuk ka asnjë kallëzim në prokurori nga Ilir Kulla e Selim Muça. Në një tjetër vend jepen arsyet e shkarkimit të ish-sekretarit të BISH, Zylyftar Dervishi, që ka falsifikuar diplomën e shkollës së lartë.

"Antiterrori shoqëron pesë imamë", kronikë, Mariglen Mullai, fq. 7.

Edhe në këtë shkrim flitet për shoqërimin e të pesë imamëve dhe marrjen në pyetje prej ekspertëve të antiterrorit për shkak të disa kërcënimeve që kanë marrë Selim Muça dhe Ilir Kulla. Konflikti ka nisur pas një peticioni të nënshkruar nga 10 imamë "për pastrimin shpirtëror të muslimanëve" dhe bëhet fjalë për përjashtimin nga detyra të ish-sekretarit Dervishi dhe dërgimin e tij si klerik në Lushnjë. Ndërkaq në një vend të posaçëm jepen deklaratimet publike të kreut të BISH, Muça, i cili thotë se nuk e kërcënuar njeri dhe nuk mban asnjë truproje. Në një tjetër vend jepen deklaratat e Policisë së Tiranës, citojmë: "Zëdhënësja e Drejtorisë së Policisë së Tiranës, Alma Katragjini, tha dje për gazetën se personat u morën në pyetje nga ekspertët e antiterrorit, të cilët panë të gjitha mundësitë për të zbardhur ngjarjen. Por problemi kyç, sipas burimeve të tjera policore, qëndron në faktin se në Policinë e Tiranës nuk është regjistruar asnjë denoncim nga ndonjë i kërcënuar. Kështu që nuk mund të nisin hetimet pa pasur pista paraprake, emra, apo numra telefonash, nga ku pretendohet se janë kërcënuar kryetari i Kulteve, Ilir Kulla dhe kreu i Komunitetit Mysliman, Selim Muça". Në një cep tjetër jepet e gjithë ecuria e vrasjes së ish-sekretarit të KMSH, Salih Tivari dhe hetimet rreth kësaj ngjarje.

79. E martë 14 qershor 2005

gazeta **"Ballkan"**

"Muça: Nuk jam kërcënuar nga askush", mbititull *"Reagon kryetari i Bashkësisë Islame: Shtëpia ime nuk ruhet dhe as survejohet nga ndonjë polic"*, kronikë, Klodiana Sadiku, fq. 6.

Në këtë shkrim jepen fillimisht deklaratimet e kreut musliman Muça, i cili mohon të ketë marrë kërcënime nëpërmjet telefonit, e-mailit apo ndonjë mjeti tjetër. Më poshtë jepen deklaratimet e policisë se kreu i KSHK, Kulla, ka marrë kërcënime, i citojmë: "Nëse do të vazhdosh t'i fusësh hundët në Bashkësinë Islame

Shqiptare, atëherë ata do të reagojmë ndryshe”, ky është edhe thelbi i kërcënimeve. Në një kuadrat të veçantë është vendosur shkrimi me titull: **“15 imamë shoqërohen në polici, më pas lirohen”**. Këtu jepet njoftimi i shoqërimit të 15²⁴ imamëve për shkak të kërcënimeve që kanë marrë Muça dhe Kulla, por që më pas janë lënë të lirë pasi nuk ka pasur asnjë shkak për t'i mbajtur më tej ata. Ndërkaq njëri prej imamëve që nuk përmendet me emër citohet të ketë thënë: “Megjithatë, ai mbetet kreu ynë dhe ne e respektojmë. Por kjo s'do të thotë që për kreun të mos ketë kritika,...”.

80. E martë 14 qershor 2005

gazeta **“Shekulli”**

“Kërcënimi, 15 klerikë myslimanë në polici”, kronikë, Dashmir Bıçaku, fq. 5.

Në këtë shkrim përcillet përsëri lajmi si në gazetat e tjera për kërcënimet, por në dallim nga të tjera, emri që përmendet nga të BISH, nuk është më kryetari i saj Selim Muça, por sekretari i sapo-zgjedhur Betim Truçi²⁵. Kështu jepet edhe hetimi i antiterrorit për kërcënimet ndaj Truçit dhe kreut të KSHK, Ilir Kulla. Po ashtu citojmë nga shkrimi: “Një trakt i hartuar me mesazh kërcënues duket se ka ndezur dhe një tjetër konflikt, në radhët e Bashkësisë Islame. Sipas burimeve policore, mesazhi kërcënues ka shkuar në adresë të kryetarit të Komitetit të Kulteve, Ilir Kulla dhe sekretarit të sapoemëruar të Bashkësisë Islame, Truçit”. Ndërsa në një kuadrat të veçantë bëhet e ditur se ka qenë kreu i KSHK, Ilir Kulla, ai që ka bërë denoncimin në policinë e Tiranës dhe menjëherë pas denoncimit ka lëvizur edhe sektori i Antiterrorit për të bërë hetime.

“Themelohet në gjykatë komuniteti mysliman paralel”, mbititull *“Forumi Mysliman i Shqipërisë u themelua nga ish-anëtarë të Bashkësisë Islame”*, kronikë, Ened Janina, fq. 5.

Në pak rreshta jepet themelimi i këtij Forumi, për të cilin pretendohet nga shkruesi se themeluesit janë ish-anëtarë të komunitetit mysliman. Jepen emrat e themeluesve të këtij forumi, të cilët janë: Fisnik Kruja, Mentor Lamaj, Eliaz Kolçe dhe Redi Shehu. Kështu jepen edhe disa pika të nenit 2 se si

²⁴ Veçanërisht nga të gjitha gazetat e tjera që e kanë dhënë numrin e të shoqëruarve në 5 ose 6, kjo gazetë dhe Shekulli e japin 15.

²⁵ Vetë Truçi së bashku me kryetarin Selim Muça e kanë mohuar kategorikisht të kenë marrë kërcënime për jetën, në një konferencë për mediat e mbajtur në ambientet e BISH, ditën e martë më datë 14 qershor 2005.

do të funksionojë ky organizëm, gjithashtu për mbledhjen e këtij forumi disa ditë më parë si dhe ngritjen e degës së Forumit në Shkodër ku ka marrë pjesë dhe një imam xhamie.

81. E mërkurë 15 qershor 2005

gazeta “Shekulli”

“**Trakti kërcënues**”: **Ja shkeljet në Komunitet**”, kronikë, Aleksandra Bogdani, fq. 7.

Në këtë shkrim flitet për të ashtuquajturin ‘trakt’, i cili është një petition i zakonshëm i nënshkruar normalisht nga Myftiu i Tiranës dhe imamët, drejtuar kreut të BISH, Selim Muça. Në të jepet një përmbledhje ngjarjesh , të cilat përbëjnë edhe shqetësimin e petitionit të besimtarëve. Flitet për shkarkimin e Zylyftar Dervishit dhe dërgimin e tij në Lushnje si myfti. Po ashtu përmendet se në këtë petition kreu i BISH ka marrë pjesë në fushatën elektorale të kandidatit socialist në Peshkopi Bashkim Haxhiu. Më poshtë nën një titull të veçantë “**Muça: Asnjë kërcënim për mua apo vartësit**”, jepen deklaratat e kreut të BISH Muça se në asnjë mënyrë nuk ka qenë i kërcënuar në ndonjë lloj forme. Po ashtu ai ka mohuar të ketë denoncuar në Drejtorinë e Policisë për të ashtuquajturat ‘kërcënime’ dhe nëpërmjet kësaj konference për mediat ai u ka bërë thirrje imamëve të xhamive Tiranës “...të mos deklarohen në media pasi në këtë mënyrë nxisin përçarjen”.

“**Reagimi - Forumi Mysliman: Nuk rivalizojmë Komunitetin**”, E. Janina, fq. 7. Në një shkrim shumë të shkurtër jepet reagimi i këtij Forumi se nuk po rivalizojnë me BISH. Në deklaratën e tyre për shtyp ata kanë mohuar që të ketë si synim përçarjen e myslimanëve shqiptarë ose rivalizimin e institucioneve ekzistuese të fesë islame në Shqipëri.

82. E mërkurë 15 qershor 2005

gazeta “Korrieri”

“**Muça: Politikanë, larg myslimanëve**”, ngjarje dite, Sokol Çobo, fq. 2.

Në këtë shkrim të ndërtuar mbi konferencën e medias të kreut të BISH, Selim Muça, jepet thirrja publike e tij që forcat politike në asnjë mënyrë të mos përdorin besimtarët për qëllimet e tyre elektorale. Kreu Muça nuk ka përmendur emra të veçantë se kush janë ato që po e shfrytëzojnë këtë ngjarje. Gjithashtu ai ka mohuar të ketë marrë pjesë vetë në ndonjë fushatë elektorale të kandidatëve të ndryshëm, citojmë: “Selim Muça, nuk ka marrë pjesë në asnjë fushatë elektorale të ndonjë

kandidati në Dibër ku ka më shumë se tetë muaj që nuk kam shkuar”. Po ashtu jepet një deklaram i grupit të imamëve pasi kanë dalë nga ambientet e Antiterrorit në Tiranë, citojmë: “është një show mediatik në prag të zgjedhjeve elektorale, ku qeveria duket se duhet të bëjë një figurë të mirë në arenën ndërkombëtare”.

Një vend të posaçëm jepet lajmi se në predikimin e së premtes rryma selefiste ka mbetur e pakënaqur me emërimin e Zylyftar Dervishit myfti në Lushnje.

“E vërteta e organizatës “Forumi Mysliman Shqiptar”, Sokol Çobo, fq. 2.

Intervistë me nënkryetarin e BISH Bledar Myftari rreth organizatës së Forumit Mysliman. Myftari deklaroi se BISH është i vetmi organ përfaqësues dhe administrues i muslimanëve shqiptarë. Forumi është një OJQ si të tjerat dhe janë institucionet kompetente ato që vendosin nëse ka përplasje ose jo. “Muça dhe Kulla u kërcënuan me jetë”, red.kro, fq. 2. Ky lajm i shkurtër ka të bëjë me shoqërimin në Seksionin e Antiterrorit të imamëve të xhamive të Tiranës dhe prononcimin për mediat të zëdhënësës të Drejtorisë të Policisë së Tiranës, Alma Katragjini, rreth kësaj ngjarjeje. Citojmë zëdhënësen: “Shoqërimi dhe marrja në pyetje e personave të mësipërm, u bë për verifikim dhe sqarimin e rrethanave, të kërcënimit për jetën të Kryetarit të Komunitetit Shtetëror të Kulteve Ilir Kulla, dhe të Sekretarit të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman Shqiptar, Selim Muça²⁶”.

83. E mërkurë 15 qershor 2005

gazeta “Express”

“Kërcënimi, dyshimet mes “Tivarit” dhe “Kullës”, “Antiterrori heton dy pista. Kreu i Kulteve sajoi për reputacion, apo u kërcënuan se mohoi selafistët”, kronikë e zezë, F. (Fabiola) Bramo, fq. 8.

Në pjesën e parë të këtij shkrimi jepen dyshimet se ato që kërcënuan Ilir Kullën dhe Selim Muçën, mund të jenë njëkohësisht edhe vrasësit e ish-sekretarit të KMSH, Salih Tivari. Sipas burimeve policore, të interesuarit për këto veprime nuk janë tjetër veçse anëtarë fanatikë të sektit të selafijve. Kështu në vazhdim thuhet se selafijtë kërkuan të dilnin fe më vete, por hasën në kundërshtimet e Ilir Kullës dhe kështu fanatikët e kërcënuan nëpërmjet celularit. Ndërkaq nga ana

²⁶ Këtu ka një gabim nga zëdhënësja! sepse, o flitet për Selim Muçën dhe ai është kryetari dhe jo sekretari, ose cilësimi i postit është në rregull dhe bëhet fjalë për sekretarin e sapoemëruar Betim Truçi.

tjetër të njëjtat burime të Ministrisë së Rendit Publik bëjnë me dijeni se ky mund të jetë edhe një show elektoral i Ilir Kullës që është kandidat i PS në Korçë. Jepet edhe deklarata e kreut të BISH, Muça, i cili ka mohuar kategorikisht të jetë i kërcënuar. Nën titullin **“Shoqërimet dhe avokati i refuzuar”**, bëhet me dijeni lajmi i shoqërimit të imamëve në Seksionin e Antiterrorit dhe pasi janë hetuar janë lënë të lirë të shkojnë në shtëpi më pas. Burimet e Rendit kanë deklaruar se, citojmë: “Nuk mund të nisim hetime për këtë ngjarje, pasi nuk kemi marrë ndonjë denoncim nga zotërinjtë e kërcënuar”.

“Kulla: Unë kundërshtova krijimin e Forumit Mysliman Shqiptar”, B. (Bledi) Gila, fq. 8.

Në këtë shkrim jepet kundërshtimi publik i kreut të KSHK, Ilir Kulla ndaj legalizimit të Forumit Mysliman, për shkak se bie ndesh me kushtetutën. Kështu ai do t'i bëjë një kërkesë kryeministrit, për t'i deleguar më pas presidentit, ku do të kërkojë anulimin e licensës dhe dënimin e gjyqtares. Themelimin e këtij Forumi ai ia atribuon selafistave, citojmë: “Para pak kohësh, selafistët kanë krijuar Forumin e Myslimanëve Shqiptar”.

84. E mërkurë 15 qershor 2005

gazeta **“Ballkan”**

“Muça këmbëngul: Nuk ndjehem i kërcënuar”, kronikë, pa autor, fq. 9.

Në këtë shkrim të shkurtër i bëhet jehonë konferencës për mediat të mbajtur një ditë më parë, të kreut të BISH, Selim Muça. Po ashtu jepet mohimi i tij kategorik të ketë marrë ndonjë kërcënim. Po ashtu jepet sqarimi i policisë se shoqërimi i imamëve u bë për të sqaruar rrethanat e kërcënimit të kryetarit të KSHK, Ilir Kulla. Po ashtu në këtë konferencë Muça ka pohuar se ka dy rryma të ndryshme brenda Bashkësisë.

85. E enjte 16 qershor 2005

gazeta **“Shekulli”**

“Myftari: Imamët në polici, është për të ardhur keq”, kronikë, Ened Janina, fq. 7

Kjo është një intervistë e nënkryetarit të BISH, Bledar Myftari, dhënë kësaj gazete si koment rreth ngjarjeve të Komunitetit Mysliman, si dhe për shoqërimin e imamëve në Seksionin e Antiterrorit të Drejtorisë së Policisë Tiranë. Myftari sqaron rrethanat që shtynë një grup drejtuesish dhe besimtarësh të bëjnë një shkresë të brendshme ku shprehnin shqetësimet e tyre. Kjo letër ka ndenjur e afishuar nëpër xhamitë e Tiranës.

Myftari e ka cilësuar shoqërimin e imamëve në polici, citojmë nga intervista: “Është për të ardhur keq, që persona të cilët janë njerëz me reputacion, liderë shpirtërorë në vendet e kultit, që janë xhamitë, të shoqërohen për sqarime, më saktë të ftohen në strukturat e caktuara të policisë së shtetit”. Po ashtu i pyetur për çështjen se a mundet Forumi Mysliman të jetë një komunitet paralel, ai i përgjigjet se asnjë lloj OJQ-je nuk mund të marri përsipër administrimin, menaxhimin e udhëheqjen e jetës fetare të Komunitetit Mysliman.

86. E diel 19 qershor 2005

gazeta “Albania”

“Imamët: ‘Bashkësia Islame nuk na mbrojt’”, “Imamët: ‘Ja lojërat e fshehta në kupolën e Komunitetit Mysliman’”, speciale, Ergys Mërtiri, fq. 10-11.

Në këtë speciale përmbledhet ajo çka ndodhur pas denoncimit të bërë në publik nga mediat e ndryshme si “kërcënime për jetën” që kanë marrë kreu i KSHK, Ilir Kulla dhe kryetari i BISH, Selim Muça. Po ashtu jepet prononcimi i imamit të xhamisë së Tabakëve, Elvis Naçi rreth letrës drejtuar kryetarit të BISH, Selim Muça, letër e cila ishte edhe shkaku i të gjithë zhurmës së shkaktuar. Po ashtu imami Elvis Naçi shpreh edhe shqetësimin e tij për thirrjen që u është bërë në ambientet e Drejtorisë së Policisë së Tiranës, seksioni i Antiterrorit, citojmë: “Thirrja e imamëve në polici ka shkaktuar habi te ne për vetë faktin se nuk ka asnjë arsye për këtë”. Po ashtu ai deklaroi pak më poshtë se, citojmë: “Ne ndihemi mjaft të ofenduar nga fakti që kryetari i Bashkësisë Islame nuk ka reaguar për këtë veprim, i cili në radhë të parë cenon imazhin e këtij institucioni”. Ndërsa shkrimi në vijim është letra e plotë e imamëve drejtuar kryetarit të BISH, Selim Muça dhe që u bë më vonë publike në të gjitha ambientet e xhamive të kryeqytetit. Aty ata i kërkojnë kreut Muça të marri masa kundrejt ish-sekretarit Dervishi për diplomën e falsifikuar dhe që e kaluan përsëri myfti në Lushnje, si dhe kundrejt Tomor Ballabanit që edhe ky si Dervishi nuk ka diplomën e duhur për të mbajtur postin e myftiut të Lezhës. Po ashtu jepen edhe disa shqetësime të tjera që kanë të bëjnë po me z. Dervishi dhe deklaratimet e tij të bëra publikisht në TV Klan. Në një pikë të veçantë trajtohet me shqetësim se në Vizion Plus është trajtuar fakti që kreu Muça ka bërë fushatë elektorale në favor të një kandidati socialist në rrethin e Dibrës. Pjesa e fundit e kësaj letre është e nënvizuar me të zezë dhe që kjo mendohet të ketë sjellë shqetësimin e kreut të KSHK,

Kulla dhe për pasojë edhe denoncimin e tij në polici në emër të vet, por edhe për kryetarin e BISH, Muça dhe sekretarin e sapoemëruar Betim Truçi.

87. E shtunë 25 qershor 2005

gazeta "55"

"Fjalori i Dizdarit dhe gjuha shqipe pa dizdar", kulturë, Mehmet Elezi, fq. 19.

Në këtë faqe kulture flitet për fjalorin e orientalizmave të Tahir Dizdarit si dhe daljen në dritën e botimit të këtij fjalori 34 vjet pas vdekjes së autorit. Në këtë shkrim artikullshkruesi flet gjerë e gjatë për përparësitë e këtij fjalori, si dhe për ndërtimin e tij. Po ashtu jep edhe disa çaste të rëndësishme të jetës së Tahir Dizdarit ku përmend faktin se ka qenë i internuar gjatë kohës së fashizmit dhe gjatë regjimit komunist. Gjithashtu ai lavdëron edhe botuesit e këtij fjalori që gjetën mundësitë financiare për ta shtypur, citojmë: "Lumturisht u gjet një qendër jo-shtetërore që i doli për zot: Instituti Shqiptar i Mendimit e i Qytetërimit Islam (AIITC). Kjo qendër u lidh me një simotër në Marok, e cila sponsorizoi. Falë këtij bashkëpunimi gjuha shqipe ka tashti të botuar një prej veprave madhore të saj".

88. E shtunë 25 qershor 2005

gazeta "Gazeta Shqiptare"

"Në kërkim 13 agjentë të CIA për terroristin e Tiranës", aktualitet, pa autor, fq. 10.

Në këtë shkrim flitet për aksionin e rrëmbimit të të ashtuquajturit Abu Omar (Osama Nasser Mustafa) nga një aksion i CIA në Milano të Italisë në vitin 2003. Ky veprim i këtyre 13 agjentëve është konsideruar i padrejtë nga një gjykatë italiane dhe këta agjentë të CIA-s janë shpallur në kërkim nga Policia e Milanos. Kështu jepet zhvillimi i ngjarjeve si ka ndodhur rrëmbimi i Abu Omarit dhe si është dërguar në Egjipt dhe është torturuar çnjerëzisht nga shërbimet sekrete.

"Gruaja shqiptare denoncoi", nëntitull "*Padia për rrëmbimin u firmos në Tiranë*", aktualitet, fe.de., fq. 11.

Në vazhdim të shkrimit të mësipërm jepet mënyra se si u arrit që të ngrihej padia ndaj këtyre 13 agjentëve të CIA. Është gruaja shqiptare e Abu Omarit, Marsela Glina. ajo që i ka paditur ata për rrëmbim personi, gjë që ka ndodhur në Milano, në territor italian, dhe kjo i bën autorët e rrëmbimit të ndjekshëm penalisht. Padia e Marsela Glinës është firmosur në Tiranë dhe kjo ka qenë shtytja e autoriteteve italiane për të ndërmarrë hetimin.

89. E diel 25 qershor 2005

gazeta "DITA"

"Tulipanët', asimilimi dhe myslimanizmi", koment, Albert Zholi, fq. 10.

Në këtë koment nga autori jepen disa vlerësime për problemet e emigracionit në vendet evropiane dhe në veçanti për Holandën. Një nga problemet që po përjeton ky vend është ai i emigracionit dhe bëhet më i ndjeshëm ndaj emigrantëve që vijnë nga vendet muslimane. Qeveria holandeze dhe kryeministri i saj Balkanere në një letër të posaçme i drejtohej të gjitha vendeve evropiane për rastin kur kineasti holandez Van Gog u vra nga 'fanatikë ekstremistë' me gjasa nga Maroku. Në këtë letër kryeministri holandez për herë të parë përdor termin asimilim të emigrantëve dhe jo integrim që është përdorur deri tashti gjerësisht nga të gjithë. Më poshtë ky autor vazhdon të bëjë komente rreth strategjive të ndryshme në Evropë për emigrantët e ndryshëm dhe veçanërisht përmend frikën dhe rezervat që kanë këto vende ndaj emigrantëve muslimanë.

90. E martë 28 qershor 2005

gazeta "SOT"

"Terrorizmi dhe kundërterrorizmi", koment & analizë, Albert Zholi, fq. 11.

Në këtë analizë flitet fillimisht për efektet psikologjike që ka krijuar tashmë imazhi i Bin Ladenit në mediat e ndryshme perëndimore. Në paragrafin e parë ngrihen disa pyetje prej autorit, ku më e rëndësishmja është si ka mundësi që nuk po kapet Bin Ladeni! Ndërkaq një përgjigje vjen më poshtë prej Kenneth Allard, ish-kolonel i kundërzbulimit në ushtrinë amerikane, citojmë: "Së pari shumë myslimanë do ta nderonin si martirë. Së dyti, nëse kapet i gjallë ai do të flasë në gjykimin e tij për të grumbulluar militantët. Të dyja këto mund të ndikojnë për sulme të reja në Shtetet e Bashkuara të Amerikës". Më pas flitet për sondazhet e bëra për sigurinë, si dhe masat e marra dhe mjetet e ndryshme që do të rrisnin nivelin e sigurisë, por që do të sjellin edhe dhunimin e jetës private të individëve. "Një raport, që iu paraqit Parlamentit European më 11 korrik 2001, nxirrte si përfundim se 'ekziston një system botëror që bën të mundur përgjimin e komunikimit dhe që funksionon në saje të bashkëpunimit... të SHBASë, Britanisë së Madhe, Kanadasë, Australisë dhe të Zelandës së Re".

Muaji Korrik 2005

91. E martë 12 korrik 2005

gazeta “SOT”

“Pse Kadareja shfaqet si racist kundër shumë kombësive”,
Kastriot Myftaraj, fq. 16-17.

Ky autor bën një analizë të veprës së Kadaresë për të nxjerrë në pah racizmin e këtij shkrimtari, duke cituar pjesë të ndryshme nga vepra e tij. Në këtë shkrim ai rreket të nxjerri në pah ndjenjat antisemite të Kadaresë, duke i shtuar këtij termi edhe atë islamik, antisemitizëm islamik që deri tani nuk ka gjetur vend në të gjithë analistët dhe politologët botërorë e shqiptarë. Citojmë nga shkrimi: “Antisemitizmi i Ismail Kadaresë vjen nga dy burime, ai është antisemitizëm islamik dhe antisemitizëm komunist. Në mjedisin familjar islamik ku u rrit Kadare, antisemitizmi merrej njëlloj si ajri që thithej, nga bisedat e të rriturve”. Po kështu vazhdon ta zbërthejë idenë e tij ky autor se Kadareja nuk është me prejardhje shqiptare dhe se ka një urrejtje të thellë racore për të gjithë kombet e tjerë.

92. E diel 17 korrik 2005

gazeta “Gazeta Shqiptare”

“Mediatori shqiptar liron 3 pengjet rumune në Irak”, faqja e parë, pa autor, fq. 2.

Në këtë shkrim flitet për ndërhyrjen e dytë të suksesshme të kreut KSHK, Ilir Kulla në Irak, për lirim të 3 pengjeve rumunë. Këto tre pengje ishin gazetarë të mediave rumune dhe falë miqësisë të krijuara në Lindjen e Mesme të Ilir Kullës, ai ndërhyrjen përsëri, duke u liruar këto tre pengje. Një nga miqtë e tij është edhe djali i myftiut të madh të Sirisë, Salah El Din Kuftaro.

“Misioni im nga Korça në Damask”, faqja e parë, pa autor, fq. 3.
Intervistë e kreut të KSHK, Ilir Kulla rreth kësaj ngjarjeje.

93. E diel 12 korrik 2005

gazeta “Express”

“Kurani dhe përparësia e ligjit”, e hapur, Magdi Allam, fq. 15.

Ky është një koment i marrë nga faqet e gazetës “Corriere della Sera”, përreth deklarimit të “British Muslim Forum” ndaj sulmeve terroriste të 7 korrikut në metrotë e Londrës. Ky forum

e ka dënuar sulmin terrorist, por pikërisht ky dënim i bërë nga këta persona ka sjellë edhe shqetësimin e artikullshkruesit. Citojmë nga shkrimi: “A kemi parasyshë çfarë po bëjmë? Jemi duke legjitimuar binarin e dytë juridik në gjirin e shtetit të së drejtës, ligjin e rregulltë për autoktonët dhe sharian për muslimanët”. Me këtë koment autori del kundra këtyre zhvillimeve duke e cilësuar multikulturalizmin, e citojmë përsëri: “Multikulturalizmi së pari ka lëshuar mjekërat e fatvas dhe sharias, pastaj ka sjellë monstrën e terrorizmit vrasës. Janë dy anë të së njëjtës monedhë”.

94. E martë 26 korrik 2005

gazeta “Metropol”

“**Kontroll islamikëve në Rinas me qen antiterror**”, kronikë, Mariglen Mullai, fq. 7.

Në këtë shkrim flitet për masat antiterror të marra në aeroportin ndërkombëtar të Rinasit nga autoritetet shtetërore. Kështu është forcuar regjimi i sigurisë dhe i kontrollit të pasagjerëve që vijnë kryesisht nga vendet islamike. Po ashtu njoftohet se është rritur bashkëpunimi ndërmjet Policisë së Shtetit dhe SHISH.

95. E martë 26 korrik 2005

gazeta “Shekulli”

“**Velo dhunohet në mes të Tiranës**”, nëntitull “*Piktori: ‘Dyshoj se njerëzit që më sulmuan i përkasin qarqeve islamike ose komuniste’*”, kronikë, Ened Janina, fq. 6.

Në këtë shkrim paraqitet sulmi me ofendime që i është bërë piktorit Maks Velo nga disa të panjohur. Pasi jepet me hollësi se si ka ndodhur ngjarja, jepen hamendësimet e Velos se kanë qenë pjesëtarë të qarqeve islamike ose komuniste. Citojmë nga shkrimi Maks Velon: “Unë dyshoj se janë disa qarqe tiranase islamike, të cilët janë njerëz me të cilët kam pasur konflikte për deklaratat mediatike që kam bërë”. “Mendoj se mund të kenë qenë edhe komuniste sepse ata janë acaruar shumë me mua pas një diskutimi që kam bërë në media”.

96. E martë 26 korrik 2005

gazeta “Shekulli”

“**Burimi i freskët i Et’hem Beut**”, kulturë, Alma Mile, fq. 18.

Në këto rreshta bëhet fjalë për rizbulimin e pusit të vjetër të xhamia e Et’hem Beut në qendër të Tiranës. Ky rizbulim është bërë edhe me ndihmën e njërit prej kujdestarëve të kësaj

xhamie. Po ashtu janë botuar edhe foto të këtij pusi, si dhe jepet një historik i shkurtër i ndërtimit të kësaj xhamie nga Molla Beu dhe Et'hem Beu. Pusi është rivënë në përdorim, por akoma uji nuk është i pijshëm se nuk janë bërë pastrimet e duhura. Më pas njoftohet edhe për punën e restauratorëve të IMK-së për mirëmbajtjen e afreskeve të xhamisë.

97. E mërkurë 27 korrik 2005

gazeta "Korrieri"

"Berisha dhe tymnaja islamike e Çoviçit", forum, Xhavit Shala, fq. 18.

Autori i këtij shkrimi i bën një koment një interviste që ka dhënë Nebojsha Çoviç, Kryetari i Qendrës Koordinuese për Kosovën, thënë shkurt koordinatori i politikës serbe në Kosovë, për ndryshimin e pushtetit politik në Shqipëri. Ky person ka shprehur shqetësimin se pushteti i Berishës do të jetë pro-islamik, ndërsa autori i këtij shkrimi përpiqet të vërtetojë të kundërtën. Çoviçi është shprehur se një grup studentësh që kanë mbaruar studimet në vendet arabe ia kanë dalë të krijojnë një fraksion dhe ta legalizojnë atë, kundër Bashkësisë Islame. Citojmë nga shkrimi: "Ky grup ia ka dalë të legalizojë aktivitetin e vet, me formimin e organizatës së re me emrin Forumi Musliman Shqiptar," thotë Çoviç". Ky autor mundohet t'i hedhi poshtë akuzat e Çoviçit, duke i konsideruar lëvizjet brenda BISH si procese normale. Ai shpreh mendimin se qeveria e re e Berishës do të zgjidhi edhe problemet e zvarritura të komuniteteve fetare.

Muaji Gusht 2005

98. E martë 2 gusht 2005

gazeta "DITA"

"Një vështrim islam mbi femrën"²⁷, nëntitull "Të përbashkëtat e kulturave orientale deri në zbritjen e Kur'anit, që i dha gruas të drejtën e pronës", speciale, Napolon Zeqiri, fq. 14-15.

Në këtë speciale të përgatitur për të drejtat e grave gjatë të gjithë kohërave flitet për padrejtësitë që u janë bërë atyre nga civilizimet e ndryshme. Më saktë tek grekët e vjetër, Italia e vjetër, romakët, kinezët, indianët, në Evropë në përgjithësi, arabët para Islamit dhe çka thotë feja islame për gruan. Një theks i veçantë i vihet faktit se gruaja me ardhjen e Islamit fitoi të drejtën e trashëgimisë, gjë të cilën edhe ne Evropën e qytetëruar e fitoi shumë vonë, pas mesit të shekullit të kaluar. Ndërsa për të drejtat e femrës në Islam, citojmë nga shkrimi: "Për dallim nga kulturat e tjera, Islami i jep të drejta të shumta; njëra prej tyre është që ajo ta mbajë mbiemrin e saj pas martesës. Ajo ka të drejtë të ketë identitetin e vet dhe për dallim nga kulturat e tjera ajo nuk e ka caktuar raportin me burrin e saj. Pasuria që sjell në shtëpinë e burrit mbetet e saj dhe vetëm ajo ka të drejtë në shfrytëzimin e saj".

99. E mërkurë 3 gusht 2005

gazeta "Korrieri"

"Kajro, metropoli i Islamit", "Në Kajro, qytetin ku këndojnë 'të gjithë' Muezinët e Botës", reportazh nga Kajro, Ben Andoni, fq. 13-15.

Ky është një reportazh i gjatë nga Kajro, ku flitet gjerësisht për këtë qytet të vjetër dhe të shkuarën e tij. Në këtë shkrim autori flet edhe për koloninë shqiptare të Kajros dhe patriotët e Rilindjes si dhe për shqiptarët që kanë dhënë kontributin e tyre në Egjipt. Ky reportazh vjen menjëherë pas shpërthimeve që ndodhën në Sharm el-Sheikh. Në një zë të posaçëm autori flet edhe religjionin mbizotërues që është Islami dhe duke e nxjerrë në plan të dytë me gjithë ndikimin e madh që ka ai. Citojmë nga shkrimi: "Por, nga ana tjetër, të rinjtë duken se

²⁷ Ky shkrim paralajmërohet në faqen e parë me titullin tjetër: "Krimet që i paraprinë barazisë së femrës".

pak përpiqen të ngjajnë shumë me Perëndimin. Ata janë krenarë për kulturën dhe më shumë përpjekjet e tyre për identitet. Dhe, nuk ka sesi të ndodhë ndryshe. Vendi tashmë është i hapur ndaj internetit dhe McDonalds janë mbira kudo, duke dhënë kudo një faqe tjetër të vendit, i cili dallon mbi të gjitha vendet e tjera arabe”.

100. E shtunë 6 gusht 2005

gazeta “Panorama”

“**Ne myslimanët, kundër terrorizmit**”²⁸, nëntitull “*Deklarata antiradikale te xhamia e Rrugës së Kavajës*”, aktualitet, Trashgim Sokolaj, fq. 10.

Kjo është një intervistë e Myftiut të Tiranës, Bledar Myftari, dhënë kësaj gazete ku edhe një herë tjetër KMSH deklarohet publikisht kundër të gjithë formave të terrorizmit dhe shpërthimeve të fundit që ndodhën në Londër, Sharm el-Sheikh etj. Ndërkaq pyetjes se a mund të rrezikojë Shqipëria për akte terroriste për shkak të trupave të saj në Irak, Myftari i përgjigjet, citojmë: “Për mendimin tim, Shqipëria dhe shqiptarët nuk kanë përçarur ndonjëherë në historinë e tyre ndonjë element të terrorizmit në përgjithësi dhe aq më tepër të atij fetar”. Po ashtu po në këtë faqe ka një prononcim të shkurtër të kreut të KSHK, Ilir Kulla në mbështetje të Komunitetit Musliman.

101. E shtunë 6 gusht 2005

gazeta “Gazeta Shqiptare”

“**Myslimanët shqiptarë kundër terrorizmit**”²⁹, nëntitull “*Myftiu i Tiranës: Predikojmë prej tre të premtesh*”, aktualitet, pa autor, fq. 6. Kjo është një intervistë dhënë kësaj gazete nga Myftiu i Tiranës, Bledar Myftari rreth shpërthimeve që ndodhën një muaj më parë në Londër. Kështu si përfaqësues i rëndësishëm i fesë islame në vend ai i dënon këto atentate dhe shprehet se Islami nuk ka lidhje me këto akte antihumane. Akte të tilla janë dënuar vazhdimisht nga KMSH dhe citojmë nga intervista: “Ne jemi distancuar që të nesërmen e atentateve të premtën e parë si në predikimin në xhami ashtu edhe në mesazhin e ngushëllimit dërguar ambasadorit të madhërisë së saj mbretëreshës Elizabet në Tiranë”.

²⁸ Ky shkrim paralajmërohet në faqen e parë me titullin tjetër: “Myftiu i Tiranës: Te xhamia e Rrugës së Kavajës kundër terrorizmit”.

²⁹ Ky shkrim paralajmërohet në faqen e parë me titullin tjetër: “Dënohen atentatet terroriste: Muslimanët shqiptarë: Londra, tragjedia jonë”.

102. E diel 7 gusht 2005

gazeta “Korrieri”

“Alarmi: ‘Islamikët, në trazirat shqiptare’”, politikë, Elton Metaj, fq. 5.

Në këtë shkrim flitet për takimin e kryeministrit Nano me liderin e partisë së Bashkimit Demokratik për Integrim të shqiptarëve të Maqedonisë, Ali Ahmeti. Në këtë takim janë diskutuar problemet e kohëve të fundit në Maqedoni, ku sipas autorit të shkrimit tema e këtij takimi ka qenë, citojmë: “Elemente islamikë janë përfshirë mes shqiptarëve në rajonin e Kondovës në Maqedoni, duke rrezikuar rindezjen e tensioneve etnike”. Po ashtu flitet edhe për shfaqjen e komandantit rebel në këtë fshat Agim Krasniqi, së bashku me ish-luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare.

103. E martë 9 gusht 2005

gazeta “SOT”

“Europianizimi i myslimanëve”, koment & analizë, Jan Repa (analist i BBC), fq. 11.

Në këtë analizë, shqyrtohet mundësia e integritit të muslimanëve në shoqëritë perëndimore dhe si shkas për mosintegrimin e tyre edhe sot e kësaj dite merret vrasja e regjisorit hollandez Teo Van Gog, nga një musliman i lindur në Amsterdam me origjinë marokene, Mohammed Bouyeri. Në këtë analizë jepen edhe përpjekjet e ndryshme që po bëhen për të realizuar këtë integrim, arsimimi, përshtatja me kulturat vendase etj. Kjo e fundit është adaptuar si ide në Francë. Një nga promovuesit e idesë së europeanizimit të muslimanëve është edhe Tarik Ramadan, egjiptian i lindur në Zvicër. Ai pohon, citojmë nga shkrimi: “Nuk i kërkoj shtetit të jetë tolerant me ne, si komunitet kulturor apo pakicë, ne duhet të kërkojmë të drejtat tona si qytetarë,” thotë ai”.

104. E martë 9 gusht 2005

gazeta “Gazeta Shqiptare”

“Fahd, mbreti saudit që ndihmoi shqiptarët”, botë, Hektor Saliq, fq. 19.

Në këtë shkrim të shkurtër flitet për ndihmat e ndryshme të dhëna nga mbreti saudit Fahd. Vlerësohet veçanërisht ndihma e dhënë gjatë krizës kosovare në Shqipëri në vitin 1999, e më pas në Kosovë. Një tjetër ndihmë e këtij mbreti të vdekur tashmë është edhe programi i Haxhit.

105. E mërkurë 10 gusht 2005

gazeta “Gazeta Shqiptare”

“**Tiranë-Shkup, plas alarmi i islamikëve**”, mbititull “*Shërbimet e huaja sekrete ndjekin gjendjen në zonë. Dyshohen ekstremistë vehabitë*”, aktualitet, pa autor, fq. 7.

Në këtë shkrim bëhet fjalë për takimin e kryeministrit Nano me kryetarin e partisë së Bashkimit Demokratik për Integrim në Maqedoni, Ali Ahmeti. Sipas burimeve të kësaj gazete në këtë takim është biseduar rreth të ashtuquajturës krizë të Kondovës. Po sipas kësaj gazete grupe “ekstremistësh vehabitë” janë përfshirë në protestat e armatosura në këtë fshat. Në këto grupe janë, citojmë: “Disa ish-ushtarë të UÇK-së janë bashkuar me disa djelmoshë me mjekra të gjata dhe pantallona treçerekëshe besimtarë praktikantë të fesë islame, të ashtuquajtur ‘teknirë’”. Po ashtu në fund të shkrimit bëhet me dijeni se ekspertë të CIA-s po ndjekin nga afër gjendjen dhe eksperti i shërbimeve sekrete me bazë në Bruksel, Klod Monik, ka paralajmëruar qysh më parë “zyrtarisht rrezikun e lidhjeve mes një pjese të popullsisë myslimane maqedone dhe grupeve islamike vahabite”.

“**Në Kondovë nuk ka islamikë, por shqiptarë**”, intervistë, bisedoi Elira Çanga, fq. 7.

Kjo është një intervistë me kreun e protestuesve të fshatit Kondovë, ish-luftëtarin e UÇK-së, Agim Krasniqi. Ai mohon kategorikisht që të jenë përfshirë në luftën për Islam, por ato kërkojnë të drejtat e tyre si dhe amnistinë në bazë të marrëveshjes së Ohrit. Kjo është një lojë e Ali Ahmetit që po e ndihmon presidentin maqedanos Branko Cervenkovskit, gjithnjë sipas deklarimeve të bëra në këtë intervistë.

106. E mërkurë 10 gusht 2005

gazeta “Express”

“**Kondova, këmbana që klith**”, speciale, Albert Gjoka, fq. 10.

Në këtë reportazh flitet për gjendjen në fshatin e Kondovës që gjendet pranë qytetit të Shkupit, në Maqedoni. Me gjithë zhurmën e shkaktuar nga ky fshat, vëren autori i reportazhit, aty mbizotëron qetësia dhe se i gjithë ai mobilizim e ajo zhurmë u krijuan për të tërhequr vëmendjen se Marrëveshja e Ohrit nuk po zbatohet. Kështu edhe autoritetet shqiptare ranë në kurthin e ngritur për të shuar këtë lëvizje të etiketuar si “lëvizje ekstremiste islamike”. Për të takuar kreun e kësaj lëvizje në Kondovë mjafton të kishe një shoqërues dhe të paraqiteshe si gazetar i një të përditshmeje të Tiranës. Më pas gazetari i bën

një profil të shkurtër ish-luftëtarit të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, Agim Krasniqi.

“Shqiptarët, jo muxhahedinë”, speciale, Albert Gjoka, fq. 11.

Kjo intervistë më Agim Krasniqin, pason reportazhin e faqes pararendëse dhe mundohet të hedhi dritë mbi të gjithë zhurmën e krijuar nga mediat rreth këtij mobilizimi të shqiptarëve në Maqedoni për të bërë të mundshme realizimin e Marrëveshjes së Ohrit. Biseda është përqendruar rreth zgjidhjes së kësaj krize nëpërmjet bisedimeve. Intervista mundohet të zbulojë dritë-hijet edhe të takimit Fatos Nano – Ali Ahmeti. Kështu në fund pyetjes së intervistuesit se “a ka në mesin e tuaj elementë radikalë islamikë apo jo!”, Krasniqi i përgjigjet: “Nuk ka dhe do të ndjehesha shumë i lumtur nëse subjektet tona shqiptare, anekënd trojeve etnike, do t’i dedektonin vetë këto elemente dhe do t’i ç’rrenjosnin nga trangu ynë kombëtar, por pa na sinjalizuar për rreziqet e tilla eventuale Cërvenkovskat dhe pulenat e tij. Ky problem duhet të jetë vetëm i yni dhe jo “brenjë” edhe e atyre që inskenojnë dhe luajnë lojëra shumë të rrezkshme mbi kurrizin tonë”.

107. E mërkurë 10 gusht 2005

gazeta **“Korrieri”**

“Feja Islame, përballë terrorit mediatik”, forum, Forumi Musliman Shqiptar, fq. 19.

Kjo deklaratë është një reagim ndaj shkrimit të analistit kosovar Baton Haxhiu shkruar një ditë më parë në faqet e po kësaj gazete. Në këtë deklaratë ky forum shprehet se “Feja Islame në Shqipëri po përballet me një terror të vërtetë mediatik”. Më pas vijohet me reagime ndaj shprehjeve që përdorur z. Haxhiu gjatë shkrimit të tij ku jepen shpjegime për shumë terma ndër to edhe kamikaxe, aq shumë i përdorur nga mediat e sotme. Në mbyllje të deklaratës Forumi Musliman shpreh shqetësimin se shtypi shqiptar me këto probleme që po trajton së bashku me shkrimin e Haxhiut, po i bën jehonë përpjekjeve të politikës serbe që i portretizon shqiptarët si “fondamentalistë islamikë”, duke u rrekur që të hutojnë faktorin ndërkombëtar në lidhje me realizimin e pavarësisë së Kosovës.

108. E enjte 11 gusht 2005

gazeta “Express”

“Rreziku islamik, kurthi sllav ndaj shqiptarëve”, intervistë, pa autor, fq. 10.

Një intervistë me politikanin shqiptar Arbër Xhaferri për rastin e fshatit të Kondovës dhe lajmet e përhapura për rrezikun radikalëve islamikë. Në një nga përgjigjet e dhëna Xhaferri thotë se Nano dhe Ahmeti dhe sidomos Nano nuk mund të jetë aq naiv sa të prodhojë një shpifje të tillë që e prodhojnë guzhinat antishqiptare. Ai deklaroi se qarqet antishqiptare po mundohen të prodhojnë idenë se në hapësirat shqiptare nuk ka kauzë shqiptare, por kauzë fetare. Sipas tij këto janë prodhime të serbëve, të cilët duan të marrin një rol të ri në rajon, citojmë: “Serbët e dinë fare mirë që fundamentalizmi islamik nuk i rrezikon ata, por shoqëritë ku në përqindje të madhe jetojnë besimtarë myslimanë. Prandaj në interes të tyre është që të përhapin sa më shumë rrezikun nga militantizmi islamik në këto shoqëri për të pasur mbështetje kërkesa e tyre që të instalohet misioni i policit që do t’i disjplinojë këto sfida të reja”.

108. E premte 12 gusht 2005

gazeta “SOT”

“Banka kombëtare greke, rracizëm ndaj myslimanëve”, sociale, pa autor, fq. 15.

Kjo është një intervistë me një qytetar me prejardhje myslimane, i quajtur Ramazan Byku, i cili pretendon se i është refuzuar dhënia e një kredie nga ana e Bankës Kombëtare Greke në Tiranë. Gjithmonë sipas tij, ai nuk është rasti i vetëm, por dhënia e kredisë i është mohuar edhe 37 personave të tjerë. Ai e akuzon këtë bankë për racizëm ndaj shqiptarëve dhe se po fut ndasi fetare ndërmjet tyre. Qytetari në fjalë i ka marrë këto informacione nga një sekretare e bankës dhe ai në përfundim nuk marrë asnjë lloj përgjigjeje, negative apo pozitive prej bankës.

109. E premte 12 gusht 2005

gazeta “Tirana Observer”

“Si e ktheva oxhakun e fabrikës në minare” dhe “Kavajë, atje ku fabrika shërben si xhami”, reportazh, Dorina Topollaj-Armand Jonuzi, fq. 18-19.

Në pjesën e parë të këtij reportazhi kemi një intervistë me z. Xhafer Shkodra që ka ndërtuar në ambientet e një ish-fabrike në xhami, si dhe oxhakun e saj në minare. Në këtë intervistë

ai shpjegon arsyet se përse e ktheu oxhakun në minare dhe për kthimin e ambienteve në xhami, citojmë nga intervista: “Duke pasur parasysh nevojën që kishte lagjja për një xhami, unë mora iniciativën dhe oxhakun e ktheva në minare dhe një pjesë të vogël të ndërtesës e bëra xhami”. Po në këtë faqe është vendosur një kurrikulum i shkurtër i Xhafer Shkodrës, si dhe 8 miniintervista nga besimtarë të ndryshëm që frekuentojnë këtë xhami. Në faqen pasuese gazetarët tregojnë vizitën që kanë bërë në këtë xhami dhe ambientet e saj. Imami i kësaj xhamie i tregon atyre për punët e përditshme. Shkrimi është i shoqëruar edhe me fotot e kësaj minareje të famshme.

110. E martë 16 gusht 2005

gazeta “Shekulli”

“Njerëz me precedentë drejtues të Komunitetit”, ngjarje e ditës, Lindita Çela, fq. 2.

Në këtë shkrim flitet për një letër petition drejtuar kreut të KSHK-së, Ilir Kulla për problemet e brendshme dhe abuzimet në BISH, ndërsa në fund të letrës firmoset “Me respekt Një grup besimtarësh të Tiranës”³⁰. Në krah të shkrimit është vendosur edhe teksti i letrës së sipërcituar. Po ashtu në këtë faqe jepet edhe një intervistë e shkurtër me kryetarin e BISH, Selim Muça, i cili në mënyrë të prerë kundërshton akuzat e bëra në këtë letër.

111. E martë 23 gusht 2005

gazeta “Albania”

“Islamizmi, pengesë për Shqipërinë europiane?”, opinion, Faik Islami, fq. 10-11.

Në këtë opinion të këtij artikullshkruesi, ai merr në shqyrtim disa çështje që kanë të bëjnë me pyetjen që ngrihet qysh në titullin e madh të këtij shkrimi, si p.sh., “Është Shqipëria vend islamik?”, “Islami dhe Europa”, “Terrorizmi dhe Islami” dhe në fund “Po rreziku për ne?”. Kështu në bazë të këtyre çështjeve që ngre autori mundohet të krijojë kuadrin e gjendjes, duke e plotësuar me thëniet e Profetit Muhamed, të cilat nuk lejnë asnjë dyshim për akuzat që janë ngritur kohët e fundit ndaj Islamit. Autori përmend të mirat që solli Islami dhe për këtë argumentohet me thënie të autorëve të shquar evropianë. Ndërsa për akuzat që i bëhen Islamit ai thotë, citojmë: “Lufta

³⁰ Pas disa hetimeve të bëra me grupe besimtarësh, askush nuk e mori përsipër autorësinë e letrës dhe akuzave të bëra në të.

kundër islamit është njëherësh edhe mbrojtje që i bëhet terrorizmit, sepse islami nuk ka asnjë lidhje me terrorizmin. Ca më shumë, as njëra dhe as tjetra nuk kanë lidhje me shqiptarët”.

112. E martë 23 gusht 2005

gazeta “Gazeta Shqiptare Sportive”

“Ne lojtarët, që falemi pesë herë në ditë”, mbititull “*Flasin futbollistët e Dinamos, besimtarë të vërtetë*”, faqja e parë, Jetmir Halilaj, fq. 4.

Në këtë reportazh janë vënë në qendër të vëmendjes futbollistët e Dinamos, të cilët falen pesë herë në ditë dhe në fokusin kryesor është portieri i këtij klubi dhe i kombëtares kuqezi, Ilion Lika. Emra të tjerë janë edhe Alikaj e Deliallisi që falen dhe stërviten e luajnë njëkohësisht. Po ashtu Lika tregon edhe për lojtarët senegalezë që luajnë me Dinamon dhe i përkasin Islamit si fe, por që nuk janë frekuentues të rregullt, si edhe për lojtarin e kombëtares Lorik Canaj. Në fund flet edhe Alikaj që tregon për arsyet e tij ndaj animit nga Islami.

“**Muslimanët, shpirtërisht me futbollin**”, faqja e parë, Fatos Mahmutaj, fq. 5.

Në vazhdim të reportazhit të mësipërm, ky shkrim e përqendron vëmendjen në këtë tendencë të besimtarëve muslimanë. Kështu flitet edhe tendenca të tjera të djemve të rinj muslimanë për tai-fun-do dhe basketboll, porse është më tepër futbollit që mbizotëron në jetën e tyre. Një nga figurat më të spikatura të basketbollit është kampioni Afrim Bilali i Valbonës. Në fund flitet edhe për turnetë e minifutbollit të zhvilluara ndërmjet xhamive të kryeqytetit dhe të rretheve.

113. E shtunë 27 gusht 2005

gazeta “Ballkan”

“**Heshtja e Enverit për vargjet e Kuranit**”, nëntitull “*Pse udhëheqësi komunist pranoi të thuhej në prezencë të tij lutja fetare; ‘Bismilah rrahmani rrahim’*”, dossier, Leonard Veizi, fq. 14-15.

Në këtë dosier flitet për mjeshtrin e famshëm të sportit Ali Kastrati. Vijon qysh nga numri i kaluar dhe në këtë numër flitet edhe për prirjen fetare të mjeshtrit Ali Kastrati, i cili falet rregullisht, citojmë nga shkrimi: “Ngrihet që në orët e para të mëngjesit, shmpin krahët, bën ushtrime aerobike, disa minuta litar dhe një automasazh duke u larë me ujë të ftohtë. Mbasi fshihet me peshqir, shikon sixhaden ku është qëndisur një xhami, kube, busull, ku shigjeta tregin Qabenë (varri i

hazretit Muhamet). Nis ritet duke dialoguar me Zotin. Edhe gjatë viteve të rregjimit komunist, kur besimi në fe cilësohej si herezi, Ali Kastrati nuk ka pranuar ta lënë këtë dialogim shpirtëror”. Më tutje vazhdohet me një intervistë të Mjeshtrit, i cili tregon për Enver Hoxhën dhe sesi një herë në prani të tij kur po i bënte masazh ai tha “bismilahin”. Kështu Enver Hoxha kur i bënë vërejtje Ali Kastratit për këtë gjë tha, gjithnjë sipas vetë Mjeshtrit: “Lere Aliun të punojë i qetë”. Kështu jepen edhe dëshmi të tjera të mjeshtrit për gjeneral Spiro Moisiun dhe Beqir Ballukun.

Muaji Shtator 2005

114. E mërkurë 14 shtator 2005

gazeta “Panorama”

“**Medreseja e Tiranës flet turqisht**”, mbititull “*Trupi pedagogjik proteston kundër Komunitetit Mysliman. Ikën gjuha shqipe pas 82 vjetësh*”, aktualitet, Keti Banushi, fq. 8.

Në pjesën e parë të shkrimit jepet një farë historiku i Medresesë së Tiranës për sponsorizuesit. Më pas tregohet se një shoqatë turke ka marrë drejtimin e Medresesë pasi e ka lënë sponsorizimin e saj një shoqatë arabe. Burim shqetësimi i kontratës së nënshkruar ndërmjet Komunitetit dhe kësaj shoqate është bërë futja në programin mësimor e gjuhës turke. Mësuesit e trupit pedagogjik i janë drejtuar me një letër proteste kryetarit të BISH, Selim Muça dhe drejtorit të arsimit Saimir Rusheku. Po ashtu sipas shkrimit ato kanë propozuar që Medreseja të kalojë me vetëfinancim. Në një vend të veçantë jepet edhe një prononcim i kreut të KSHK, Ilir Kulla, si një kontratë e jashtëligjshme.

115. E enjte 15 shtator 2005

gazeta “Panorama”

“**Medreseja e Tiranës, tani pa identitet**”, aktualitet, Keti Banushi, fq. 11.

Në këtë intervistë me ish-mësuesin e anglishtes Telat Sula i pushuar dy ditë më parë jepet gjendja e Medresesë pas nënshkrimit të kontratës me një shoqatë sponsorizuese turke. Shqetësim për këtë mësues përbën fakti i ndryshimit të strukturës së Medresesë në kolegji. Gjithashtu ai shprehet se dëshira e stafit është që mësimdhënia të bëhet në shqip. Ndërsa në një vend të veçantë jepet edhe një prononcim nga burime të brendshme i Ministrisë së Arsimit, i cili thotë se ndryshimi i gjuhës do të bëhet vetëm sipas ligjit.

116. E martë 20 shtator 2005

gazeta “Shekulli”

“Myftari: Pse jap dorëheqjen nga Komuniteti Mysliman”³¹, ngjarje e ditës, Klodian Rado, fq. 3.

Në këtë shkrim flitet për dorëheqjen e parevokueshme të ish-nënkryetarit të BISH, Bledar Myftari. Kështu flitet për letrën e dorëheqjes së Myftarit ku janë dhënë akuzat e tij ndaj drejtuesve të lartë të këtij institucioni, ku më të rëndat janë ato për shpërdorimin e pronave, paaftësi në drejtim dhe krizën në të cilën po e përjeton ky institucion. Aty jepet edhe një pjesë e letrës së Myftarit, drejtuar kryetarit të BISH Selim Muça. Një nga akuzat e bëra në këtë letër është edhe dhënia në administrim e Medresesë së Tiranës një shoqate turke, ku ai e cilëson si mbyllje de facto të këtij institucioni.

“Komuniteti, përplasjet që pas vrasjes së Salih Tivarit”, ngjarje e ditës, Lindita Çela, fq. 2.

Në këtë faqe jepen një përmbledhje e ngjarjeve më të rëndësishme të BISH, pas vrasjes tragjike të ish-sekretarit të këtij institucioni Salih Tivarit. Nga përplasjet më të rëndësishme që përmenden janë ato për shkarkimin e zëvendësuesit të Salih Tivarit, Zylyftar Dervishin dhe shoqërimi i imamëve të Tiranës në Drejtorinë e Policisë së Tiranës. Po ashtu një vend i posaçëm i kushtohet reagimit të Kryetarit të BISH, Selim Muça, ku ai ka thënë citojmë: “Pa u takuar me Bledar Myftarin nuk kam ç’të them”.

117. E martë 20 shtator 2005

gazeta “Ballkan”

“Bledar Myftari: Mëkatet e Komunitetit Mysliman”, kronikë, pa autor, fq. 6.

Në këtë shkrim jepet njoftimi për dorëheqjen nga posti i nënkryetarit të KMSH dhe myftiu i Tiranës të Bledar Myftarit. Ky shkrim shoqërohet me faksimilen e dorëheqjes dhe njëkohësisht ka një zë të veçantë, ku trajtohen akuzat e tij ndaj drejtuesve të KMSH-së. Në këto akuza spikat ajo e pronave, intrigat brend institucionit, administrimi i keq dhe përçarja së cilës i la shërbyer ky institucion.

³¹ Ky shkrim paralajmërohet në faqen e parë me titullin kryesor të numrit: “Ikën nënkryetari i muslimanëve” dhe nëntitullin “Bledar Myftari jep dorëheqjen: Komuniteti Mysliman, një çerdhe intrigash”.

118. E martë 20 shtator 2005

gazeta “Korrieri”

“**Bin Laden, 600 mijë USD në Shqipëri**”, ngjarje dite, Elton Metaj, fq. 3.

Në këtë faqe i dedikohet një shkrim i gjatë Abdul Latif Saleh si njeri i Bin Ladenit dhe që ka marrë prej tij 600.000 \$ për ngritjen e grupeve terroriste në Shqipëri. Ky person ka qenë i lidhur me disa organizata joqeveritare, të cilat sipas supozimeve të Uashingtonit kanë qenë të lidhura me Xhihadin Islamik Egjiptian. Po ashtu ky person ka qenë i lidhur me fondacionin “Al Haramain” dhe me një biznesmen tjetër me origjinë arabe, të akuzuar për terrorizëm, Jasin Kadi. Më pas bëhet një historik i shkurtër i të ashtuquajturave lidhje terroriste dhe të bllokimit të pasurive të fondacionit “Al Haramain”.

119. E martë 20 shtator 2005

gazeta “SOT”

“**Abdul Latif Saleh, njeriu i Bin Ladenit në Tiranë**”, politikë, Jeannine Aversa (The Associated Press), fq. 3.

Në këtë shkrim të shkurtër flitet për Abdul Latif Saleh si njeri i Bin Ladenit në Tiranë, i cili ka marrë rreth 600.000 \$ për ngritjen e grupeve terroriste në Shqipëri. E gjithë kjo akuzë ngrihet nga Departamenti Amerikan i Thesarit. Po ashtu thuhet në këtë shkrim se ky person ka pasur lidhje me fondacionin “Al Haramain” dhe me një biznesmen tjetër të akuzuar për terrorizëm të quajtur Jasin Kadi.

120. E mërkurë 21 shtator 2005

gazeta “Express”

“**Bin Laden bleu truallin e Kullave Binjake**”, speciale, pa autor, fq. 11.

Edhe në këtë shkrim flitet për Abdul Latif Saleh si njeri i Bin Ladenit në Tiranë dhe që ka vepruar duke bërë biznes e duke rekrutuar terroristë. Supozimet ngrihen në bazë të akuzave të bëra nga Departamenti Amerikan i Thesarit, si dhe një kontratë për blerjen e truallit të dy Kullave Binjake në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”.

“**Kulla: Myftari bashkëpunon me ekstremistët**”, kronikë, Klodiana Lala, fq. 9.

Ish-kreu i KSHK-së, Ilir Kulla e akuzon Bledar Myftarin pas dhënies së dorëheqjes si një nga bashkëpunëtorët me ekstremistët që e kanë kërcënuar atë në këtë shkrim, citojmë: “Bledar Myftari u bashkëngjitet elementëve ekstremistë nga të

cilët kam pasur kërcënime”. Më poshtë shkrimi vazhdon me qëndrimet e Kullës rreth deklaratave të Myftarit pas dorëheqjes si dhe për akuzat e bëra nga ky i fundit kundrejt Komunitetit Musliman. Pak më poshtë në një shkrim tjetër jepen akuzat të plota që i ka bërë Myftari si dhe pritjen e tij për një përgjigje nga krerët e KMSH. Po ashtu jepet edhe një reagim e i krerëve të KMSH ndaj këtyre akuzave, ku gjatë një mbledhjeje të një dite më para që janë shqyrtuar ato, janë cilësuar thjesht si aludime.

121. E mërkurë 21 shtator 2005

gazeta “Korrieri”

“Muça: Në vendimet për pronat, është marrë mendimi i Myftarit”, aktualitet, Mirilda Tili, fq. 15.

Në këtë shkrim flitet për reagimin e kryetarit të BISH, Selim Muça, pas akuzave të bëra nga ish-nënkryetari dhe ish-myftiu i Tiranës, Bledar Myftari, kundrejt drejtuesve të lartë të këtij institucioni. Kështu pasi kryetari Muça tregon diçka për historikun e menaxhimit të pronave, tregon edhe procedurën sesi merren vendimet në lidhje me to, ku deklaroi se Myftari ka marrë pjesë në këto mbledhje, por pa pasur të drejtën e votës. Po ashtu Muça hedh poshtë edhe akuzat se gjuha zyrtare e Medresesë do të jetë turqishtja, duke i cilësuar ato si spekulative.

122. E enjte 22 shtator 2005

gazeta “Tirana Observer”

“Zëvendësi im të kthehet në punë”!, aktualitet, Dorina Topollaj – Armand Jonuzi, fq. 17.

Kjo është një intervistë e kryetarit të BISH, Selim Muça, pas dorëheqjes së parevokueshme që u dha nga posti i nënkryetarit dhe i myftiut të Tiranës, Bledar Myftari. Në këtë intervistë ai mundohet të sqarojë problemet e BISH dhe akuzat e bëra përpara se të largohej nga posti Bledar Myftari. Gjithashtu ai sqaron se Myftari ka qenë vazhdimisht pjesë e vendimmarrjes si për pronat edhe për rastin e Medresesë me turqit dhe se nuk ka ditur gjë për dorëheqjen e tij. Ai thotë se e ka lënë vendin pa zënë akoma të nënkryetarit, duke i lënë shteg Myftarit që të kthehet përsëri në punë.

123. E enjte 22 shtator 2005

gazeta “**Korrieri**”

“**Pas dorëheqjes, Myftinia akuzon Kullën për shpifje**”, sociale, Fatos Salliu, fq. 11.

Pas dorëheqjes së z. Ilir Kulla nga posti i kryetarit të KSHK me justifikimin se i është bërë shantazh nga Myftinia e Elbasanit, në këtë shkrim jepet reagimi i myftiut të Elbasanit, Agim Duka. Ai shprehet se vërejtjet i janë bërë publike z. Kulla dhe deklaroi, citojmë: “Ne nuk e kemi kërcënuar Ilir Kullën por i kemi bërë të ditur atij qëndrimin tonë si institucion ndaj rolit që ka luajtur në krye të detyrës që ka pasur”. Po ashtu jepet edhe qëndrimi i një teologu që ka dalë në mbështetje të Myftinisë Elbasanit, Arben Ramkaj, citojmë: “Në vend që të rregullonte lidhjet shtetfe, ky njeri duket se e ka parë me sy tjetër Islamin në Shqipëri”.

124. E enjte 22 shtator 2005

gazeta “**Tirana Observer**”

“**Nuk kthehem më në Komunitetin Mysliman**”, aktualitet, Dorina Topollaj- Armand Jonuzi, fq. 10.

Ky shkrim bën fjalë për reagimin e ish-nënkryetarit Myftari ndaj ftesës së kryetarit të BISH, Selim Muça për t’u rikthyer në post pasi dha dorëheqjen e parevokueshme. Kështu kryetari Muça i bëri thirrje Myftarit që të kërkonte të falur për veprimin dhe të rikthehej në postin e vet. Ndërsa ky i fundit nuk ka pranuar, duke deklaruar se, citojmë nga shkrimi: “Nuk kam ndërmend të kthehem sërish në vendin e punës ku dhashë dorëheqjen”. Në një vend të posaçëm i është lënë vend akuzave të bëra nga Myftinia e Elbasanit ndaj kreut të KSHK, Ilir Kulla, se ai po vepron në kundërshtim me interesat e Komunitetit Musliman Shqiptar.

125. E shtunë 24 shtator 2005

gazeta “**Ballkan**”

“**Shyqyri Rreli: Pronat, Kryesia të zbardhë akuzat e Myftarit**”, sociale, pa autor, fq. 10.

Kjo është një intervistë që i është marrë Shyqyri Rrelit, anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të BISH, figurë e shquar e futbollit shqiptar rreth dorëheqjes së ish-nënkryetarit Bledar Myftari dhe akuzave të bëra prej tij. Në këtë intervistë Rreli i përgjigjet gazetarit rreth çështjes së rëndësishme të rikthimit të pronave. Po ashtu ai deklaroi se çdo gjë duhet të kalojë në Komisionin e Transparencës përndryshe do të lihet shteg të dyshohet se akuzat e Myftarit janë të vërteta. Rreli e shikon zgjidhjen në

largimin e zyrtarëve të paaftë, të cilët nuk arrijnë të bëhen përfaqësues të vlerave.

126. E shtunë 24 shtator 2005

gazeta "ABC"

"Ja si e njoha unë Komunitetin Musliman", intervista, Mentor Nazarko, fq. 4-5.

Në këtë intervistë të gjatë dhënë nga ish-myftiu Bledar Myftari për të sqaruar shkaqet e dorëheqjes së tij. Kështu ai jep përgjigje të hollësishme për pronat, për vrasjen e ish-sekretarit Salih Tivari, akuzat e Ilir Kullës, dallimet moshore në vendimmarrjen e komunitetit musliman, po ashtu edhe për probleme që e shqetësojnë botën muslimane. Gjithashtu ish-myftiu shpreh qëndrimin e tij citojmë nga shkrimi se: "Unë do të thoshja plot mburrje që ka qenë pikërisht Islami që e ka ruajtur identitetin kombëtar shqiptar, pa dashur të nënvlerësoj kërkënd. Ka qenë Islami që ka ndikuar në moskthimin e shqiptarëve në serbë e grekë".

"Myftiu ...dhe dorëheqja", portret, Ben Andoni, fq. 5.

Në këtë shkrim i bëhet një portret ish-myftiut Bledar Myftari nga artikullshkruesi. Jepen vendet ku ka studiuar si dhe përpjekjet e ish-myftiut për studimet pasuniversitare dhe marrjen e doktoraturës. Po ashtu jepen edhe detaje të pamjes së jashtme të Myftarit si dhe luftën midis brezave.

127. E diel 25 shtator 2005

gazeta "Tirana Observer"

"Ndërhyrjet e politikës në Komunitetin Mysliman", aktualitet, Artan Leka, fq. 4.

Kjo është një intervistë e lëshuar nga myftiu i Elbasanit, Agim Duka, pas dorëheqjes së dhënë nga ish-kreu i KSHK Ilir Kulla. Myftiu Agim Duka jep shpjegime rreth akuzave të bëra ndaj institucionit që përfaqëson ai prej Ilir Kullës. Në këtë intervistë ai jep shpjegime të hollësishme përreth edhe akuzave se Kulla ka dhënë dorëheqjen si shkak i shantazheve të bëra nga myftinia. Gjithashtu Myftiu Duka akuzon edhe pjesë të politikës shqiptare se po përdorin qëllimisht kartën e islamizmit ekstrem.

128. E martë 27 shtator 2005

gazeta "SOT"

"Komuniteti Mysliman "jorgan" politik", komente & analizë, Olsi Jazexhi, fq. 11.

Kjo është një analizë ku merret në shqyrtim kriza e BISH pas dorëheqjes së dhënë nga ish-myftiu i Tiranës, Bledar Myftari, si dhe trajton problemet, të cilat i ngriti me dorëheqjen e tij ky i fundit. Ai akuzon gjithashtu se institucioni është politizuar dhe pas këtyre veprimeve qëndron ish-kreu i KSHK, Ilir Kulla, ku ky ka ndikuar në veprimet e marra nga kreu musliman Selim Muça. Në fund ky shkrues hedh mendimin se ka ardhur koha që muslimanët të përfaqësohen nga një institucion alternativ.

Muaji Tetor 2005

129. E diel 2 tetor 2005

gazeta “Ballkan”

“Indiferenca e rrezikshme ndaj besimeve”, koment & analizë, Agim Baçi, fq. 8.

Autori i shkrimit i bën një analiza gjendjes së BISH. Ndër të tjera ai përmend edhe presionin e jashtëm dhe të brendshëm që i ushtrohet kësaj organizate që është edhe përfaqësuese e një komuniteti shumë më të gjerë. Një tjetër temë shumë e përfolur është edhe ajo e pronave të këtij Komuniteti. Një akuzë e rëndë ngrihet nga ky autor për përfaqësuesit e lartë shtetërorë që janë treguar tolerantë ndaj problemeve të këtij komuniteti dhe indiferenca ndaj rolit të vërtetë që duhet të luajnë përfaqësuesit e tij. Gjithashtu ai nënvizon se krahas kthimit të pronave nga ana e shtetit, duhet të rritet kujdesi i shtetit për këtë komunitet.

130. E martë 4 tetor 2005

gazeta “Dita”

“Është koha e faljes së mëkateve”, speciale, Manjola Bregasi, fq. 16-17.

Kjo është një intervistë me Dorian Demetin, drejtor i kulturës në BISH, përreth muajit të shenjtë të Ramazanit. Në këtë intervistë ky i përgjigjet disa pyetjeve që kanë të bëjnë me vlerat e agjërimit dhe të muajit të Ramazanit, çfarë është agjërimi dhe përse besimtarët myslimanë agjërojnë. Gjithashtu në një vend të veçantë ze kalendari i agjërimit gjatë të gjithë muajit të Ramazanit. Pak rreshta i janë kushtuar edhe krizës së brendshme të KMSH. Gjithashtu i është kushtuar vëmendje e veçantë rreth çështjes se kur hyn muaji i shenjtë hënor i Ramazanit marrë nga gazeta e huaj “Call Star” me autor Robert King. Kjo speciale është publikuar pikërisht në ditën e parë të shpallur zyrtarisht kur fillon Ramazani.

130. E martë 4 tetor 2005

gazeta “Tirana Observer”

“Terrorizmi islamik në kontekst historik dhe politik, rajonal dhe ndërkombëtar”, analizë, Fatos Tarifa, fq. 9.

Ky është një shkrim i gjatë analitik i botuar në katër numra që nisin në datën 4 tetor dhe mbyllet më datë 7 tetor. Në këtë shkrim të gjatë analitik autori trajton një seri çështjesh, ku përmendim “Kalifati arab dhe lavdia kulturore e tij”, “Krijimi dhe rënia e Perandorisë Otomane”, “Tre stadet e terrorizmit islamik”, “Terrorizmi Binladenist” etj. Megjithë titullin që mban autori si profesor doktor vërehet se nuk jepet asnjë argument bindës, por merret si a priori termi terrorizëm islamik. Në dy temat e para bëhet një përmbledhje historike të ngjarjeve që u referohen temat dhe vihet re që janë të pasura boll me informacion. Në dy temat e tjera vihet re e njëjta gjë, porse ka një vështirësi se ky informacion nuk është i verifikueshëm.

131. E martë 11 tetor 2005

gazeta “Express”

“Al Kaida, llogari bankare në Tiranë”, kronikë & periferi, pa autor, fq. 11.

Në këtë shkrim lajmërohet për nisjen e hetimeve rreth disa shtetasve të huaj dhe një shqiptar që kanë ndihmuar Al Kaedën në Shqipëri. Flitet për hapjen e një kontoje bankare si dhe për hapjen e hetimeve për personat e huaj me emra: Hamza Abu Rajan, si dhe Abdyl Latif Saleh me origjinë jordaneze, ndërsa shqiptari jepet me inicialet A. L. Këto persona janë denoncuar nga ministria e financave pasi emrat e këtyre personave janë publikuar si terroristë nga ana e Departamentit të Shtetit Amerikan. Po ashtu në një vend të veçantë njoftohet se: **“Saleh bleu truallin e dy kullave”**. Bëhet fjalë për dy kulla binjake përballë godinës së kryeministrit.

132. E mërkurë 12 tetor 2005

gazeta “Express”

“Kontroll parave të shoqatave muslimane”, kronikë, pa autor, fq. 11.

Në këtë lajm të shkurtër njoftohet se pala amerikane i ka kërkuar SHISH të verifikojë preardhjen e fondeve të shoqatave muslimane. Ky operacion do të kalojë në sitën e imët të SHISH të gjitha organizatat bamirëse muslimane, qoftë edhe ato me personel shqiptar. Po ashtu në një lajm prej 4 rreshtash njoftohet se: **“Prokuroria heton dy arabë dhe një shqiptar”**.

133. E premte 14 tetor 2005

gazeta "Korrieri"

"Amerikanët, vizitë në Komunitetin Mysliman", aktualitet, pa autor, fq.7.

Ky është një lajm i shkurtër rreth vizitës së një delegacioni zyrtar në selinë e BISH, ku janë takuar me kreun e institucionit Selim Muça. Sipas të dhënave të gazetarit ky është një takim formal dhe kaq. Më pas jepet një përmbledhje e problemeve shqetësuese të Bashkësisë. Në fund jepet njoftimi i zgjedhjes së imamit të Xhamisë së Et'hem Beut, Shaban Saliaj në postin e Myftiut të Tiranës.

134. E martë 18 tetor 2005

gazeta "Korrieri"

"Myftiu i ri: Humbja e pronave shkakton probleme në Komunitet", intervista, Mirilda Tili, fq. 20.

Kjo është një intervistë njohëse me myftiun e ri të Tiranës, Shaban Saliaj. Ai i përgjigjet pyetjeve se përse pranoi të jetë kreu i Myftinisë së Tiranës si dhe për disa probleme që i ka hasur qysh në ditët e para. Më pas ai rrëfen për përgatitjen e tij fetare si hafiz dhe për pozicionet që ka mbuluar si imam.

Muaji Nëntor 2005

135. E premte 4 nëntor 2005

gazeta “Albania”

“Të rinjtë mbushin radhët në xhami”, politikë, Evisa Dervishi, fq. 2.

Ky është një reportazh për festimin e Bajramit³² në kryeqytet, ku evidentohet kryesisht fakti se pjesëmarrësit më të shumtë në numër kanë qenë të rinjtë. Vërehen dy gabime të thjeshta që Bajrami është falur në Xhaminë e Et’hem Beut dhe pjesëmarrësit kanë qenë 1.000 vetë. Ndërkaq Bajrami është falur dhe festuar në Sheshin Skënderbej dhe pjesëmarrësit vlerësohet të kenë qenë 10-12.000 persona. Flitet edhe se si njerëzit e kanë festuar këtë dhe ushqimet që kanë marrë. Një njoftim i veçantë është ai për drekën e shtruar për fëmijët jetimë të shtëpisë “Zyber Hallulli”. Një tjetër njoftim i veçantë është ai i rikthimit të pronave komuniteteve fetare prej kryeministrit Sali Berisha dhe vizitën e tij në selinë e BISH.

136. E shtunë 5 nëntor 2005

gazeta “Express”

“Universitet islamik në Shqipëri”, kronikë, pa autor, fq. 8.

Në këtë shkrim njoftohet për përpjekjet e ngritjes së një universiteti islamik në vendin tonë nga një shoqatë iraniane. Nismën për këtë projekt dhe realizimin e tij e ka marrë kolegji iranian “Saadi” me drejtorin e saj H. Asghari. Sipas njoftimit për së shpejti do të paraqitet kërkesa për leje në Ministrinë e Arsimit. Si mbështetje për ngritjen e universitetit do të shërbejë përvoja e ngritur në këto katër vjet me kolegjin. Për ndërtimin e universitetit dhe fondet do të përdoren ndihmat e disa shoqatave muslimane bamirësie, të cilave nuk u përmendet emri.

137. E shtunë 12 nëntor 2005

gazeta “Korrieri”

“Moisiu të kërkojë falje ndaj myslimanëve”, politikë, Forumi Musliman i Shqipërisë, fq. 5.

Kjo është një deklaratë për shtyp e këtij forumi pas fjalimit të mbajtur nga presidenti Alfred Moisiu në Oksford, Angli me

³² Shkrime dhe reportazhe të ngjashme ka pasur edhe në disa gazeta të tjera më 4 nëntor.

temën: “Toleranca ndërjetare në traditën e popullit shqiptar”. Fjalët e presidentit Moisiu që kanë sjellë shqetësimin e këtij forumi, i citojmë: “Si rregull është një islamizëm i cekët. Tek çdo shqiptar, pak po të gërmosh do të zbulosh thelbin e tij të krishterë.” dhe “te çdo musliman shqiptar, gjen 15 shekuj krishtërim”, dhe se “nuk është e vërtetë që në vendin tonë, jetojnë shumica me besim islam”, por se “në pikëpamjen vertikale diakronike të gjithë shqiptarët janë të krishterë” (mbyllet citimi). Në vijim deklarata e këtij forumi hedh poshtë deklaratimet e sipërcituara të presidentit shqiptar Moisiu.

138. E shtunë 12 nëntor 2005

gazeta “Metropol”

“Zemërohen muslimanët, Moisiu na fyeu”, kronikë, Basir Çollaku, fq. 9.

Ky është një shkrim i zgjeruar që merr shkas nga deklarata e Forumit Musliman Shqiptar rreth fjalimit të mbajtur nga presidenti Alfred Moisiu në Oksford, Angli me temën: “Toleranca ndërjetare në traditën e popullit shqiptar”. Gazetari ka kontaktuar edhe me kreun e BISH, Selim Muça, dhe ka kërkuar një opinion, porse Muça nuk ka qenë në dijeni të këtij fjalimi sepse edhe vetë ka qenë jashtë vendit në Turqi. Në fund të shkrimit jepet një pjesë e deklaratës së Forumit ku i kërkohet presidentit Moisiu të kërkojë falje publike për ofendimin e ndjenjave të shtetasve shqiptarë të besimit islam. Në një vend të posaçëm i është kushtuar riprodhimit një pjese të fjalës së Moisiut në Oksford me titull: “Çfarë tha presidenti në Londër”.

139. E diel e hënë 13-14 nëntor 2005

gazeta “Tema”

“Me ç’cilësi keni folur në Oksford zoti Moisiu?”, komenti, Çelo Hoxha, fq. 11.

Ky është një koment rreth fjalimit të presidentit Moisiu në Oksford të Anglisë. Autori i komentit e cilëson fjalimin e Moisiut “përrallë nga e kaluara”. Pasi i ka përmendur pikat se ku gaboi presidenti Moisiu në fjalimin e tij, autori ndër të tjera thotë, citojmë nga shkrimi: “Dhe ky është turp. Një njeri që nuk ka minimumin e logjikës për të vënë në pikëpyetje 4 pikat e mësipërme që bëjnë “muuu” qysh me një lexim, nuk duhet të ishte bërë kurrë president”.

140. E martë 15 nëntor 2005

gazeta “Shekulli”

“Feja e të parëve apo feja e parave?”, opinion, Alban Bala, fq. 15. Ky është një tjetër koment rreth fjalimit të presidentit Moisiu në Oksford të Anglisë. Komentuesi Alban Bala i ka bërë një shqyrtim të thellë pikave më të nxehta të këtij fjalimi si dhe ka sjellë argumente të mjaftueshme dhe të sigurta për të hedhur poshtë këto pika. Ai i zbërthen një për një këto pika duke futur në optikën e shqyrtimit edhe “motivet politike” e “motivet fetare”. Një nga arsyet për të cilat krishterimi nuk ka arritur të ndikojë është edhe përçarja e tij në fraksione përpara se të fillonte islamizimi i shqiptarëve, citojmë nga teksti: “..., nuk mund të jetë e vërtetë që “faktori homogjenizues i shqiptarëve është tradita 15-shekullore e krishterimit”, pasi Kisha Romane e Perëndimit deri në prag të vitit 1400 ishte e përçarë në 3 njësi që luftonin njëra-tjetrën për jetë a vdekje. Pa folur për betejat mes dy kishave, të Perëndimit dhe Lindjes,...”. Autori mendon se nuk është presidenti Moisiu shkruesi i fjalës që mbajti në Oksford, për këtë ai thotë, citojmë përsëri: “Sepse presidenti Moisiu as mund ta vazhdojë, as mund ta mbrojë atë që ka thënë në Oksford. Ai është një ushtarak karriere, një burrë i urtë dhe babaxhan, por – pa ofezë- i papërvojë për të menduar kaq larg në rrafshet vertikale- diakronike, siç ia kanë shpjeguar të urtët historinë”.

141. E martë 15 nëntor 2005

gazeta “Korrieri”

“Të shqetësuar nga Moisiu, toleranca apo historia”, forum, Luan Rama, fq. 17.

Në këtë analizë historiko-politike një nga politikanët e brezit të ri socialist rreket të japë opinionin e tij përreth deklaratave të presidentit Moisiu, të bëra në Oksford të Anglisë. Ai mundohet t'i dalë në mbrojtje presidentit Moisiu, por duke e shtyrë më tej idetë laike dhe shekullariste që i shtyjnë këtë kategori njerëzish. Për këtë citojmë nga shkrimi: “Feja ndër shqiptarët nuk është figurë ta quash palimpsest apo e mbivendosur. Në kalanë e Shkodrës ndodhet një kishë-xhami apo edhe vendvarrimi i Skënderbeut gjendet në një ish-xhami që më parë ka qenë kisha e Shënkollit”. Kështu ai rreket që me argumente historike të tjera të mbrojë tezën e të ashtuquajturës tolerancë fetare, nëpërmjet mbivendosjes së disa fakteve dhe manipulimit të tyre nga pikëpamja logjike.

142. E mërkurë 16 nëntor 2005

gazeta "Shekulli"

"KM: Fjalimi i Moisiut cenon tolerancën fetare", politikë, Klodian Rado, fq.8.

Në këtë shkrim jepet reagimi i KMSH-së (BISH) pas një mbledhjeje urgjente për shkak të deklaratave të presidentit Alfred Moisiu të bëra në Oksford të Anglisë. Pesë janë pikat që kanë sjellë shqetësimin kryesor jo vetëm të Komunitetit Musliman, por edhe të mbarë muslimanëve në Shqipëri. Këto pika janë dhënë në një vend të posaçëm. Po ashtu sipas shkruarit, citojmë: "Sipas kryesisë së këtij komuniteti, fjalimi i presidentit Moisiu, "nxjerr në pah elementë tendenciozë që cënojnë vlerat e tolerancës dhe bashkëjetesës ndërfaqetare". Kështu presidenti Moisiu e ka cilësuar si "islam të cekët" si dhe disa cilësime të tjera të bëra prej tij që jepen dhe njëkohësisht jepet edhe reagimi i KMSH (BISH).

"Polemikat fetare Moisiun", opinion, Mentor Nazarko, fq. 15.

Ky është një opinion pro fjalimit të presidentit Moisiu të mbajtur në Oksford të Anglisë. Pavarësisht nga zhurma mediatike kundra këtij fjalimi, autori e mbron këtë fjalim duke e cilësuar, citojmë: "Fjalimi i presidentit Moisiu, ndoshta më i miri i tij që nga koha kur është bërë president, kishte megjithatë një të metë thelbësore, që ishte absolutizuar prej kritikëve të tij". Më tej ai vazhdon me disa arsyetime, ku thotë se pikërisht këto argumente që u përdorën nga Moisiu mund të ishin përdorur fare mirë edhe nga znj. Jozefina Topalli dhe kryeministri Sali Berisha, sepse për fat një gjuhë e tillë është bërë gjuha karakteristike e politikanëve tanë. Ai thotë se është i bindur për këtë për shkak të karakterit pragmatist të shqiptarëve sipas thënies: Pas vendit bëhet edhe kuvendi.

143. E enjte 17 nëntor 2005

gazeta "Shekulli"

"Fetarët, ateistët dhe presidenti Moisiu", opinion, Skënder Shkupi, fq. 14.

Ky është një tjetër opinion nga një tjetër opinionist rreth debatit që solli në shtyp fjalimi i presidentit Moisiu në faqet e gazetave tona. Autori është nxitur nga një opinion i gazetarit të mirënjohur Alban Bala, i shprehur po në faqet e kësaj gazete 2 ditë më parë, ku ai i ka sulmuar tezat e fjalimit të presidentit Moisiu. Ky autor merr në shqyrtim me hollësi pjesën më të madhe të çështjeve të trajtuara nga z. Bala duke u munduar të hedhë poshtë trajtimet e tij. Thelbi i opinionit të tij është se

autori i këtij shkrimi ndjehet një mysliman i mirë edhe pse pi ndonjë gotë raki dhe nuk ndjehet aspak person fetar.

144. E shtunë 19 nëntor 2005

gazeta “**Korrieri**”

“**Çështjet fetare dhe Siguria Kombëtare**”, forum, Xhavit Shala, fq. 17.

Në këtë trajtim opinioni autori merret në fillim me çështjet e edukimit fetar dhe me rikthimin e pronave. Më tej ai vazhdon me problemin tejet të debatueshëm për financimin e komuniteteve fetare, gjithashtu ai ngre edhe problemin se kuvendi shqiptar akoma nuk ka arritur të nxjerri një ligj të plotë për marrëdhëniet me komunitetet fetare. Më pas ai rikthehet kohës së mbretit Zog I dhe risjell në kujtesë se shumë muslimanë të arsimuar në Perëndim kanë pasur sensin e një trajtimi të barabartë të komuniteteve fetare pavarësisht nga numrat që paraqisnin ato. Ai shton në fund se është detyrë e komuniteteve fetare të kontribuojnë për promovimin e klimës së dialogut ndërfaqet.

145. E shtunë 19 nëntor 2005

gazeta “**Albania**”

“**Myftinia e Korçës sherr me 72-vjeçarin për dy tyrbet**”, aktualitet, pa autor, fq. 13.

Ky është një lajm i shkurtër që vjen nga rrethi i Korçës rreth një vendimi gjyqi të dhënë në favor të një personi civil Kadri Mullaçmeri 72 vjeç, kundra pretendimit të Myftinisë së Korçës për pronësinë e dy tyrbeve. Pretendimet e Mullaçmerit janë se familja e tij i ka administruar ato edhe më parë. Tashmë ky individ i ka fituar gjyqet me Myftininë në dy nivele të gjykatës.

146. E diel 20 nëntor 2005

gazeta “**Metropol**”

“**Vlerat e fesë myslimane nuk mund të zbehen**”, politikë, Darina Tanushi, fq. 2

Në këtë shkrim të shkurtër flitet rreth takimit të presidentit shqiptar Alfred Moisiu me kryetarin e KMSH (BISH), H. Ing. Selim Muça. Sipas shkrueses presidenti Moisiu është munduar të sqarojë pozicionin e tij pas deklaratave të bëra po prej tij në Oksford të Anglisë dhe që sollën shqetësim në të gjithë opinionin e gjerë mysliman. Sipas gazetares: “Presidenti vuri në dukje se ato nuk reflektojnë realitetin tonë, nuk mund të zbehin dhe nuk kanë të bëjnë me këtë vlerë të kahershme që i bënë nder

si popullit ashtu dhe besimeve fetare në Shqipëri”. Gjithashtu gjatë takimit të mbajtur presidenti Moisiu ka vlerësuar rolin e muslimanëve shqiptarë dhe të Komunitetit të tyre. Një vend të posaçëm në shkrim i dedikohet deklaratave të presidentit në Oksford, të cilat sollën edhe zemërimin e muslimanëve shqiptarë.

147. E diel 20 nëntor 2005

gazeta “Express”

“**Muslimanët në presidencë, Moisiu nuk kërkon falje**”, politikë, pa autor, fq. 2.

Në këtë shkrim flitet mbi takimin e presidentit shqiptar Alfred Moisiu me kryetarin e KMSH (BISH), H. Ing. Selim Muça. Në këtë takim sipas shkruarit citojmë: “...Moisiu nuk ka parapëlqyer që t'i kthehet deklaratave të bëra në Oksford, por është mjaftuar vetëm me shprehjen e konsideratës për këtë pjesë të shoqërisë shqiptare”. Në vazhdim jepen disa konsiderata pozitive të presidentit për muslimanët shqiptarë. Po ashtu njoftohet në këtë shkrim se kreu i KMSH (BISH), Selim Muça i ka shprehur presidentit disa shqetësime për komunitetin që drejton, ku më të rëndësishmet janë hapja e një universiteti teologjik dhe rregullimi me ligj i marrëdhënieve mes shtetit dhe besimeve fetare. Po ashtu jepet edhe një pjesë e deklaramit të bërë ditë më parë nga zëdhënësi i Myftinisë së Shkodrës.

148. E diel 20 nëntor 2005

gazeta “Korrieri”

“**Moisiu, paqe me muslimanët**”, politikë, R. Kalemi, fq. 6.

Edhe në këtë shkrim flitet rreth takimit të presidentit shqiptar Alfred Moisiu me kryetarin e KMSH (BISH), H. Ing. Selim Muça. Kështu në vazhdim jepen disa konsiderata pozitive të presidentit Moisiu për tolerancën dhe rolin e muslimanëve shqiptarë në shoqëri. Më pas jepen shqetësimet e ngritura nga kreu i muslimanëve Muça, të cilat më të rëndësishmet janë: hapja e një universiteti teologjik dhe rregullimi me ligj i marrëdhënieve mes shtetit dhe besimeve fetare. Në një vend të posaçëm janë dhënë deklaratat e diskutueshme të presidentit Moisiu të bëra në Oksford. Po ashtu jepen edhe opinionet e tre analistëve të njohur në media: Ardian Klosi, Fatos Lubonja dhe Mustafa Nano.

149. E diel 20 nëntor 2005

gazeta **“Panorama”**

“Moisiu: S’kam konflikt me myslimanët”, nëntitull *“Kreu i shtetit: Reagimet e ashpra s’reflekojnë realitetin tonë”*, politikë, pa autor, fq. 6.

Ky shkrim përsëri flet rreth takimit të presidentit shqiptar Alfred Moisiu me kryetarin e KMSH (BISH), H. Ing. Selim Muça. Sipas shkruarit ky takim është konsideruar nga presidenti i vendit si, citojmë: “...një takim në vazhden e takimeve të kryera nga vetë kreu i shtetit me përfaqësuesit e komuniteteve fetare në vend”. Pas disa konsideratave pozitive të presidentit për myslimanët shqiptarë, sipas shkruarit, kreu i KMSH-së, Muça i ka kërkuar atij hapjen e një shkolle të lartë teologjike. Më pas jepen shkaqet e debatit të lindur në shtyp pas deklaratave të bëra nga presidenti në Oksford.

150. E diel 20 nëntor 2005

gazeta **“Ballkan”**

“Moisiu qetëson Komunitetin Mysliman”, nëntitull *“Reagimi ndaj ligjëratës në Oksford, përpjekje për të zbehur rolin e bashkëjetesës”*, lajmi i ditës, Juli Prifti, fq. 3.

Po ashtu edhe në shkrimin e kësaj gazete flitet rreth takimit të presidentit shqiptar Alfred Moisiu me kryetarin e KMSH (BISH), H. Ing. Selim Muça. Ai është munduar të qetësojë kreun e myslimanëve, porse nuk është tërhequr në asnjë nga pikat e fjalimit të tij të mbajtur në Oksford të Anglisë. Ndërsa shqetësimin dhe indinjatën e Myftinisë së Shkodrës, ai e ka cilësuar si, citojmë nga shkrimi: “Realiteti shqiptar i harmonisë dhe bashkëjetesës fetare, i njohur tashmë edhe përtej kufijve të vendit tonë, është përgjigjeja më e mirë ndaj përpjekjeve për ta mohuar apo për të zbehur përmasën e tij³³”. Më pas jepen shqetësimet e ngritura nga kreu i myslimanëve Muça, të cilat më të rëndësishmet janë: hapja e një universiteti teologjik dhe rregullimi me ligj i marrëdhënieve mes shtetit dhe besimeve fetare. Një vend të posaçëm zënë deklaratimet e presidentit Moisiu në Oksford, që e ka cilësuar fenë islame si joburimore, si dhe një vend tjetër i kushtohet protestës së Myftinisë së Shkodrës, e cila ka kërkuar që presidenti Moisiu t’i kërkojë falje myslimanëve shqiptarë.

³³ Të gjitha citimet e bëra nga fjalët e presidentit Moisiu apo edhe të kreut të KMSH (BISH), Selim Muça, vijnë nga zyra e shtypit e presidencës.

151. E hënë 21 nëntor 2005

gazeta "55"

"Orientimi katolik i Luftës së Skënderbeut krijoi unitetin dhe traditën e rreshtimit modern të shqiptarëve", forum, dr. Sami Repishti, fq. 9.

Në këtë shkrim gjysëm-historik gjysëm-divulgativ, i pajisur me një fotografi të marrë nga filmi Skënderbeu, flitet nga autori për luftën e Skënderbeut dhe orientimin katolik të saj, ashtu siç edhe njoftohet qysh në titull. Në këtë shkrim janë paraqitur disa koncepte të qytetërimit perëndimor si qytetërim i krishterë. Po ashtu autori jep shumë citime nga autorë të tjerë rreth kontributit të krishterimit në ngritjen e qytetërimit perëndimor. Më pas ai flet edhe lindjen edhe daljen në skenë të Islamit si dhe për rolin e rëndësishëm që kanë luajtur të krishterët në lëvizjet proto-nacionaliste. Ky shkrim zë një faqe të plotë gazete dhe është me vazhdim për në numrin e nesërm.

Muaji Dhjetor 2005

152. E premte 2 dhjetor 2005

gazeta “Panorama”

“**Si u bënë myslimanë shumica e shqiptarëve**”, speciale, Rezarta Delisula, fq. 18-19.

Në këtë speciale gazetarja është munduar të ballafaqojë faktet e ndryshme mbi islamizimin e shqiptarëve. Në një anë ka dhënë versionet e ngritura nga prof. Petrika Thëngjilli dhe nga ana tjetër ato që ngrihen nga Roald A. Hysa. Ato që thotë prof. Thëngjilli janë vullnetarizmi dhe dhuna, ndërsa Hysa nëpërmjet të dhënave hedh poshtë që konvertimi të jetë bërë me forcë nëpërmjet xhizjes, devshirmesë dhe taksave të ndryshme. Ndërkaq ai jep të dhëna se hyrja e Islamit në trojet shqiptare është më e hershme se sa hyrja e turqve.

153. E mërkurë 7 dhjetor 2005

gazeta “Standard”

“**Do të mbeten vetëm reformuesit**”, intervista, Edi Lesi, fq. 4-5. Kjo është një intervistë ekskluzive marrë z. Berisha pasi ka hipur në postin e kryeministrit të Shqipërisë. Ndër pyetjet e shumta që i bëhen aty kryeministrit të ri është edhe ajo mbi qëndrimin e Moisiut në Oksford të Anglisë, ku ai përgjigjet, citojmë: “Jam i bindur që nuk mund të ketë jo vetëm nga Presidenti Moisiu, por nga asnjë politikan kryesor shqiptar, edhe nga ish-kundërshtarët e mi kryesorë, tendenca për të ofenduar një komunitet apo një tjetër”. Kështu më poshtë ai vlerëson trashëgiminë shekullariste dhe laicizmin dhe shprehet se, citojmë: “Kështu që në këtë kontekst unë konsideroj laicizmin si parimin fundamental të ndërtimit të këtij shteti”.

154. E hënë 19 dhjetor 2005

gazeta “Koha Jonë”

“**Forumi Musliman: Rama të mos tallet me Sabri Koçin**”, aktualitet, FMSH, fq. 5.

Kjo është pjesë e një deklaratë të reagimit të këtij Forumi ndaj disa shprehjeve të kryetarit të ri të sapozgjedhur të PS-së, z. Edi Rama. Sipas kësaj deklaratë ky Forum “vuri re krahas zhvillimeve normale të një tubimi politik, edhe disa teprime të cilat bien ndesh me frymën e shoqërisë shqiptare...”. Shprehjet

e kryetarit socialist Rama që e kanë shqetësuar më tepër këtë Forum janë: “flet si Sabri Koçi” dhe “luftën e Haxhi Qamilit kundër të pafeve”. Kështu në fund të deklaratës së botuar ata i bëjnë thirrje klasës politike shqiptare e veçanërisht asaj socialiste që të tregoj kujdes dhe të mos bëjë ilustrime të panevojshme fetare për të goditur kundërshtarët.

155. E hënë 19 dhjetor 2005

gazeta “Standard”

“**Myslimanët: Edi Rama na ka fyer**”, politikë, pa autor, fq. 4.

Këtu kemi të bëjmë më një njoftim të shkurtër ku thuhet se Bashkësia e Besimtarëve Myslimanë i kërkojnë kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Edi Rama të kërkojë falje se ka përdorur terma myslimanë dhe emrin e Sabri Koçit me konotacione negative. Ky komunitet i kërkon z. Rama të kërkojë falje dhe raste të tilla të mos përsëriten.

156. E premte 23 dhjetor 2005

gazeta “Korrieri”

“**Të huajt vënë kryqe kristiane rrugëve të Shkodrës**”, aktualitet, Valbona Idrizi, fq. 7.

Pasi janë disa kryqe në disa prej kodrave të Bushatit në rrethin e Shkodrës reagojnë besimtarët muslimanë, të cilët i kanë paraqitur një peticion Myftinisë së Shkodrës për t'i hequr ato. Myftiu Bashkim Bajraktari e ka ngritur këtë shqetësim në një konferencë për mediat dhe i ka kërkuar autoriteteve përkatëse që të hiqen sepse ato janë vendosur në vende publike. Ndërkaq Angjelo Masafrà arqipeshkvi i Shkodrës është përgjigjur sipas Myftiut se, citojmë: “ne nuk dimë asgjë, as nuk kemi urdhëruar e kryqeve dhe ato mund t'i ketë vendosur ndonjë misionar i huaj që ka ardhur nga Anglia ose Franca”. Ndërkaq këto autoritete fetare kanë prekur edhe temën e xhamisë-kishë në kalanë e Shkodrës.

157. E premte 23 dhjetor 2005

gazeta “Panorama”

“**Ngrihen kryqe në kodrat e Bushatit**”, aktualitet, Ritvan Dibra, fq. 7.

Shkak për daljen në një konferencë për mediat të myftiut të Shkodrës, Bashkim Bajraktari u bë një peticion i besimtarëve muslimanë të Bushatit, të cilët kërkojnë në mënyrë institucionale heqjen e tre kryqeve të vendosura në toka publike në kodrat e Bushatit. Në këtë konferencë Myftiu u ka kërkuar

autoriteteve përkatëse që t'i heqin këto kryqe, duke e cilësuar vendosjen e tyre si, citojmë: “Ky veprim i bërë nga persona qëllimkeq, të papërgjegjshëm ose të paditur është provokues, tendencioz dhe dashakeqës në vazhden e përpjekjeve e disave për të na provokuar, për të krijuar përçarje dhe konflikte ndërfaqetare”. Ndërsa autoritetet e komunës së fshatit Bushat janë shprehur se nuk kanë dijeni dhe se nuk kanë dhënë leje për ndërtimin e këtyre tre kryqeve.

158. E premte 23 dhjetor 2005

gazeta “SOT”

“Myftinia kërkon heqjen e kryqeve nga kodrat e Bushatit”, rrethe, Besi Bekteshi, fq. 7.

Po edhe në këtë shkrim jepen sqarime rreth konferencës për shtyp të myftiut të Shkodrës, Bashkim Bajraktari për vendosjen e kryqeve në Bushat. Kështu Myftiu Bajraktari ka deklaruar se këto veprime janë tendencioze dhe keqdashëse, gjithashtu ai citoi nga biseda që kishte pasur me arqipeshkvin e Shkodrës, Masafra, se ai nuk kishte dijeni dhe nuk kishte dhënë urdhër për vendosjen e kryqeve dhe se ato mund të jenë vendosur nga ndonjë misionar i huaj që ka ardhur nga Anglia apo Franca.

159. E premte 23 dhjetor 2005

gazeta “Standard”

“Tre kryqe fusin në sherr fetë në Shkodër”, kronika, Taulant Koplaku, fq. 8.

Po edhe në këtë lajm flitet për petitionin e besimtarëve muslimanë, cilët i janë drejtuar arqipeshkvisë katolike Shkodër dhe kryetarit të Komunës Bushat ku kanë kërkuar në mënyrë institucionale që të hiqen tre kryqet e vendosura në kodrat e kësaj komune. Këto kryqe janë tre metra të lartë, të lyer me të bardhë dhe dallohen qysh larg në rrugën kombëtare. Po ashtu citohet deklarata për shtyp e myftiut të Shkodrës ku ndër të tjera ai ka deklaruar, citojmë: “Në qoftë se vendosjen e kryqeve në Bushat, ku janë cënuar besimtarët islamë, drejtuesit e arqipeshkvisë nuk e quajnë arsye serioze për prishjen e tolerancës dhe mirëkuptimit, atëherë nuk dimë se çfarë veprimesh të tjera provokuese ata do t'i quajnë serioze, pasi veprime të tilla destruktive mund të ndodhin edhe në kalanë e Shkodrës”.

160. E premte 23 dhjetor 2005

gazeta **“Durrësi Bulevard”**

“Hafiz Ali Korça, rilindasi, kolosi i mendimit folozofik, enciklopediku, patriot i kohërave të para.”, Bashkim S. Kadiu, fq. 6-7.

Në këtë dossier prej dy faqesh flitet për figurën shumëdimensionale të patriotit rilindas Hafiz Ali Korça. Autori i shkrimit përmend meritat e shumta të Hafiz Aliut dhe sidomos përpjekjet e mëdha të tij për arsimin shqip, si hartues programesh dhe metodikash. Veprat e tij mbajnë 23 tituj dhe 7.000 faqe. Periudha e tij më e begatshme në veprimtarinë e tij politike, arsimore dhe në të shkruar ka qenë nga viti 1905-1945. Pas vendosjes së regjimit komunist në Tiranë si edhe shumë figura të tjera politike dhe fetare përndiqet politikisht. Në vitin 1995 i jepet titulli **“Mësues i Popullit”** dhe për merita të posaçme merr urdhërin e Flamurit të klasit të parë.

161. E shtunë 24 dhjetor 2005

gazeta **“Koha Jonë”**

“Krerët e komuniteteve fetare nderohen me titullin “Qytetar Nderi””, sociale, Manjola Zeka, fq. 4.

Nën këtë titull i bëhet jehonë nderimit të veçantë që iu është bërë krerëve të katër komuniteteve fetare më të mëdha në vend nga Bashkia e Tiranës me titullin **“Qytetar Nderi”**. Ato janë arqipeshkvi i metropolit Tiranë-Durrës, Imzot Rrok Mirdita, Kryepeshkopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Anastas Janullatos, kryetari i Komunitetit Bektashian, Baba Reshat Bardhi dhe pas vdekjes ish-kryetari i Komunitetit Mysliman Haxhi Hafiz Sabri Koçi. Gjithashtu janë dhënë edhe prononcimet e krerëve të lartë fetarë pas marrjes së këtij çmimi, ku për H.H. Sabri Koçin e ka tërhequr çmimin kreu aktual i KMSH-së, Selim Muça.

162. E hënë 26 dhjetor 2005

gazeta **“Korrieri”**

“Moisiu: Kryqet e Shkodrës po i fryjnë mediat”, aktualitet, (Ed.Ku), fq. 6.

Pas vizitave tradicionale të presidentit Moisiu për Krishtlindjet në komunitetet e krishtera, ku kësaj radhe ai kishte zgjedhur Durrësin, ai është pyetur edhe për problemin e kryqeve të Bushatit. Citojmë nga shkrimi: **“Ai tha se përplasja mes komuniteteve myslimane dhe të krishtere në Shkodër për vendosjen e paligjshme të kryqeve, “është më shumë një incident**

mediatik sesa fetar””. Po ashtu gazetari i kujton presidentit se nuk janë gazetarët ata që e sollën në vëmendje çështjen e kryqeve të Bushatit, por ishte myftiu i Shkodrës në një konferencë për mediat.

163. E hënë 26 dhjetor 2005

gazeta “Standard”

“Qeveria, financim feve sipas numrit të besimtarëve”, në plan të parë, Eva Gjura, fq. 2.

Në këtë shkrim flitet për projektin e financimit të feve sipas numrit të besimtarëve, një projekt i qeverisë Berisha, i cili paraqitet nga drejtori i ri i KSHK, Rasim Hasani. Ky shpjegon se do të përgatitet një projekt-draft për këtë problem brenda 3-4 muajve, ku shteti do të financojë fetë sipas numrit të besimtarëve. Citojmë nga shkrimi: “Sipas Hasanit, në bazë të një përlllogaritjeje, i bie që komuniteti më i madh në Shqipëri është ai mysliman, i cili arrin deri në 65-70 për qind”.

“Berisha: Do u kthejmë pronat komuniteteve fetare”, në plan të parë, Eva Gjura, fq. 3.

Në këtë shkrim flitet për premtimin e bërë nga kryeministri Berisha komuniteteve fetare për rikthimin e pronave të tyre, gjatë vizitave për Krishtlindjet të bëra në selitë kryesore katolike dhe ortodokse. Sipas gazetares kryeministri Berisha ka deklaruar, citojmë: “Pronat janë një detyrim ligjor, por një detyrim tjetër ligjor është krijimi i një fondi, në mënyrë që komunitetet tona fetare të mund ti kryejnë të gjitha shërbimet dhe veprimtaritë e tyre në mënyrë të pavarur nga shtetit dhe nga burime të tjera”. Këto prona pritet të shihen si një çështje e veçantë dhe jo në bazë të ligjit për kthimin e pronave.

164. E martë 27 dhjetor 2005

gazeta “Standard”

“Acarohet situata, katolikët meshë në kishën-xhami”, kronikë, Taulant Kopliku, fq. 8.

Në këtë lajm flitet për acarimin e gjendjes midis dy komuniteteve fetare më të rëndësishme në qytetin e Shkodrës, atij musliman dhe atij katolik. Megjithë konfliktin e pazgjidhur ende për xhaminë-kishë në kalanë e Rozafës në Shkodër, arqipeshkvia e këtij qyteti ka paralajmëruar për mbajtjen e një meshe në rrënojat e kalasë. Më pas mesha është mbajtur prej dom Gjovalin Sukajt, ku deklaratat e tij janë dhënë të cituara në një vend të posaçëm. Po ashtu në një vend të posaçëm jepet edhe lajmi se myslimanët do të reagojnë në një konferencë shtypi po atë ditë.

165. E mërkurë 28 dhjetor 2005

gazeta "Telegraf Ditor"

"Pse shkojnë në Islam gratë europiane", opinion, Peter Ford (marrë nga "The Christian Science Monitor), fq. 19.

Autori i shkrimit mundohet të zbulojë arsyet që e kanë shtyrë znj. Meri Fallot të hyjë në Islam, dhe jo vetëm atë, por edhe shumë burra e gra të tjera që janë konvertuar në Islam pas 11 shtatorit. Sipas shkrimit nga të dhënat e mbledhura numri i të konvertuarve në Islam në Evropë është më i madh ndërmjet grave. Ndërsa "znj. Fallot, e cila u konvertua në fenë islame tre vjet, më parë pasi i bëri vetes ca pyetje shpirtërore për të cilat nuk gjeti shpjegim në katolicizmin e saj që nga fëmijëria, nuk dyshon se feja e saj e re "rëndon" ndokënd. "Për mua" thotë ajo "Islami është fe e dashurisë, e tolerancës dhe e paqes". Më pas jepen edhe mendime nga studiues të ndryshëm për këtë fenomen.

166. E mërkurë 28 dhjetor 2005

gazeta "Standard"

"Myftinia e Shkodrës: Shteti të ndërhyjë për kishën-xhami", kronika, Vladimir Karaj, fq. 10.

Një pasi kanë mbajtur një meshë në kundërshtim me vullnetin e komunitetit musliman në Shkodër ka reaguar ky komunitet nëpërmjet një konference shtypi. Në tekstin e deklaratës së tyre ata i kanë kërkuar organeve kompetente të ndërhyjnë për parandalimin e konflikteve që mund të ndodhin. Ata kanë deklaruar, citojmë: "Myftinia Shkodër kërkesave të besimtarëve myslimanë për të kryer ritet fetare atje, i është përgjigjur me fjalën "jo", megjithëse ky objekt ka mbi 500 vite që është xhami. Ndalimi i tyre është bërë duke treguar si gjithmonë tolerancën islame me vepra konkrete, për të evituar ndonjë konflikt të mundshëm me besimtarët katolikë".

167. E enjte 29 dhjetor 2005

Gazeta "Metropol"

"Ekstremistët: Myslimanë, braktisni Vitin e Ri!", aktualitet, Anila Prifti, fq. 2.

Në këtë shkrim flitet për një trakt që ka rënë në duart e një gruaje me prejardhje muslimane, ku në të cilin shkruhej, citojmë sipas shkrimit: "Mos festoni Vitin e Ri, është festë e të krishterëve. Jeni të mallkuar!". Gruaja nuk dëshiron të identifikohet se kush është dhe nuk sillet ndonjë rast tjetër. Më pas artikullshkruesja citon një faqe interneti, e cila merret

me arsytet e mosfestimit të Vitit të Ri prej muslimanëve, duke i cilësuar autorët e këtyre këshillave ekstremistë. Në një vend të posaçëm renditen 14 këshillat e dhëna në këtë faqe interneti. Po ashtu është marrë një prononcim nga drejtori i arsimit pranë BISH (KMSH), Saimir Rusheku, të cilit i është vënë gabimisht mbiemri Rushemi prej gazetares. Në këtë prononcim të posaçëm për Metropolin, ai ka deklaruar se, citojmë: “Nuk jam në dijeni të faktit, por nuk mund të jem dakord me një thirrje të tillë. Theksoj se ajo është festë tradicionale e gjithë shqiptarëve”, përfundon Rushemi”.

“Myftinia e Elbasanit, kërkesë Berishës për xhaminë”, aktualitet, L.Ll., fq. 2.

Në këtë lajm të shkurtër i njoftohet publikut kërkesa që i bën kryeministrit Berisha, si kryetar i KRRTRSH, për të zhvleftësuar vendimin e ish-kryeministrit Fatos Nano për miratimin e planit urbanistik të qendrës së qytetit të Elbasanit. Ky vendim ka qenë që në vendin ku ka qenë xhamia e Baliasit të ndërtohej një lulishte. Për këtë zv/myftiu Behaudin Gashi edhe në emër të imamëve të qytetit i drejtohet hapur kryeministrit Berisha që të mos e njohë këtë vendim dhe ta ndryshojë atë në favor të Myftinisë Elbasan.

Muaji Janar 2006

168. E mërkurë 4 janar 2006

gazeta “Panorama”

“Misteri i thyerjes së xhamisë në Tiranë”, aktualitet, (f.s), fq. 11. Në këtë shkrim njoftohet thyerja dhe dhunimi i xhamisë së Tabakëve në kryeqytet nga persona të panjohur. Zyrtarët e akuzës flasin për një tentativë grabitjeje, ndërsa përfaqësuesit e xhamisë flasin për dhunimin e saj duke e argumentuar këtë gjë. Sipas prokurorisë klasifikimi i kësaj vepre në Kodin Penal është i vështirë, sepse dhunimi i simboleve në këtë kod përmendet në rastin e nxitjes së urrejtjes etnike, ku parashikohet edhe dhunimi i simboleve fetare.

169. E mërkurë 4 janar 2006

gazeta “Shekulli”

“Thyhet dhe dhunohet xhamia e Tabakëve”, kronikë, Dashamir Biçaku, fq. 9.

E gjitha kjo faqe i kushtohet thyerjes dhe dhunimit të xhamisë së Tabakëve në kryeqytet. Me shumë imtësi tregohet e gjithë ngjarja për aq sa dihet nga njerëzit e xhamisë që e kanë zbuluar të parët në çastin kur do të kryhej falja e mesditës. Kur e kanë parë xhaminë në atë gjendje besimtarët janë ndjerë të fyer nga ky akt vandal. Gjithashtu në këtë faqe gjendet edhe një intervistë e shkurtër me imamin e xhamisë së Tabakëve, Elvis Naçi, që ka deklaruar citojmë: “Gjithashtu ne do t’u drejtojmë një protestë edhe organeve të tjera kompetente dhe do të kërkojmë nga policia zbardhjen e këtij akti që tenton të fyejë dhe të poshtërojë myslimanët në vendin tonë”.

170. E martë 10 janar 2006

gazeta “Albania”

“Dosja “Tivari”, ekzekutorët u larguan nga Shqipëria pas atentatit”, kronikë, Artur Qoraj – Artan Çela, fq. 11.

Në këtë shkrim flitet për të dyshuarit dhe pistat e hetimit të ndjekura nga prokuroria e Tiranës për të zbuluar vrasësit e ish-sekretarit të KMSH-së, Salih Tivari. Emrat e përmendur në këtë shkrim janë Ilir Halili, Artan Kristo, Ibrahim al Nagar dhe një femër që nuk ka emër. Pra, mendohet të jenë 4

bashkëpunëtorët në krim sipas autorëve të shkrimit. Gjithashtu përmendet edhe pasuesi i Salih Tivarit, Zylyftar Dervishi si personi që ka prishur provat në vendngjarje. Gjithashtu një vend i posaçëm në këtë faqe ze edhe njoftimi që për vrasjen e Tivarit janë bërë hetime nga shërbimet sekrete shqiptare dhe amerikane.

171. E martë 10 janar 2006

gazeta “**Republika**”³⁴

“**Kurban Bajrami, dita e adhurimit dhe nënshtrimit ndaj Zotit**”, speciale, përg. Gjok Marjakaj, fq. 8-9.

Në këtë dossier prej dy faqesh jepet historiku, krentimi dhe domethënia e fjalës kurban. Jepen me hollësi shpjegime për kurbanin si dhe sesi festohet kjo te shqiptarët. Më pas jepen hollësi për bagëtitë që mund të bëhen kurban dhe moshën, të cilën nevojiten ato për t’u bërë kurban. Në këto rreshta shpjegohet se Kurban Bajrami është festë e sakrificës, i triumfit të së mirës mbi të keqen. Po ashtu në këtë ditë mbyllen edhe ritet e Haxhit në Meke.

172. E mërkurë 11 janar 2006

gazeta “**Standard**”

“**Moisiu pajtohet me myslimanët e Shkodrës**”, në plan të parë, Taulant Kopliku, fq. 3.

Në këtë shkrim flitet për vizitën që ka bërë presidenti Moisiu në Myftininë e Shkodrës me rastin e Kurban Bajramit. Ai ka pasur një takim të veçantë me krerët e Myftinisë, ku sipas burimeve të brendshme janë diskutuar edhe mosmarrëveshjet midis komunitetit musliman dhe atij katolik për problemin e xhamisë-kishë, kryqet e Bushatit dhe problemin e pronave. I pyetur për deklaratimet e tij në Oksford që ngjallën reagime të ashpra veçanërisht të Myftinisë së Shkodrës, presidenti u përgjigj se i përket të kaluarës. Po në këtë faqe jepet njoftimi se kryeministri Berisha ka zgjedhur Kavajën për të bërë vizitën e tij tradicionale për të uruar Kurban Bajramin. Në Myftininë e Kavajës ai ka deklaruar se do të punojnë për financimin e komuniteteve fetare dhe për rikthimin e pronave.

“**Kryqi i Bushatit “kurban” për Bajram**”, në plan të parë, Taulant Kopliku, fq. 3.

Në këtë lajm njoftohet se rreth orës 15.15 të po kësaj dite, pak orë pasi është larguar presidenti Moisiu nga Shkodra, njëri

³⁴ Edhe gazeta të tjera kanë pasur njoftime rreth ditës së Kurban Bajramit.

prej kryqeve të mëdhenj të Bushatit është sharruar. Sipas gazetarit menjëherë kanë nisur hetimet nga ana e organeve të rendit. I menjëhershëm ka qenë edhe reagimi i Myftinisë së Shkodrës, nëpërmjet zëvendësmyftiut Arben Halluni. Ai ka deklaruar, citojmë: “Ne distancohemi nga ky akt, pasi cënon rëndë raportet mes dy komuniteteve. Vërtet ne kërkojmë heqjen e tre kryqeve në Bushat, por kjo kërkesë konsiston në heqjen e tyre në mënyrë institucionale dhe në rrugë paqësore”.

“Selim Muça myslimani shqiptar, myslimani evropian”, profil, Henri Çili, fq. 28.

Ky është një profil i kryetarit aktual të BISH (KMSH), H. Ing. Selim Muça që ka ardhur në krye të kësaj Bashkësie pas vdekjes së hafiz Sabri Koçit që ishte kreu i parë i këtij komuniteti të rindërtuar. Citojmë nga shkrimi: “Muça duket sot një pikë reference optimale për atë se si kleri mysliman shqiptar duhet të bashkëjetojë me botën e sotme, një botë që, duhet thënë, është aspak miqësore me muslimanët për njëmijë një arsye, nga të cilat njëmijë nuk varen fare nga zoti Muça”.

173. E mërkurë 11 janar 2006

gazeta **“Panorama”**

“I thashë Moisiut se po emërohen shumë katolikë”, “Kurbani”, sharrohet kryqi në Bushat”, aktualitet, Ritvan Dibra, fq. 2-3.

Në faqen 2 është intervista me Myftiun e Shkodrës, Bashkim Bajraktari pas takimit që ka pasur me presidentin Moisiu që ka vizituar ambientet e myftinisë me rastin e Kurban Bajramit. Sipas intervistës së myftiut Bajraktari kanë qenë disa problemet e diskutuara me presidentin si, problemi i pronave të komuniteteve fetare, marrëdhëniet mes komuniteteve dhe shtetit, përcaktimi i statusit të këtyre komuniteteve në raport me shtetin si dhe një problem specifik për Shkodrën që është ai se nuk po ruhen raportet fetare në emërimet e administratës shtetërore. Po në këtë faqe jepen edhe njoftime për Kurban Bajramin në Elbasan, Fier e Gjirokastrë. Në faqen 3 jepet njoftimi i sharrimit të kryqit në kodrën e Zef Janit në Bushat si dhe ngritjen e menjëhershme nga ana e banorëve të fshatit. Po ashtu jepet edhe deklarata e kryeministrit Berisha e bërë në Kavajë me rastin e urimeve tradicionale në myftininë e këtij qyteti. Ai ka deklaruar se po punojmë që t'i kthejmë pronat komuniteteve fetare.

“Histori kryqesh të ngritura në hartën e Shqipërisë”, aktualitet, Rezarta Delisula, fq. 4.

Në këtë koment gazetarja flet rreth vendosjes së kryqeve në disa vende të dukshme nëpër Shqipëri. Gazetarja tregon për shpërndarjen e kryqeve si dhe për problemet që i kanë shoqëruar ato. Nga e kaluara ajo citon thëniet e rilindasit Gjergj Fishta për problemet ndërfitare që shoqëruan luftën ballkanike. Në të gjithë Shqipërinë janë vendosur 8 kryqe në vende të dukshme. Po ashtu në këtë faqe jepet një njoftim që në Lezhë është zhvilluar një koncert i përbashkët ndërmjet 3 komuniteteve, ku është shprehur harmonia që mbizotëron në këtë qytet.

174. E enjte 12 janar 2006

gazeta “Korrieri”

“Masaffra: Jemi kundër kryqeve në vend publike”, aktualitet, V. Idrizi, fq. 6.

Në këtë faqe jepen pronocimet e ndryshme nga krerët fetarë në Shkodër pas sharrimit të kryqit në kodrat e Bushatit. Fillimisht jepen deklaratat e zëvendësmyftiut Arben Halluni që e ka dënuar aktin e sharrimit të kryqit, por ai deklaroi, citojmë nga shkrimi: “Problemet tona në lidhje me këtë çështje i kemi bërë publike dhe si gjithmonë kemi kërkuar dhe i kërkojmë organeve të qeverisë, që të zgjidhen vetëm në rrugë institucionale, të bazuara në ligje”. Më pas vijon deklarimet e arqipeshkvit të Shkodrës, Anxhelo Masaffra, që është shprehur se ai vetë personalisht është kundër vendosjes së kryqeve në vende publike dhe se ai vetë në një nga pronat e kishës nuk e ka lejuar vendosjen e një kryqi të tillë. Ai ka thënë se, citojmë: “tani e tutje duhet të evitojmë këto forma që mund të duken si ngacmime, veçanërisht në prona që nuk janë pronë e Kishës”. Po ashtu ka edhe deklaratat të kreut të Selisë së Kishës Katolike Shqiptare, Rrok Mirdita dhe kryetarit të Bashkësisë Islame të Shqipërisë, H. Ing. Selim Muça.

175. E enjte 12 janar 2006

gazeta “Tema”

“Incidenti nuk cenon marrëdhëniet tona”, aktualitet, Arben Lagreta, fq. 4.

Pas njoftimit të sharrimit të kryqit në kodrën e Zef Janës në Bushat të Shkodrës, jepen deklaratat e shtypit të të dy krerëve të komuniteteve fetare. Në fillim jepen pjesë nga deklaratat e arqipeshkvit të Shkodrës, Anxhelo Masaffra. Ndër të tjera ai ka deklaruar se, citojmë: “Pavarësisht nga ky akt, autorët e tij nuk duhet të cenojnë dhe të prishin marrëdhëniet e mira ndërfitare, të cilat janë ruajtur ndër shekuj nga populli ynë.

Jemi të ndërgjegjshëm se personat e këtij akti nuk kanë qenë të nxitur nga titullarët e komunitetit mysliman të Shkodrës,...”. Ndërsa ka qenë zëvendësmyftiu Arben Halluni që ka lexuar deklaratën në emër të Myftinisë së Shkodrës, një pjesë të së cilës e citojmë: “Institucioni ynë si gjithmonë ka qenë dhe mbetet kundër çdo lloj veprimi të dhunshëm si dhe kundër simboleve fetare”. Po ashtu jepet edhe një pjesë e vogël e deklaratës së intelektualëve shkodranë për këtë çështje. Në një vend të posaçëm jepet edhe njoftimi se çështja e kryqit i ka kaluar Krimeve të Hapura dhe Antiterrorit, por asnjë të arrestuar nuk ka pasur deri në ato çaste.

“Selim Muça e Rrok Mirdita: Bushati një rast i veçuar”, aktualiteti, pa autor, fq. 5.

Në këtë faqe jepen reagimet e krerëve kryesorë të BISH (KMSH), Selim Muça dhe kreut të selisë katolike at Rrok Mirdita. Kreu musliman i ka cilësuar këto veprime si vandaliste. Ai ka deklaruar “Simbolet duhet të jenë në institucionet fetare. Unë nuk mund të gëzohem nga një veprim si ai në Bushat, por nuk gëzohem që ai u rivu aty ku ishte”. Ndërsa Rrok Mirdita ka thënë: “U kërkojmë besimtarëve të mos bien pre e provokimeve që synojnë përçarjen dhe armiqësinë”. Në një vend të posaçëm jepen rastet e mosmarrëveshjeve midis komuniteteve fetare si dhe një njoftim tjetër ku harmonia fetare te shqiptarët është bërë objekt i studimeve të ndryshme.

176. E hënë 16 janar 2006

gazeta “Korrieri”

“Dëshmitarët e Jehovahit të përzihen nga Shqipëria”, aktualitet, Edison Kurani, fq. 10.

Në këtë faqe është vendosur një bisedë me kreun e BISH (KMSH), ing. Selim Muça pas disa rasteve të përsëritura vetëvrasjesh nga moshat e reja. Ai është pyetur për vetëvrasjen në fenë islame si dhe për sektin e Dëshmitarëve të Jehovahit. Së parës ai i është përgjigjur se jo vetëm në fenë islame, por edhe në atë të krishterë është e ndaluar vetëvrasja. Ndërsa për të dytën ai është përgjigjur, citojmë një pjesë të përgjigjes: “Dëshmitarët e Jehovahit janë një sekt i rrezikshëm. Ata kanë aftësi të bindin njerëzit që të vrasin veten me premtimin se do të shkojnë në Parajsë dhe do të rikthehen në tokë”. Po ashtu jepen disa raste vetëvrasjesh si dhe rastin e një vajze 19-vjeçare Silvana Hoxha, e cila nuk pranoi të merrte gjak për shkak se ia ndalon ta marri feja e saj dhe vdiq pa i lënë mjekët ta ndihmojnë. Po ashtu citohet edhe literatura e Dëshmitarëve të Jehovahit për

marrjen e gjakut nëpërmjet transfuzionit dhe mospranimin total për një veprim të tillë.

177. E martë 17 janar 2006

gazeta "Standard"

"**Xhamia rrezikon aeroportin e Kukësit**", kronika, Bujar Muçmata, fq. 11.

Në këtë shkrim jepet njoftimi i ndërprerjes së punimeve nga investitorët e Emirateve në aeroportin e Kukësit. Kjo ka ardhur si shkak i ndërtimit të një xhamie, e cila sipas urdhërpezullimit të ndërtimorëve është pa lejen e duhur. Ndërsa investitorët u janë përgjigjur se kjo xhami do të shërbejë si për nevojat e aeroportit, po aq sa edhe për nevojat e fshatit Shtiqën. Aeroporti i Kukësit është një investim prej 14 milionë dollarësh nga Emiratet e Bashkuara Arabe, dhuratë që i bëhet popullit shqiptar e veçanërisht atij të Kukësit në shenjë mirënjohjeje për përballimin e krizës kosovare të vitit 1999.

178. E martë 17 janar 2006

gazeta "Korrieri"

"**Rumija, sulltan Fatihu dhe kryqet e Bushatit**", forum, Xhavit Shala, fq. 16.

Ky është një opinion nga autor rreth problemit të kryqeve të vendosura në Bushat dhe në disa vende të tjera. Në këtë shkrim autori heq disa paralele midis ngritjes provokative të një kishë të vogël në malin Rumija vjet prej serbëve, si dhe mosmarrëveshjeve që kanë lindur për xhaminë-kishë në kalanë e Rozafës. Ai shpreh keqardhjen për kundërshtimin e Myftiut të Shkodrës ndaj një shume të vënë në dispozicion nga ana e mabasadores amerikane Marsi Rijs për rindërtimin e këtij objekti fetar në kishë. Ai citon një fakt historik ku sundimtari osman Mehmet Pashë Bushatlliu pat gjetur një zgjidhje të mesme, ku ky objekt shfrytëzohej si xhami gjatë të gjithë javës dhe vetëm një ditë në javë kremtohej mesha për të krishterët. Më pas ai kalon me shqyrtimin e vendosjes së kryqeve në kodrat e Bushatit. Në fund ai e cilëson si protagonizëm me pasoja negative atë të autoriteteve qendrore fetare dhe se e gjithë shoqëria duhet të punojë për parandalimin e mosmarrëveshjeve të tilla.

179. E mërkurë 18 janar 2006

gazeta “Korrieri”

“A mjafton miti i “Tolerancës fetare””, forum, Fatos Lubonja, fq. 16.

Ky është një opinion i autorit në rubrikën forum të kësaj gazete. Në këto rreshta ky opinionist merr në shqyrtim disa mite të krijuara ku ai i tolerancës ndërfitare e merr shkakun nga sharrimi i kryqit të Bushatit. Ai bën një përmbledhje historike të asaj çka ka qenë intolerancë dhe citon edhe nga periudha otomane e deri rastin e mbylljes së kishave e xhamive në gjysëmshkullin e dytë të kaluar. Po ashtu mundohet të japi një përkufizim të gjerë të termit tolerancë nga pikëpamja filozofike duke cituar një filozof bashkëkohor francez Zhak Derrida. Ai kalon më pas në trajtimin e termit të në kontekstin e ri social në Evropë dhe kritikon duke bërë të vetat këndvështrimin e filozofit Derrida. Citojmë: “Jacque Derrida, kur trajton problemin e mprehtë të sfidave evropiane me emigrantët e shumtë muslimanë që e popullojnë sot Evropën, e atakon konceptin e tolerancës, sikurse e thashë edhe më lart, si një koncept që nënkupton superioritetin dhe asimilimin duke kërkuar që evropianët ta zëvendësojnë atë me konceptin e “mikpritjes së pakushtëzuar” me çka kupton pranimin e tjetrit me kulturën e tij. Këtë ai e konsideron sfidën e rradhës që ka Evropa përpara”. Pas disa arsytive ai e mbyll opinionin e tij me përfundimin se është partizan i ruajtjes së frymës shekulare dhe ekumenike që mbizotëron në Shqipëri.

Muaji Shkurt 2006

180. E mërkurë 1 shkurt 2006

gazeta “Tirana Observer”

“Shteti demokratik dhe edukimi fetar”, forum, Xhavit Shala, fq. 9.

Në këtë opinion trajtohet çështja e edukimit fetar nëpër shkolla si dhe subvencionimin nga ana e shtetit të këtij edukimi. Në këtë drejtim autori ngre shqetësimin veçanërisht ndaj kurseve fetare, të cilat janë mbajtur nga OJQ të ndryshme arabe me orientim vahabi-selefist. Janë pikërisht këto shoqata, gjithnjë sipas autorit, të cilat janë munduar të ndryshojnë besimin tradicional të shqiptarët dhe kanë bërë diversion. Më pas autori i referohet praktikës perëndimore të financimit të edukimit fetar dhe realizimit të tij në Francë e Angli. Kështu ai thotë në fund, citojmë: “Për kushtet e Shqipërisë do të ishte e rekomandueshme përfshirja e edukimit fetar në sistemin arsimor publik, duke respektuar laicitetin e shtetit dhe shekullaritetin e shkollës”.

181. E diel 5 shkurt 2006

gazeta “Ballkan”

“Feja nuk mund të jetë temë për karikaturë”, koment & analizë, Rainer Hermann (autori është opinionist i gazetave gjermane “Frankfurter Allgemeine Zeitung” dhe i gazetës turke “Zaman”), fq. 9.

Në pjesën e parë të këtij opinionit jepet një opinion estetik rreth karikaturistëve dhe karikaturave nga autori. Këtu autori shpjegon sesi persona politike si Husni Mubarak I Egjiptit apo tema të ndryshme janë paraqitur me mjeshtëri nga karikaturistët e botës arabe. Më pas në pjesën në vazhdim e titulluar “Feja”, autori kalon në dhënien e opinionit të tij për temat fetare. Ai thotë se, citojmë: “Të bësh portretin e Pejgamberit Muhamed për çdo karikaturist arab nuk ka të bëjë vetëm me faktin se në Islam është e ndaluar vizatimi i pikturës, karikaturës, apo fotos së tij. Në thelb ka të bëjë me faktin se, qoftë për sa i përket fesë Islame apo asaj Katolike, asnjëherë feja nuk mund të jetë një temë karikature”. Po ashtu ai njofton se është hapur një debat i madh në botën arabe rreth

karikaturave të Pejgamberit Muhamed nga gazeta daneze "Jyllands-Posten", ku është paraqitur profeti si terrorist.

182. E diel 5 shkurt 2006

gazeta "Standard"

"**Rinxehet debati për kishën-xhami**", speciale, Taulant Koplaku, fq. 11.

Në këtë shkrim flitet rreth përplasjes së krijuar për restaurimin e xhamisë në Kalanë e Rozafës në Shkodër. Anëtarë të Myftinisë së Shkodrës kanë reaguar ashpër ndaj lajmit të restaurimit të kësaj xhamie që më parë në shek. XV ka qenë kishë. Fondi për restaurimin është dhënë nga ambasadorja amerikane Marsi Rijs dhe kap shumën e 30.000 dollarëve. Reagimet e ashpra të muslimanëve të Shkodrës kanë ardhur pas lajmërimit që u është bërë nga Komiteti Shtetëror i Kulteve për fillimin e restaurimit. Ndërkaq edhe Komuniteti Musliman ka kërkuar që objekti të mbetet xhami siç ka qenë për 500 vjet rresht përndryshe të pezullohet.

"**Siri u vihet zjarri ambasadave perëndimore**", nëntituj "*Vazhdon irritimi në botën islame për karikaturat; Vatikani kritikoi gazetat që botuan karikaturat*", botë, pa autor, fq. 17.

Përveç lajmit të djegies së një ndërtese ku strehoheshin misione të ndryshme perëndimore në Siri, jepen edhe njoftime të ndryshme se çka ndodhur në Iran e Jordani. Gjithashtu njoftohet se kryeministri danez Rasmusen ka thirrur ambasadorët danezë në vendet e ndryshme muslimane për të gjetur rrugët e bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm për qetësimin e situatës. Po ashtu jepet qëndrimi i Vatikanit nëpërmjet një zëdhënësi, i cili ka konsideruar se, citojmë: "...e drejta e lirisë së fjalës nuk do të thotë e drejtë për të fyer besimet fetare".

183. E martë 7 shkurt 2006

gazeta "Metropol"

"**Spanja kërkon ndihmë për situatën në vendet arabe**", politikë, Brahim Shima, fq. 5.

Në këtë shkrim trajtohet vizita e ministrit të jashtëm spanjoll Migel Angel Moratinos ku në takim qe ka pasur me homologun e tij shqiptar Besnik Mustafaj, dy kanë qenë temat kryesore të bisedimit: hapja e ambasadës spanjolle në Tiranë, si dhe ka kërkuar që Shqipëria të përcjelli mesazhe moderuese në Konferencën Islamike si anëtare e saj rreth protestave të ashpra ndaj botimit të disa karikaturave të Profetit Muhamed në një

gazete daneze. Gjatë një konferencë të përbashkët për mediat ministri spanjoll Moratinos ka deklaruar: “Është e vërtetë se Shqipëria është një vend me shumicë popullsie myslimane dhe gjatë bisedimeve kemi trajtuar edhe këtë problematikë të ekseseve që po ndodhin në Botën Arabe ndaj këtyre botimeve. I kam kërkuar kolegut tim shqiptar, si anëtar i Konferencës Islamike, që të dërgojë atje mesazhin e moderacionit”.

“Kur përplasen kulturat”, bota speciale, grup opinionesh, fq. 20.

Në këtë faqe jepen opinione të shkurtra nga mendimtarë e figura të ndryshme nga vende të ndryshme të botës përreth problemit të karikaturave të botuara nga një gazetë daneze. Ndër ta dallon akademiku mysliman që jeton në Zvicër, Tarik Ramadan.

“Protestat Zjarri që nuk shuhet”, bota speciale, pa autor, fq. 21.

Në këtë shkrim bëhet një përmbledhje e reagimeve të ndryshme në vende të ndryshme myslimane rreth çështjes së karikaturave. Ato përfshijnë lajme nga Siria, Libani, Afganistani e Irani. Jepet njoftimi i djegies së konsullatës daneze në Bejrut si dhe bojkotimin dhe bllokadën që ka nisur në botën myslimane rreth prodhimeve daneze.

184. E martë 7 shkurt 2006

gazeta “Koha Jonë”

“Spanja, përfaqësi diplomatike në Tiranë”, mbititull *“Ministri spanjoll: Shqipëria të nisë mesazhe në Konferencën Islamike”*, lajmi i parë, M. Bejdo, fq. 3.

Në këtë shkrim njoftohet lexuesi për vizitën e ministrit të jashtëm spanjoll Migel Angel Moratino në Tiranë për hapjen e ambasadës spanjolle. Ai ka pasur takim me homologun e tij shqiptar Besnik Mustafaj ku është diskutuar rreth problemit të karikaturave. Më pas gjatë një konferencë të përbashkët për mediat ministri spanjoll Moratinos ka deklaruar: “Është e vërtetë se Shqipëria është një vend me shumicë popullsie myslimane dhe gjatë bisedimeve kemi trajtuar edhe këtë problematikë të ekseseve që po ndodhin në Botën Arabe ndaj këtyre botimeve. I kam kërkuar kolegut tim shqiptar, si anëtar i Konferencës Islamike, që të dërgojë atje mesazhin e moderacionit”.

185. E martë 7 shkurt 2006

gazeta "Express"

"Karikaturat, Shqipëria të negociojë si vend islamik", politikë, Leonard Mitro, fq. 2.

Edhe në këtë shkrim jepet jehona e vizitës së ministrit të jashtëm spanjoll Migel Angel Moratinos me rastin e hapjes së ambasadës spanjolle në Tiranë dhe takimet që ka pasur me homologun e tij Besnik Mustafaj, edhe me funksionarë të tjerë të lartë të shtetit shqiptar. Gjatë takimit me ministrin shqiptar Mustafaj, ai i ka kërkuar që Shqipëria të ndërhyjë duke përcjellur mesazhet e moderacionit në Konferencën Islamike. Ai ka kërkuar që Shqipëria të bëjë thirrje për qetësi në vendet e Lindjes të Mesme, ku po shkatërrohen ambasada dhe institucione daneze.

186. E martë 7 shkurt 2006

gazeta "Shekulli"

"Konflikti për Muhamedin, Spanja kërkon ndërhyrjen e Shqipërisë", ngjarje e ditës, N. Perndoj, fq. 5.

Po ashtu edhe kjo gazetë e ka fokusuar vëmendjen e saj pikërisht në konfliktin e karikaturave dhe kërkesës që i është bërë ministrit të jashtëm Mustafaj, nga homologu spanjoll Migel Angel Moratinos. Gjatë bisedave për hapjen e ambasadës spanjolle në Tiranë dhe çështjeve të tjera të diskutuara midis dy ministrave, një vend të veçantë i është kushtuar çështjes së karikaturave. Ministri spanjoll i ka kërkuar kolegut shqiptar të çojë mesazhe paqësore në Konferencën Islamike. Më pas gjatë një konferencë të përbashkët për mediat ministri spanjoll Moratinos ka deklaruar: "Është e vërtetë se Shqipëria është një vend me shumicë popullsie myslimane dhe gjatë bisedimeve kemi trajtuar edhe këtë problematikë të ekseseve që po ndodhin në Botën Arabe ndaj këtyre botimeve. I kam kërkuar kolegut tim shqiptar, si anëtar i Konferencës Islamike, që të dërgojë atje mesazhin e moderacionit".

187. E mërkurë 8 shkurt 2006

gazeta "Express"

"Karikaturat e Profetit përflakin botën", reagime, pa autor, fq. 2.

Në këtë faqe të shoqëruara edhe me foto janë pasqyruar ngjarje dhe reagime shkurt nga disa vende të botës, si Afganistani, Pakistani, Irani, Turqia, Prishtina etj. Ndër reagimet më të rëndësishme është ai që vjen nga sekretari i përgjithshëm i

Këshillit të Evropës, Teri Dejvis që e ka kritikuar botimin karikaturave. Ai thotë, citojmë: “Publikimi i karikaturave ndoshta nuk i tejkalon kufijtë e ligjit, por me siguri i shkel normat etike të bazuara në respektimin e ndërsjellë dhe në pranimin e besimit fetar të të tjerëve”.

“Imami në xhami bën thirrje për protesta në Shqipëri”, politikë, pa autor, fq. 3.

Në këtë shkrim bëhet fjalë për një thirrje që u është bërë besimtarëve të një xhamie në Tiranë, së cilës nuk i përmendet emri, ku është cilësuar si një ofendim i madh prej imamit të kësaj xhamie botimi i karikaturës së Profetit Muhamed në një të përditshme daneze. Ndërkaq pas faljes besimtarët kanë diskutuar rreth këtij problemi, ku janë vënë re dy linja, gjithnjë sipas artikullshkruesit “të ashprir” dhe “të moderuarit”. Autori thotë se besimtarët janë në vëmendjen e SHISH-it, citojmë nga shkrimi: “Për këtë qëllim policia dhe SHISH është duke mbajtur në survejim të rreptë disa elementë ekstremistë, të identifikuar edhe më parë për qëndrimin e tyre radikal”. Më poshtë pasojnë disa prononcime të disa figurave politike të opozitës si Paskal Milo, Ilir Meta, Arta Dade etj., rreth kërkesës që i është bërë ministrit të jashtëm Besnik Mustafaj nga homologu i tij spanjoll Moratinos që Shqipëria të dërgojë mesazhin e saj të moderacionit në Konferencën Islamike. Këta politikanë e kanë cilësuar këtë deklaratë si të pavend. Më tej jepet një thirrje e Komunitetit Musliman për më tepër maturi.

188. E mërkurë 8 shkurt 2006

gazeta **“Gazeta Shqiptare”**

“Ia vlen të matemi me kut islamik”, opinion, Plator Nesturi, fq. 22.

Autori pasi jep një përmbledhje të asaj çka ndodhur në këto 13 vjet pasi Shqipëria ka hyrë në Konferencën Islamike, si dhe deklaratën e ministrit të jashtëm spanjoll Moratinos thotë se, citojmë: “Është e natyrshme që nuk mund të kemi luksin e megallomanisë të mendojmë se Shqipëria si vend anëtar do të ndikojë në moderacionin e OKI”. Në mbyllje të opinionit të tij autori thotë se Shqipërisë nuk i vlen të matet me kut islamik dhe se nuk e meritojmë të paguajmë një haraç të tillë.

“Nuk ka përse ta fshehim fenë”, opinion, Bashkim Kopluku, fq. 22.

Edhe ky opinion merret me kërkesën që i është bërë ministrit të jashtëm shqiptar Besnik Mustafaj nga ana e homologut të tij spanjoll, Moratinos. Ky autor i ka cilësuar zërat që dolën kundër

kësaj kërkesë të ministrit Moratinos si snobë anti-myslimanë. Hyrjen e Shqipërisë në OKI, autori e përshkruan si si një përpjekje të saj për hapje ndaj botës. Po ashtu ai thotë: “Pra, ne shqiptarët, së bashku me vendet perëndimore, duhet të kontribuojmë për sqarimin dhe qetësimin e gjërave, qoftë edhe duke pranuar ndërmjetësimin në qeveritë e vendeve anëtare të OKI, megjithëse ne na duket se influenza jonë në atë organizatë është tepër e vogël, dhe kërkesa e ministrit spanjoll, së paku ashtu siç u tha, tregon një mungesë njohje nga ai, ose nga stafi i tij:...”.

189. E mërkurë 8 shkurt 2006

gazeta “Koha Jonë”

“Çështja e karikaturave kthehet në krizë globale”, lajmi i parë, Diella Vuka, fq. 2.

Në këtë faqe jepen njoftime të protestave nga vende të ndryshme të botës myslimane, për shkak të botimit të karikaturave të profetit Muhamed nga një gazetë daneze. Protestuesit kanë dëmtuar misionet diplomatike në vendet muslimane. Sekretari i përgjithshëm i OKB-së u ka bërë thirrje vendeve muslimane që ta pranojnë ndjesën e gazetës daneze. Më poshtë jepet qëndrimi zyrtar i Danimarkës nëpërmjet kryeministrit të saj Rasmusen, ku ai ka këmbëngulur “...që kultura e lirisë së shtypit në vendin e tij do të thotë që qeveria nuk mund të kërkojë falje për atë që bën një gazetë e pavarur”. Më tutje jepet një kronologji e ngjarjeve qysh nga data 30 shtator 2005, kur gazeta daneze Jyllands-Posten ka botuar për herë të parë 12 karikatura të profetit Muhamed. Po ashtu jepen edhe disa raste të tjera blasfemish, kryesisht ndaj Jezu Krishtit, karikatura të cilat janë botuar në Evropë dhe autorët mbrohen me ligj.

“Myslimanët: Karikaturat, fyerje mjaft e rëndë”, lajmi i parë, Eglantina Nasi, fq. 3.

Në këtë shkrim jepen reagimet e KMSH-së pas një njoftimi për mediat ku është shprehur qëndrimi i tyre zyrtar. Sipas drejtuesve të këtij Komuniteti ato e kuptojnë lirinë e shprehjes, por citojmë nga shkrimi: “Mirëpo ky akt i kapërcen kufijtë e kësaj lirie, sepse luan me dinjitetin e gjithë myslimanëve të cilët sot përbëjnë një të pestën e globit duke ofenduar vlerat e tyre më të shenjta”. Për muslimanët shqiptarë personaliteti i Profetit Muhamed lidhet ngushtë me nderin dhe dinjitetin e çdo muslimani. Po ashtu Komuniteti Musliman Shqiptar ka përshëndetur aktin qytetar të kryeministrit danez, i cili është shprehur se nuk do të kishte bërë të tilla vizatime. Fjalët e

kryeministrit në KMSH janë përcjellur nga ambasadori danez në Tiranë, ku në këtë deklaratë citohet të ketë thënë: “unë për veten time, nuk do të zgjidhja kurrë të përshkruaja simbolet fetare në këtë mënyrë”. Më pas shkrimi vijon me citime të tjera nga deklaratat e KMSH. Në një vend tjetër të posaçëm jepen edhe qëndrimet e ish-ministrave të jashtëm Arta Dade dhe Ilir Meta, të cilët kanë deklaruar se Shqipëria nuk ka ndonjë ndikim në Konferencën Islamike, si dhe reagimet e Kofi Anan dhe Kombeve të Bashkuara rreth kësaj çështjeje.

190. E enjte 9 shkurt 2006

gazeta “Korrieri”

“**Kur karikaturat përshtjellojnë botën**”, forum, Mustafa Nano, fq. 18.

Në këtë opinion autori merret me problemin e karikaturave dhe protestave që e kanë shoqëruar atë. Ai mundohet të argumentojë që portreti i Muhamedit është bërë edhe më përpara në Mesjetën e hershme. Më poshtë ky autor merret me debatin e lirisë së shprehjes, vetëcensurimit dhe përgjegjësisë që varet “nga vetëdija e të qenit pjesë e një bote delikate, ekuilibri i së cilës varet shpesh herë në fijet e penjve të hollë lehtësisht të këputshëm”. Ndërkaq ky autor i cilëson protestat e Sirisë dhe të Iranit si jo spontane, por të organizuara nga vetë shtetet përkatëse. Në mbyllje ky autor lavdëron muslimanët shqiptarë dhe mos-reagimin e tyre nëpërmjet protestave.

“**Rikonkuesta shqiptare**”, forum, Sokol Dervishaj, fq. 18-19.

Ky është një tjetër opinion në rubrikën forum të kësaj gazete në vazhdim të debatit mbi karikaturat e botuara nga një gazetë daneze, si dhe për kërkesën e bërë nga ministri i jashtëm spanjoll Moratino për ndërhyrjen e moderacionit të Shqipërisë në botën muslimane. Autori mundohet ta nxjerri kombin shqiptar me rrënjë të thella evropiane edhe përpara se të krishterizohej. Kështu sipas tij shqiptarët kanë luftuar qysh herët për identitetin e tyre kombëtar dhe është i mendimit se, citojmë: “Prandaj ndodh që vjen një spanjoll, hedh një shashke dhe askush nuk reagon, duke i yshtur edhe tej demonet që konfliktin e tyre duan ta transferojnë diku tjetër. Për fat të keq, kur ne roberoheshim dhe viheshim nën trysninë e deformimit të identitetit tonë të lashtë, Spanja rifitonte me luftë identitetin e saj”.

“Implikimet e pjesëmarrjes në Konferencën Islamike”, forum, Piro Misha, fq. 19.

Ky opinion është në vazhdim të rubrikës forum dhe merret me një deklaratë të zëvendësministrit të jashtëm shqiptar të integritit, Albert Gajo, i cili ka deklaruar se Shqipëria ka vendin e vet në botën e vendeve islamike. Ky deklarim ka sjellë shqetësimin e autorit, duke e cilësuar z. Gajo si të papërvojë. Ai i referohet parimit të laicitetit të shtetit, duke i lënë mënjanë besimet fetare. Pjesëmarrjen e Shqipërisë në samitin e Konferencës Islamike më 7-8 dhjetor ai e cilëson si “ambiguitet thuajse skizofrenik thuajse të rrezikshëm”. Kështu ai vazhdon më tej me komentimin e dokumentit të dalë nga kjo konferencë, si dhe ngre pyetjen: “A e përkrah shteti ynë idenë e zbatimit të parimeve të Kartës Islamike të Kajros të të drejtave të njeriut?”.

191. E enjte 9 shkurt 2006

gazeta **“Gazeta Shqiptare”**

“Identiteti islam”, opinion, Ilir Kulla, fq. 24.

Edhe ky opinion merret me kërkesën e bërë nga ministri spanjoll Moratino, duke e cilësuar atë si “një të vërtetë historike”. Pra, për identitetin mysliman të shqiptarëve. Këtë përkatësi fetare autori e cilëson si diçka të zakonshme që nuk e dëmton Shqipërinë. Në mbyllje ai thotë: “E pra faji nuk është i identitetit fetar nëse sot ka konflikte dhe luftra në botë. Është tjetër gjë pjesëmarrja apo jo e Shqipërisë në një organizatë ndërkombëtare siç është OKI dhe tjetër gjë përkatësia dhe identiteti multifetar që ka kombi shqiptar”.

192. E shtunë 11 shkurt 2006

gazeta **“Tema”**

“Çallma e harruar e Muhamedit”, editorial, Andi Bushati, fq. 1 me vazhdim 10.

Në këtë shkrim autori jep shqetësimin e tij në fillim se mediat tona përveç se kanë dhënë njoftimet e protestave myslimane ndaj karikaturave, nuk kanë bërë gjë tjetër deri tani. Ai pretendon se duhet të ishte hapur një debat pikërisht për këtë temë. Por shqetësimi më i madh për të ka qenë falënderimi që i bëri mediave shqiptare për mosbotimin e karikaturave, ambasadori iranian Biazar në një konferenca shtypi. Ky opinionist nuk e quan të nevojshme veprimin e ambasadorit iranian dhe thotë se e vërteta është që sot, citojmë: “..., një nga pikat themelore për të cilat po zhvillohet debati, është ajo që mes atyre që janë kategorikë në mbrojtjen e lirisë së

shprehjes dhe atyre që kërkojnë kufizimin e saj (këtë radhë në mbrojtje të imazhit të Muhamedit).

“Luftë karikaturash”, opinion, Jonila Godole, fq. 11.

Që në fillim të opinionit të saj, autorja e ka cilësuar si matje të nivelit të provokimit faktin që gazeta daneze ka shkuar të intervistojë “një prej imamëve më radikalë” për botimin e karikaturave. Ajo cilëson se edhe media shqiptare ka uruar që të ndizen “gjakrat” brenda komunitetit fetar shqiptar dhe se ajo e ka reduktuar debatin rreth këtij problemi “..., duhet lejuar apo jo publikimi i ilustrimeve karikatureske për tematika të caktuara”. Më pas ajo bën një përmbledhje në formë komenti të disa ngjarjeve ndërkombëtare e më pas thotë, citojmë: “Pas 11 shtatorit 2001, studiues, politologë, psikologë nga Ameriak, Kanadaja dhe Europa u përpoqën t’i bëjnë të qartë Uashingtonit, se terroristët duhej të ndiqeshin derisa të vendosej drejtësia, por në asnjë mënyrë nuk duhej nisur përplasja e kulturave. Zgjedhja e kulturës islamike si sinonim i armikut flet për të kundërtën”.

193. E shtunë 11 shkurt 2006

gazeta **“Standard”**

“Pse nuk u botuan karikaturat në shtypin shqiptar”, kopertina, V. Murati, fq. 12.

Nën këtë titull hap Standardi javor forumin e përplasjes së mendimeve prej 6 faqesh rreth problemit të botimit të karikaturave nga gazeta daneze “Jyllands Posten”. Gazetarja që e ka mbuluar këtë forum na jep një përmbledhje të mendimeve pro e kundra, të cilat ajo ka mbledhur nga disa opinionistë dhe gazetarë shqiptarë rreth këtij problemi. Ato janë Aurrel Plasari, Remzi Lani, Mark Marku, Olsi Jazexhi, Adri Nurellari dhe Alfred Peza. Ndërsa në fund e mbyll me mendimin e dhënë nga njëri prej autorëve më të njohur të mendimit islam Fet’hullah Gylen si dhe me intervistën e marrë nga kryetari i BISH (KMSH) , H. Ing. Selim Muça. Ai e ka cilësuar botimin e karikaturave si: “..., është një akt i rëndë fyes ndaj besimtarëve myslimanë. Për më keq, në këtë rast nuk bëhet fjalë vetëm për karikaturimin e profetit Muhamed, e cila sërish nuk do të ishte e pranueshme, por për disa karikatura që janë thelbësisht denigruese dhe fyese”.

194. E hënë 13 shkurt 2006

gazeta "Metropol"

"Nuk është çështje e lirisë së shprehjes", bota speciale, pa autor, fq. 20.

Në këtë faqe nga bota është dhënë një intervistë e studiuesit pakistanez Ahmed Rashid, ku intervistuesi nëpërmjet pyetjeve të përgatitura dhe përgjigjeve, është munduar të kuptojë atmosferën dhe reagimin e muslimanëve rreth problemit të botimit të karikaturave. Pyetjes se kush përfiton nga skandali, Ahmed Rashid përgjigjet: "E gjithë episodi po nxit ekstremistët në të dy krahët". Ndërsa pyetje se cila do të ishte përgjigjja më e përshtatshme ai i përgjigjet: "Nuk po them që kryeministri danez duhet të fusë në burg redaktorin. Por, redaktori duhet të bëhet përgjegjës për humbjen e jetëve që ka ndodhur, për pandjeshmërinë që ka treguar si dhe mungesën totale të respektit për besimet dhe komunitetet e tjera në vetë Danimarkën".

195. E martë 14 shkurt 2006

gazeta "Tirana Observer"

"Aty ku mbaron liria ime, fillon liria e tjetrit", forum, Luan Rama, fq. 8.

Autori i këtij shkrimi e nis opinionin e tij duke shprehur habinë se nuk pritej që karikaturat do të shkaktonin gjithë këto trazira. Më pas ai vijon me një sërë deklarimesh të bëra nga udhëheqës të ndryshëm botërorë, të cilët kanë kërkuar të respektohen ndjenjat e besimtarëve. Ai citon gjithashtu fjalët e zëdhënësit të Vatikanit, Navarro Valls, ku thuhet citojmë: "E drejta e lirisë së shprehjes nuk nënkupton të drejtën e plagosjes të ndjenjave fetare të besimtarëve". Më pas ai vazhdon duke treguar rreth fetvasë së Khomeinit, e cila dënonte me vdekje Selman Ruzhdi, vrasjen e Teo Van Gogut nga një islamik radikal, kërcënimet me vdekje që kanë marrë të tjerë dhe së fundmi në këtë kronologji përfshin edhe karikaturat. Ndërsa ribotimin e tyre në Norvegji më 10 janar 2006 nga revista "Magazinet", ai e cilëson si një "shkarje të rrezikshme". Më 30 janar edhe gazeta daneze Jyllands Posten, edhe Magazinet kërkojnë falje publike për botimin e karikaturave, por situata vazhdoi të mbetet e njëjtë sepse shumë gazeta të tjera evropiane i ribotuan ato. Më tej ai lavdëron gazetarinë shqiptare, e cila nuk i botoi ato, duke respektuar ndjenjat e besimtarëve, por bën edhe një përmbledhje rreth lirisë së karikaturimit në Perëndim të figurave të ndryshme politike si dhe të papës. Ndërsa në fund autori e

mbyll shkrimin me thënien e myftiut të Bosnje-Hercegovinës, Mustafa Cerić pasi ka tërhequr çmimin e paqes të UNESCO-s, citojmë: “Noe e krijoi atë barkë për shpëtimin e gjinisë njerëzore. A nuk mund të krijohet dhe ne një barkë për të shpëtuar llojin njerëzor, atë çka na bashkon të gjithëve?”

“Paturpësia e karikaturave dhe çoroditja e politikës”, forum, Xhavit Shala, fq. 9.

Edhe ky opinionist në këtë faqe të forumit të debatit shpreh mendimet e tij rreth problemit të karikaturave që ka sjellë shqetësime dhe protesta jo vetëm në botën myslimane. Fillimisht autori bën një përmbledhje të gjendjes politike të brendshme të disa vendeve myslimane në çastin kur u botuan karikaturat. Më pas ai përmend faktin që Komuniteti Musliman Shqiptar reagoi në mënyrë të matur dhe të kulturuar dhe se vetë ambasadori danez në Tiranë ka shkuar në selinë e Komunitetit Musliman dhe ka dorëzuar deklaratën e kryeministrit danez që i ka dënuar karikaturat. Më pas ai bën edhe disa komente rreth kërkesës që i bëri ministri i jashtëm spanjoll Moratino, kolegut të tij shqiptar Mustafaj, si dhe reagimeve që ngjalli kjo kërkesë në opinionin vendas. Në mbyllje ai komenton: “Përfundimisht, politika shqiptare nuk u tregua bashkëpunuese dhe e gatshme të ndihmojë në zbutjen e krizës së karikaturave, krizë e cila po kërcënon sigurinë e disa shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Spanja e BE-ja i kërkuan ndihmë politikës shqiptare, thjesht për të dhënë mesazhe moderacioni”.

196. E enjte 16 shkurt 2006

gazeta “Telegraf Ditor”

“Ministri shpërndan bluza me karikaturat e profetit”, metropol, ANSA, fq. 12.

Ky është një lajm i shkurtër i marrë nga ANSA, ku citohet se një ministër i qeverisë italiane, Roberto Calderoli, ka stampuar bluza me karikaturat e Profetit dhe i ka shpërndarë ato. Ai ka deklaruar se edhe vetë do të veshë një bluzë të tillë, duke e vënë në vështirësi qeverinë italiane dhe dialogun me muslimanët. Ky ministër është anëtar i grupimit politik “Lega Nord”, i mirënjohur për fobinë e tyre ndaj emigrantëve.

197. E premte 17 shkurt 2006

gazeta "Tema"

"Toleranca fetare, pararoja e integritit të Shqipërisë", intervista, Enton Palushi, fq. 12-13.

Kjo është një intervistë me ambasadorin danez në Tiranë Finn Theilgaard rreth trazirave që ngjallën në të gjithë botën, botimi i disa karikaturave të Profetit Muhamed. Ai jep shpjegime të ndryshme rreth qëndrimeve të kryeministrit danez Rasmusen si dhe për atmosferën e krijuar në Danimarkë pas botimit të karikaturave, si dhe jep informacione për muslimanët e Danimarkës. I pyetur për qëndrimin e Shqipërisë, ambasadori thotë: "Doja të thoja që kam pasur kontakte me përfaqësues të të rinjve myslimanë, dhe jam i prekur dhe i emocionuar nga këto kontakte. Ata kanë mendimin e tyre, të të qenit të rinj, të të qenit europianë, të të qenit myslimanë, dhe të gjitha këto qëndrojnë së bashku, dhe kjo është shumë e rëndësishme për të ardhmen e Shqipërisë".

198. E premte 17 shkurt 2006

gazeta "Standard"

"Përjetimi i karikaturave dhe gruaja e tij myslimane", intervistë, Edi Lesi, fq. 2-3.

Në këtë intervistë ambasadori danez Theilgaard i përgjigjet pyetjeve të ndryshme që i bëhen atij rreth problemit të karikaturave dhe reagimeve të ashpra që patën në të gjithë botën muslimane. Në një nga përgjigjet e tij ambasadori danez tregon për takimet që ka pasur me përfaqësues të politikës, autoritetet fetare dhe grupe të rinjsh myslimanë rreth këtyre problemeve. Ai gjithashtu tregon se si janë të organizuara komunitetet fetare myslimane në shoqërinë daneze. Pyetjes së gazetarit se kë do të vinte të parën shoqëria daneze respektin, tolerancën apo lirinë e shprehjes ai përgjigjet: "Të dyja këto janë gur themeli për shoqërinë daneze. Ne të gjithë duam që të kemi lirinë e shprehjes, por kjo nuk mund të jetë e pakufishme. Ne në Danimarkë kemi rregulla të cilat i dënojnë këto diskriminime dhe këto ndalohen sipas kodit penal danez".

199. E shtunë 18 shkurt 2006

gazeta "Standard"

"Feja ndan nuk duhet përmendur vend e pa vend", kopertina, Henri Çili, fq. 16-18.

Kjo është një intervistë me poetin Ervin Hatibi, e cila botohet në faqet e Standardit javor, ku Hatibit i janë drejtuar një seri

pyetjesh nga intervistuesi rreth problemit të karikaturave. Përveç këtyre pyetjeve atij i janë drejtuar edhe një seri pyetjesh të tjera që kanë të bëjnë me jetën e tij personale si besimtar dhe poet. Pyetjes se si u ndjetë që asnjë gazetë në Shqipëri nuk i botoi karikaturat, ai i përgjigjet citojmë: “Pyetja më duket në shumës, ndërkaq që unë vetëm mund të përfytyroj se normalisht, ashtu si unë edhe të tjerë njerëz, besimtarë ose jo besimtarë, duhet të jenë ndier më të qetë që nuk u bëmë edhe në karikaturë si disa komunitete të tjera nëpër botë, qoftë nga njëra apo tjetra anë e barrikadës daneze”. Ndërsa karikaturat Hatibi i cilëson si: “Për mua karikaturat nuk kishin fare të bënin me figurën të cilën përpiqeshin të paraqisnin sa me faktin se përpiqeshin të aktivizonin idenë se barbaria dhe terrori janë arketipave në Islam. Për mua, karikaturat nuk ishin çyshtje blasfemie, sa ishin çështje sulmi racist. Në momentin ku qindra milionë njerëz në botë, edhe po qe se janë ateistë, jetojnë nën peshën e trashëgimisë kulturore islame, mbajnë emra, veshje dhe shenja racore që lidhen me të qenit mysliman, mbi të gjithë këta rrezikon të peshojë portretizimi i krye-simbolit njerëzor të kulturës së tyre si një barbar, si një kamikaz”.

200. E mërkurë 22 shkurt 2006

gazeta “Shekulli”

“Nuk e pranojmë artin që frymëzon urrejtje”, kulturë, Elsa Demo, fq. 19.

Kjo është një intervistë e dhënë nga znj. Marsi Rijs, ambasadore e SHBA-së në Tiranë me rastin e hapjes së një ekspozite. Ajo e refuzon artin që frymëzon urrejtjen tek njerëzit. Pyetjes së intervistueses për kufijtë e lirisë së shprehjes, znj. Rijs i përgjigjet: “Kjo është një pyetje e vështirë për t’iu përgjigjur, për të përcaktuar kufijtë e lirisë. Ne nuk mund të pranojmë art që frymëzon urrejtje, dhunë apo që përfaqësojnë paragjykime ndaj racave të veçanta ose grupeve etnike të caktuara. Ne e konsiderojmë të urryer, të neveritshëm një art të tillë. Kjo shkon kundër idesë tonë për tolerancë dhe barazi”.

201. E enjte 23 shkurt 2006

gazeta “Shekulli”

“Shkodër, Myftinia: Po rritet arroganca ndaj myslimanëve”, kronikë, Anila Dushi, fq. 17.

Në këtë shkrim jepen deklaratat e një dite më parë të Myftinisë së Shkodrës rreth problemit të karikaturave. Në këtë deklaratë Myftinia i ka dënuar këto publikime si akte destabilizues dhe

që baltosin dinjitetin e myslimanëve. Në një pjesë të deklaratës thuhet: “Nuk e dimë se pse këtu dhe në Perëndim çdo ditë e më tepër po shtohet arroganca ndaj myslimanëve dhe Islamit, në një kohë që dikush sa për sy e faqe trumbeton mbrojtjen e të drejtave të besimit dhe lirive të njeriut”.

202. E enjte 23 shkurt 2006

gazeta “Metropol”

“A është e vërtetë përplasja e qytetërimeve?”, koment, dr. Arqile Boti, fq. 20-21.

Ky koment është shkëputur nga libri i Arqile Botit “Sistemet politike dhe 666”, libër që pritet të dali së shpejti në qarkullim. Në këtë pjesë autori mundohet të shpjegojë se nuk ka ndonjë përplasje midis qytetërimeve sipas tezës së Hantingtonit, i cili thotë se ka përplasje midis të krishterëve dhe muslimanëve. Ai bën dallim mes besimtarit të krishterë dhe atij që mban një emër të krishterë. Ai nuk e konsideron se të dyja këto fe janë larg njëra-tjetrës, e citojmë: “Duke trajtuar dhe ripërmendur rastin e fundit të karikaturave të profetit Muhamed, duhet të jenë të qartë gjithashtu se ata që i kanë botuar në çdo pozicion shoqëror dhe politik që të jenë janë ateistë dhe materialistë. Atëherë nuk duhen konfunduar besimtarët e krishterë që të ballafaqohen me besimtarët islamë, sepse si esencë dogmatike, Islamizmi qëndron afër Krishterimit, veçanërisht në lindjen e Jezusit, siç e theksuam më lart”.

“Një karikaturë mes diversitetit të kulturave”, koment, Miranda Haxhia, fq. 21.

Ky koment e ka marrë shkasin përsëri nga problemi i karikaturave dhe zemërimit që ngjallën ato në botën myslimane dhe autorja mundohet të japi shpjegime pse ka ndodhur një gjë e tillë. Ajo mendon se nja nga arsytet është diversitet kulturor dhe në përgjithësi të gjithë elementet e cituara kanë të bëjnë me këtë diversitet. Pavarësisht se nuk e thotë në mënyrë të qartë, autorja e konsideron qytetërimin perëndimor si një qytetërim superior dhe në fund rreket të japë mendimin rreth asaj çka po ndodh në botën arabe, citojmë: “Mjeti i përdorur prej botës së acaruar arabe është mjet dhune dhe shkatërrimi, që konsiston arratinë dhe dhunën nga vetë pafuqishmëria drejt botës së jashtme, duke e shkatërruar atë me sa të mundë. Kjo nuk do të shpjegojë që myslimanët duke kërkuar të jenë vetvetja, duke adoptuar personalitetin e tyre, duke ofruar modele kulturore të jashtme, do të zhdukjin diferencat mes tyre dhe botës. Personaliteti shndërrohet në një autonom që ka mohuar

vetveten në kërkim të mbrojtjes së një gjysmë milioni të tjerë autonomë, duke ruajtur paqen dhe jo duke zhvilluar elementë të urrejtjes dhe shprehje të racizmit”.

Gazetat e përditshme të shfrytëzuara:
SOT, Korrieri, Ballkan, Tirana Observer, ABC, Dita, Express, Shekulli, Gazeta Shqiptare, Koha Jonë, Metropol, Panorama, Republika, Tema, 55, Standard, Durrësi Bulevard, Telegraf Ditor.

Tabelë analitike e shkrimeve të paraqitura në monitorimin e mediave të shkruara shqiptare

Nr.	Gazeta	Intervista	Dossier, Reportazh	Komente, opinion, analiza.	Lajmi	Shoqeria	Bota	Kultura	Sasia e shkrimeve gjithej
1.	Gazeta Shqiptare	3	2	3	18	1	2	-	29
2.	Korrieri	1	I*	12	26	2	I*	-	42
3.	Ballkan	-	1	I*	8	1	I*	-	12
4.	Tirana Observer	8	3	7	4	-	-	-	22
5.	ABC	1	-	1	-	-	-	-	2
6.	Dita	1	I I*	I*	1	2	II*	-	7
7.	Express	2	-	-	15	3	3	-	23
8.	Shekulli	1	2	4	21	3	-	2	33
9.	SOT	-	-	3 II*	2	2	II*	-	9
10.	Koha Jone	-	-	1	7	2	1	-	11
11.	Metropol	-	-	3	10	2	8	1	24
12.	Panorama	-	-	2	21	-	-	1	24
13.	Republika	-	1	-	2	-	-	-	3
14.	Tema	1	I I*	3	2	-	I*	-	8
15.	55	-	-	1	-	1	1	1	4
16.	Standard	4	-	9	8	2	1	-	24
17.	Telegraf Dior	-	-	I*	-	-	I I*	-	2
18.	Albania	-	1	1	10	5	-	-	17
19.	Durresi Bulevard	-	1	-	-	-	-	-	1
19	Totali	22	15	56	155	26	17	5	296

* me shifrat romake dhe me këtë shenjë janë shënuar ato artikuj apo shkrime që i përkasin rubrikës “dossier, reportazh”, por që vijnë nga bota.

Shkrimet e evidentuara në monitorim

Në krye të listës të gazetave që kanë treguar një vëmendje të posaçme ndaj muslimanëve dhe problemeve të tyre janë:

1. Korrieri me	42	shkrime të ndryshme
2. Shekulli	33	
3. Gazeta Shqiptare	29	
4. Standard	24	
5. Panorama	24	
6. Metropol	24	
7. Express	23	
8. Tirana Observer	22	
9. Albania	17	
10. Ballkan	12	
11. Koha Jonë	11	
12. SOT	9	
13. Tema	8	
14. Dita	7	
15. 55	4	
16. Republika	3	
17. Telegraf Ditor	2	2
18. ABC	2	
19. Durrësi Bulevard	1	

Ndërsa nga rubrikat më e pasura ka qenë ajo e **lajmit** me 155 lajme të ndryshme dhe është e kuptueshme përse, ku edhe këtu në krye të listës është:

1. Korrieri	26
2. Shekulli	21
3. Panorama	21
4. Gazeta Shqiptare	18
5. Express	15
6. Metropol	10
7. Albania	10

Po ashtu një nga rubrikat më të pasura ka qenë ajo e “**Komente, opinione, analiza**”, ku edhe këtu numrin më të madh të shkrimeve e ka:

1. Korrieri	12
2. Standard	9
3. Tirana Observer	7

Ndërsa me lajmet dhe komentet që vijnë nga “**Bota**” për Islamin dhe muslimanët është gazeta “Metropol”, e cila ka numrin më të madh të shkrimeve kundrejt 17 shkrimeve që janë në total. Siç edhe mund të shihet në bazë të shifrave ka një rritje të ndjeshme të interesit në mediat e shkruara për problemet e muslimanëve dhe kjo tregon se jo vetëm lajmet për terrorizmin islamik janë ato që bëjnë bujë. Nga të dhënat e mësipërme ky fakt vihet re qartë, si dhe nga rubrikat e ndryshme në të cilat evidentohet edhe më tej ky interes. Ndërsa më poshtë do të japim një përmbledhje të temave më të rëndësishme, të cilat janë trajtuar më gjerësisht nga shtypi. Një vëmendje e madhe është treguar ndaj marrëdhënieve ndërfetare, por tema më e ndezur ka qenë e ashtuquajtura “problemi i karikaturave”, e cila ka shqetësuar së fundmi të gjithë botën në përgjithësi, duke shkaktuar debate dhe diskutime, të cilat nuk janë shuar ende.

Temat që i kanë interesuar më tepër mediat e shkruara

Temat që i kanë interesuar shtypit të shkruar kanë qenë nga më të ndryshmet, por ato që kanë ngjallur më tepër interesimin e publikut të gjerë, në bazë edhe të rregullit të “scoop-it” gazetaresk si dhe të lajmeve që bëjnë bujë janë këto që po i rendisim më poshtë, sipas rendit kronologjik të ndjekur në këtë monitorim.

1. Gjykimi i Islamit ndaj vetëvrasjes, pas një serie vetëvrasjesh të disa të rinjve, që mendohet të jenë nxitur nga disa sekte fetare (“Dëshmitarët e Jehovahit).
2. Premtimi i kryeministrit Fatos Nano për hapjen e një universiteti islamik në Tiranë.
3. Nënshkrimi i marrëveshjes së katër komuniteteve fetare tradicionale në Shqipëri e quajtur “Deklarata e Angazhimeve të Përbashkëta Morale”.
4. Në vëmendjen e disa analistëve ka qenë zgjidhja e disa problemeve fetare, duke vendosur një marrëveshje më përfaqësuesit e lartë fetarë, për t’i dhënë zgjidhje problemit të edukimit fetar, duke shmangur kështu rreziqet e fundamentalizmit në të mirë të sigurisë kombëtare.
5. Problemi i lidhjeve shqiptare me “terrorizmin islamik ndërkombëtar”.
6. Shkarkimi i sekretarit administrativ të Komunitetit Musliman Shqiptar, Zylyftar Dervishi me akuzën e falsifikimit të diplomës.
7. Reformatorët dhe tradicionalët, përplasjet e brendshme mes myslimanëve.
8. Hetimet rreth vrasjes së ish-sekretarit të KMSH-së, Sali Tivari.
9. Fillimisht problemi i kryqit të vendosur në fshatin Fikas, në komunën e Bradasheshit, Elbasan, e më pas kryqet e vendosura në kodrat e komunës së Bushatit në Shkodër.
10. Rreth një ngjarje të rëndë të ndodhur në Baltëz të Fierit, ku gjetën vdekjen aksidentalisht me tritol dy besimtarë myslimanë.
11. Të ashtuquajturat akuza për përfshirjen e kryetarit të BISH, H. Ing. Selim Muça, në zgjedhjet e 3 korrikut 2005, në favor të një kandidati të Partisë Socialiste.

12. Shoqërimi në Drejtorinë e Policisë në Tiranë, dega e antiterrorit, të 6 imamëve të xhamive të kryeqytetit dhe anëtarë të këshillit të myftinive, për të ashtuquajturat kërcënime që u janë bërë Ilir Kullës (kryetar i KSHK) dhe Selim Muçës.
13. Themelimi i Forumit Musliman Shqiptar.
14. Fshati i Kondovës dhe lëvizja e tyre e etiketuar si “lëvizje ekstremiste islamike”, por ajo zhurmë u krijua për të tërhequr vëmendjen se Marrëveshja e Ohrit në Maqedoni nuk po zbatohet.
15. Kalimi i Medresesë pas nënshkrimit të kontratës me një shoqatë sponsorizuese turke nën kontrollin e kësaj të fundit dhe kundërshtimi i trupit pedagogjik.
16. Dorëheqja e parevokueshme e nënkryetarit të BISH, Bledar Myftari shoqëruar më akuza të ndryshme ndaj këtij institucioni.
17. Bin Ladeni ka investuar në Shqipëri nëpërmjet të tjerëve.
18. Fjalimi i mbajtur nga presidenti Alfred Moisiu në Oksford, Angli me temën: “Toleranca ndërfaqetare në traditën e popullit shqiptar”, i cili solli zemërimin e muslimanëve ndaj deklaratave të bëra në këtë fjalim.
19. Kthimi i pronave Komunitetit Musliman Shqiptar (BISH) nga ana e shtetit.
20. Përplasjet e krijuara në Shkodër për xhaminë-kishë në kalanë e Rozafës.
21. I ashtuquajturi problem “i debatit të karikaturave”, si dhe lajmet për protesta të ashpra në të gjithë botën myslimane.
22. Mbështetja që i ka kërkuar ministri i jashtëm spanjoll Migel Angel Moratinos, Shqipërisë për të përcjellë mesazhet e moderacionit në Konferencën Islamike si anëtarë e saj rreth protestave të ashpra ndaj botimit të disa karikaturave të Profetit Muhamed në një gazete daneze.

Shtojcë 1

Marrëveshja e katër komuniteteve fetare tradicionale dhe aktualiteti shqiptar

Pikërisht të premtën më 18 mars 2005 nënshkruhet një nga marrëveshjet më të rëndësishme ndërmjet katër komuniteteve ekzistuese prej qindra vjetësh në të gjitha trevat shqiptare. Pra, atyre komuniteteve që i përkasin dy feve tradicionale: të krishterë dhe muslimanë. Komuniteti bektashi që kryesisht është i përqëndruar në jug të vendit së bashku me atë të krishterë ortodoks, atij katolik që është i përqëndruar në Tiranë, Durrës, Mirditë, Shkodër e në ndonjë rreth tjetër si dhe Komunitetit Musliman Shqiptar që është edhe përfaqësuesi më i rëndësishëm dhe që përfshin të gjithë Shqipërinë zyrtare në hartën e vet të ndikimit. Pikërisht nga kjo pikëpamje ky i fundit është edhe më i rëndësishmi. Deklarata e firmosur nga përfaqësuesit e këtyre komuniteteve dhe që kanë në dorë efektivisht edhe drejtimin administrativ dhe atë shpirtëror është cilësuar si: “Deklarata e Angazhimeve të Përbashkëta Morale” dhe është firmosur nga Kryetari i Komunitetit Musliman Shqiptar H. Selim Muça, Kryegjyshi Botëror H. Dede Reshat Bardhi, Arqipeshkvi i Tiranës dhe Durrësit monsinjor Rrok Mirdita dhe Kryepeshkopi Ortodoks i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë Anastas Janullatos. Kjo u arrit edhe në sajë të bashkëpunimit me konferencën botërore “Fetë për paqen”, si dhe mbështetjen e Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë. Në bazë të kësaj deklarate të përbashkët është vendosur motoja “Predikimi në asnjë rast nuk duhet të nxisë urrejtje fetare”, dhe kështu këta drejtues të lartë angazhohen në bazë të kësaj deklarate për vazhdimin dhe promovimin e një atmosfere paqësore në vend brenda komuniteteve përkatëse fetare. Të pranishëm në këtë nënshkrim të rëndësishëm kanë qenë krerë të lartë shtetërorë, trupat diplomatikë dhe natyrisht edhe zyrtarë të lartë të këtyre komuniteteve. Ky është një tregues edhe i rëndësisë së dhënë nga të gjithë palët e interesuara, ku më të interesuarit janë jo vetëm komunitetet, por edhe vetë shteti shqiptar, i cili kohët e fundit është vënë në një dilemë sepse gjatë viteve të tranzicionit iu është hapur dera edhe shumë

sekteve fetare, të cilët kanë ardhur me synime të mirëpërcaktuara prozelitizmi¹.

Kësaj marrëveshjeje i ka paraprirë një fushatë në shtyp për problemet e hapjes së një universiteti islam në Tiranë që iu bë e ditur publikut gjatë përrurimit të universitetit katolik dhe spitalit “Zoja e Këshillit të Mirë”. 3 ditë përpara se të firmosej kjo kontratë në faqet e gazetës që ka hyrë së fundmi në tregun e shtypit të shkruar “Express”, më saktësisht të martën në 15 mars 2005, botohet një shkrim i titulluar “**Mjaft pasiviteteve në çështjet fetare**”, analizë, Xhavit Shala (drejtor i Qendrës Shqiptare të Studimeve për Sigurinë Kombëtare – ish-funksionar i rendit dhe i SHISH).

Në këtë shkrim, të cilin autori e nis duke përmendur përplasjen e simboleve ku përmend rastin e dy kryqeve të mëdhenj ortodoksë, vazhdon me analizën mbi gjendjen e bashkësisë muslimane pas ardhjes së demokracisë deri në ditët e fundit. Ai akuzon haptas se OJQ-të arabe u bënë përhapëse të fundamentalizmit islamik në Shqipëri nëpërmjet selefizmit. Citojmë nga shkrimi: “Selefizmi është semafori jeshil i fundamentalizmit islamik. Ai ndryshon nga katër drejtimet kryesore të ushtrimit të myslimanizmit, të njohura zyrtarisht në botë.” Në rreshtat pasues të këtij citimi autori mundohet të bëjë një shqyrtim të imtë për këtë lëvizje në botë dhe në Shqipëri dhe lëvizjet e tyre. Duket nga informacioni i paraqitur nga ky autor se ai nuk i njeh sa duhet shkollat juridike islame dhe se informacioni është i marrë nga burime jo të mirëinformuara për nga pikëpamja doktrinale, për të cilën ai mundohet të japi shpjegime si dhe për ndjekësit e këtyre lëvizjeve. Burimet e informimit të autorit duhet të jenë të brendshme, të Komunitetit Musliman. Megjithatë, me sa duket, më i rëndësishëm për këtë person janë pikat që jepen në mbyllje të shkrimit dhe që kanë të bëjnë me: miratimin e ligjit për komunitetet fetare, nënshkrimi i një aktmarrëveshjeje midis qeverisë dhe katër komuniteteve fetare si dhe zgjidhja me ligj për kthimin e pronave komuniteteve fetare.

Vijmë në datën 19 mars 2005, kur pothuajse në të gjitha gazetat shqiptare të përditshme i bëhet jehonë faktit të nënshkrimit të një marrëveshjeje midis të katër komuniteteve fetare tradicionale të pranishëm në vendin tonë.

Titujt e përdorur nga të gjitha këto gazeta janë të ngjashëm dhe nga një lexim i vëmendshëm kuptohet se kanë përdorur

* **Prozelitizëm** - Fushatë për fitimin dhe konvertimin e njerëzve nga një fe në një fe tjetër.

një burim të përbashkët që mund të ketë qenë edhe faqja zyrtare e internetit e qeverisë shqiptare ose edhe ATSH.

Në të gjitha këto shkrime i bëhet jehonë faktit të nënshkrimit të marrëveshjes së katër komuniteteve fetare tradicionale në Shqipëri e quajtur “Deklarata e Angazhimeve të Përbashkëta Morale”. Në këtë takim kanë qenë të pranishëm kryeministri Fatos Nano, funksionarë të lartë shtetërorë, funksionarë të trupit diplomatik të akredituar në Tiranë si dhe përfaqësuesit e konferencës botërore “Fetë për Paqen”, me drejtoreshën e saj rajonale Emyli Kruniç. Po ashtu kjo nismë është mbështetur nga Ministria e Jashtme Gjermane. Në këtë deklaratë komunitetet fetare angazhohen për vazhdimin dhe promovimin e një atmosfere paqësore brenda komuniteteve dhe në asnjë rast të mos nxisin urrejtjen fetare ndaj njëri-tjetrit.

Pak a shumë, teksti është i ngjashëm në të gjitha gazetat, por në rastin e gazetave “Panorama” dhe “Shekulli” është gabuar kur thuhet katër fe në titull, sepse janë dy fe dhe katër komunitete. Muslimanë dhe të krishterë që i përkasin bektashinjve dhe sunitëve; ortodoksë dhe katolikë. Përfundim në hartimin e këtij lajmi bëjnë gazetat “Korrieri” dhe “55”, të cilat e kanë trajtuar ndryshe, pra, jo në formën e një lajmi, porse kanë dhënë edhe pika nga kjo deklaratë e nënshkruar si dhe çfarë i kanë kërkuar autoriteteve shtetërore këto komunitete fetare. Ndërsa në gazetën e përditshme “Dita” i lëshohet një vend i konsiderueshëm fjalës së kryeministrit shqiptar Fatos Nano për këtë ngjarje të rëndësishme.

Po ashtu në dy të përditshme “Panorama” dhe “Shekulli” shfaqen dy shkrime nga dy analistë të mirënjohur si Ferdinand Xhaferaj dhe Mentor Nazarko. Le t'i kushtojmë pak vëmendje secilit shkrim:

E shtunë 19 mars 2005

gazeta “Panorama”

“Universitetet fetare dhe siguria kombëtare”, Ferdinand Xhaferaj, opinion, fq. 1 me vazhdim fq. 11.

Në këtë shkrim vëmendja e autorit është përqëndruar mbi hapjen e universitetit musliman që ende nuk është hapur në Tiranë. Në të gjithë shkrimin është bërë i ndjeshëm fakti se nëse do të hapet një universitet musliman në Shqipëri do të minimizohet rreziku që vjen ndaj të shkolluarve jashtë në universitetet fetare. Ndërsa hapja e një universiteti musliman në Tiranë do të sjellë edhe një kombëtarizim të kuadrove që mendohet se do të dalin nga kjo strukturë e supozuar. Ky shqetësim i autorit vjen nga traditat e vendeve të tjera islame,

citojmë: “Traditat e huazuara nga vendet arabe mund të prodhonin një orientim të Islamit shqiptar sipas parimit, feja para kombit. Kjo do të përbënte një kërcënim nga më seriozët për institucionin e harmonisë fetare”. Ky autor vazhdon më tej të flasi me tone pozitive për punën që duhet të bëjnë predikuesit muslimanë në bazë të ajeteve kuranore për tolerancën. Më tej ky autor e sheh si pozitiv hapjen e këtij universiteti dhe mbylljen e ciklit të arsimit të lartë për të gjithë nxënësit e 7 medreseve të shpërndara në Shqipërinë zyrtare. Ky autor mendon, citojmë: “Pra, universiteti duke mundësuar një zhvillim modern kombëtar të Islamit në vendin tonë do të jetë një harmonizues progresiv i Islamit kombëtar shqiptar me vlerat e qytetërimit evropian.”

gazeta “**Shekulli**”

“**Pajtimi si bazë e sigurisë**”, opinion, Mentor Nazarko (ish-këshilltar i presidentit Rexhep Meidani), fq. 1 me vazhdim në fq. 14.

Në këtë shkrim autori merr shkas nga nënshkrimi i deklaratës së përbashkët të të katër krerëve të katër komuniteteve fetare tradicionale në vend si dhe kontekstit politik dhe social në të cilën u nënshkrua kjo deklaratë. Vetëvrasja e disa adoleshenteve që mendohet të jetë shtyrë nga sektet e “Dëshmitarëve të Jehovait”, realizimi i një ligji që do të rregullojë marrëdhëniet e feve me shtetin, çështjet e sigurisë kombëtare, hapja e një universiteti musliman, si dhe vazhdimi i harmonisë dhe i tolerancës fetare janë marrë në shqyrtim në këtë shkrim nga autori. Po ashtu ky autor e sheh si pozitiv lëvizjet e bëra nga Komiteti Shtetëror i Kulteve me në krye z. Ilir Kulla. Pas këtyre konstatimeve të bëra nga ky autor, pra, të marrëdhënieve të shtetit me fetë, ai ngre si problem çështjen e integritetit të Shqipërisë, citojmë: “Kjo përbërëse e rrjedhës së zhvillimeve tona shoqërore lidhet në mënyrë vendimtare jo thjesht me imazhin e vendit i cili nuk është një fjalë goje, por me të gjithë zhvillimet integruese shqiptare dhe me sigurinë kombëtare. Nuk mund të përfshihesh në një organizim ndërkombëtar si BE i cili derimëtanë konsiderohet si klub i vendeve të krishtera, pa i dhënë drejtimin e duhur këtij procesi, pa zgjidhur në mënyrën më të drejtë disa prej problemeve në fjalë.” Në vazhdim ky autor ngre problemin se sektet fetare për mendjen e tyre ateiste përfaqësojnë në një farë mënyre llozha masonike, ku përqëndrohet jo vetëm pushteti shpirtëror, por edhe ai ekonomik-financiar që i kapërcen kufijtë legalë shtetërorë. Më pas ky autor nënvizon faktin se shteti duhet të rregullojë me dinjitet raportet me bashkësitë fetare pa shkelur

lirinë e besimit. Në aspektin e marrëdhënieve të shtetit, ai duhet të diferencojë marrëdhëniet e tij me fetë tradicionale dhe me fetë e reja që kanë hyrë pas hapjes së Shqipërisë. Ky autor e mbyll opinionin e vet me shqetësimin e sigurisë kombëtare, ku citojmë dy fjalitë e fundit: “Për më shumë që sot feja është bërë element thelbësor i lidhur me sigurinë e vendeve të veçanta, apo në përgjithësi e familjes së tyre. Sa më i vogël të jetë një vend, megjithë historinë e lavdishme të bashkëjetesës mes feve, aq më i madh është rreziku i faktorëve të tillë si terrorizmi.”

Pra, kjo është atmosfera e paraqitur në mediat shqiptare rreth këtij evenimenti të rëndësishëm, ku të katër komunitetet njëzëri i kanë kërkuar kryeministrit Nano rikthimin e pronave të tyre. Kjo është edhe kërkesa më e rëndësishme që i kanë bërë ato kryeministrit shqiptar dhe së cilës pas kaq vjet demokracie nuk i është dhënë akoma zgjidhje.

Shtojcë 2

Problemi i karikaturave dhe pasqyrimi i tyre në shtyp

Me të ashtuquajturin problem të karikaturave që plasi në të gjitha mediat ndërkombëtare, nuk mund të mbetëj pa u trajtuar edhe nga mediat tona të shkruara. Jo vetëm që u dhanë njoftimet për atë çka po ndodhte në të gjithë botën myslimane, por me këtë problem u morën edhe analistët e opinionistët shqiptarë. Mendimet që u dhanë ishin nga më të ndryshmet dhe më të çuditshmet, deri sa u tha që muslimanët me këto veprime po kërcënojnë lirinë e mediave për të pasqyruar realitetin. Ndërkaq ky debat, nuk arriti t'i japë jetë një debati tjetër! Atij që: "A ka gjëra të shenjta shoqëria shekullore që ne të gjithë kemi ngritur". Megjithatë neve shohim se ky problem u lansua edhe për arsye komerciale, për vetë faktin e titujve bombastikë që u përdorën, pavarësisht reagimit që pritej nga pjesa myslimane e shoqërisë. Nga zhvillimet, të cilat dolën në pah pasi kishte shpërthyer në media ky problem, u vu re se botimi i parë i karikaturave nuk kishte pasur impaktin e pritur nga vetë botuesit. Karikaturat u botuan në shtator, ndërsa skandali shpërtheu në dhjetor në botën myslimane dhe në janar arriti pikun e vet. Ribotimi i tyre në Norvegji më 10 janar 2006 nga revista "Magazinet", cilësohet nga analisti dhe diplomati Luan Rama si një "shkarje të rrezikshme". Më 30 janar edhe gazeta daneze Jyllands Posten, edhe Magazinet kërkojnë falje publike për botimin e karikaturave, por situata vazhdoi të mbetet e njëjtë, sepse shumë gazeta të tjera evropiane i ribotuan ato. Në Shqipëri mediat reagueshan në fund të janarit dhe në fillim të shkurtit. Në të gjithë shkurtin më pas pati reagime të ndryshme edhe prej të gjithë analistëve. Një çast me të vërtetë interesant i këtij muaji, ishte edhe ai i vizitës së ministrit të jashtëm spanjoll Migel Angel Moratinos ku në takimin që ka pasur me homologun e tij shqiptar Besnik Mustafaj, dy kanë qenë temat kryesore të bisedimeve ndërmjet tyre: hapja e ambasadës spanjolle në Tiranë, si dhe ka kërkuar që Shqipëria të përcjelli mesazhe moderuese në Konferencën Islamike si anëtare e saj, rreth protestave të ashpra ndaj botimit të disa karikaturave të Profetit Muhamed në gazetën daneze "Jyllands Posten". Gjatë konferencës së përbashkët për mediat, ministri spanjoll

Moratinos ka deklaruar: “Është e vërtetë se Shqipëria është një vend me shumicë popullsie myslimane dhe gjatë bisedimeve kemi trajtuar edhe këtë problematikë të ekseseve që po ndodhin në Botën Arabe ndaj këtyre botimeve. I kam kërkuar kolegut tim shqiptar, si anëtar i Konferencës Islamike, që të dërgojë atje mesazhin e moderacionit”. Kjo deklaratë e ka vënë paksa në vështirësi ministrin Mustafaj. Megjithatë të gjitha gazetat i kanë bërë jehonë këtij lajmi dhe kanë pasqyruar deklaratën e Moratinos. Menjëherë pas kësaj deklarate ka reaguar ashpër kundër saj krahu i majtë i politikës shqiptare me përfaqësuesit e saj: Paskal Milo, Ilir Meta, Arta Dade etj. Më tej Komuniteti Musliman ka bërë thirrje për më tepër maturi ndaj këtij problemi dhe njëkohësisht ka reaguar ashpër ndaj publikimit të karikaturave.

Ndërkaq një deklaratë e ambasadorit iranian në Tiranë, Biazar në një konferencë shtypi solli reagime të ashpra nga analistët shqiptarë. Deklaratat e kryetarit të KMSH kanë një theks të ndjeshëm tolerance, por duke e cilësuar këtë ngjarje si të papranueshme dhe trajtimin që i është bërë figurës së Profetit Muhamed. H. Selim Muça e ka cilësuar botimin e karikaturave si: “..., një akt i rëndë fyes ndaj besimtarëve myslimanë. Për më keq, në këtë rast nuk bëhet fjalë vetëm për karikaturimin e profetit Muhamed, e cila sërish nuk do të ishte e pranueshme, por për disa karikatura që janë thelbësisht denigruese dhe fyese”.

Po ashtu më pas do të jepet deklarata e Myftinisë së Shkodrës rreth problemit të karikaturave. Në këtë deklaratë Myftinia i ka dënuar këto publikime si akte destabilizues dhe që baltosin dinjitetin e myslimanëve. Në një pjesë të deklaratës thuhet: “Nuk e dimë se pse këtu dhe në Perëndim çdo ditë e më tepër po shtohet arroganca ndaj myslimanëve dhe Islamit, në një kohë që dikush sa për sy e faqe trumbeton mbrojtjen e të drejtave të besimit dhe lirive të njeriut”. Pavarësisht zemërimit që ngjalli në të gjithë botën islame dhe bllokadës që iu bënë prodhimeve daneze, të gjitha palët në “konflikt” në Shqipëri lëshuan mesazhe tolerance dhe mirëkuptimi. Vetë ambasadori danez në Tiranë Finn Theilgaard ka shkuar në selinë e Komunitetit Musliman dhe ka dorëzuar deklaratën e kryeministrit danez që i ka dënuar karikaturat. Janë dy gazeta ato që botojnë edhe intervistën marrë ambasadorit danez rreth këtij problemi, si dhe reagimeve të ndryshme në Danimarkë dhe të kryeministrit të saj, Rasmusen. Ky problem ka vazhduar të trajtohet edhe pas muajit shkurt, porse ritmi i botimeve rreth

kësaj teme ka qenë i papërfillshëm dhe nuk ka pasur atë impakt që pati në fillim. Në një shkrim që shfaqet në muajin mars në gazetën “Shekulli”, nga një shqiptar, i cili ka marrë nënshkrimin daneze, njoftohemi se gazetatat daneze subvencionohen nga shteti dhe nuk janë private. Megjithatë ky problem u mbyll në shtypin ndërkombëtar edhe për shkak të ngjarjeve të tjera, që do të zinin faqet e para dhe titujt kryesorë të edicioneve televizive.

Kush është autori i Monitorimit



Autori i këtij monitorimi Roald A. Hysa ka ushtruar profesionin e gazetarit që nga viti 1997 e deri më shtator të vitit 2006. Në vitet 1992-1996 ai kreu studimet e larta në Fakultetin e Histori- Filologjisë, dega Gjuhë-Letërsi. Nga marsi i vitit 2003

e deri në korrik të vitit 2004 ka punuar si gazetar i sociale dhe më pas i kulturës pranë redaksisë së lajmeve të SHIJAK TV. Brenda po të njëjtës periudhë për tre muaj rresht ai ka drejtuar emisionin e drejtpërdrejtë “Media + Kulturë” me të ftuar të ndryshëm nga fusha të ndryshme të kulturës shqiptare. Nga shkurti 2004 deri në dhjetor 2004, ka drejtuar dy emisione javore në radio Kontakt, si gazetar i jashtëm, ndërsa më pas ka drejtuar një emision të përditshëm me lajme të jashtme të titulluar “Ditari Ndërkombëtar” po në Radio Kontakt deri në shtator 2006. ai ka punuar në disa gazeta të përjavshme si: Liria, Atdheu dhe Flamuri. Ka botuar shkrime të ndryshme në të përditshme si: Republika, 55, Tirana Observer dhe Panorama si dhe në të përjavshmen lokale Shkodra. Po ashtu ka dhënë kontributin e vet me editoriale dhe shkrime të ndryshme në gazetën e KMSH-së “Drita Islame”. Për një periudhë dy-vjeçare ka drejtuar revistën e specializuar “Jehona”, si dhe nën këtë emërtim ka botuar rreth 15 tituj librash. Gjithashtu gjatë kësaj kohe ka redaktuar libra të ndryshëm që janë botuar në Shqipëri dhe Maqedoni, ku dallojnë librat e Harun Yahyas në shqip: Gjunjëzimi i Evolucionit, Krijimi i universit, Popujt e zhdukur, Mrekullitë e Kuranit etj. Ky është libri i parë që sheh dritën e botimit në mënyrë elektronike. Në planet e tij të shpejta të botimit hyjnë edhe dy tituj të tjerë: “Një vështrim nga e kaluara në të ardhmen” (përmbledhje me ese të botuara në periodikë të ndryshëm) dhe “Sundimtarë të mëdhenj muslimanë” me karakter historik.

Përmbajtja

1 Paraqitja e monitorimit “Mediat e shkruara dhe muslimanët”	3
2 Monitorimi i mediave shqiptare të shkruara.....	7
Muaji Shkurt 2005.....	9
Muaji Mars 2005.....	14
Muaji prill 2005.....	28
Muaji Maj 2005.....	38
Muaji Qershor 2005.....	54
Muaji Korrik 2005.....	68
Muaji Gusht 2005.....	72
Muaji Shtator 2005.....	82
Muaji Tetor 2005.....	90
Muaji Nëntor 2005.....	94
Muaji Dhjetor 2005.....	103
Muaji Janar 2006.....	111
Muaji Shkurt 2006.....	119
Tabelë analitike e shkrimeve të paraqitura në monitorimin e mediave të shkruara shqiptare....	134
Shkrimet e evidentuara në monitorim.....	135
Temat që i kanë interesuar më tepër mediat e shkruara.....	137
Marrëveshja e katër komuniteteve fetare tradicionale dhe aktualiteti shqiptar	139
Problemi i karikaturave dhe pasqyrimi i tyre në shtyp	144
Kush është autori i Monitorimit.....	147